

Abdul Mexhid Aziz Ez-Zindani

EL~IMAN

Të besuarit e vërtetë në dritën e Kur'anit, Sunnetit dhe
argumenteve shkencore

EL~IMAN

Të besuarit e vërtetë në dritën e Kur'anit, Sunnetit
dhe argumenteve shkencore

Autorët:

Abdul Mexhid Aziz Ez-Zindani

dhe:

Abdull-llah El-Wezaf, Ahmed Selame, Tewhid Abdul
Hamid, Fejsal Abdul Aziz, Hazam El-Behluli

Përktheu dhe përshtati:

Nig'jar Bajrami ~ HOTI

Redaktor:

Dr. Ilir HOTI

Lekturoi:

prof. Fazli HAJRIZI

EL~IMAN

**Të besuarit e vërtetë në dritën e Kur'anit,
Sunnetit dhe argumenteve shkencore**

Abdul Mexhid Aziz Ez-Zindani



Parathënie

Falënderimi i qoftë All-llahut, Zotit të botëve, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit, i Cili na udhëzoi në rrugë të drejtë. Atë që e udhëzon All-llahu, nuk ka kush që mund ta shpie në mashttrim (humbje), por, kush shkon në mashttrim, askush përveç Tij nuk mund që ta nxjerrë nga mashtrimi. Salavatet dhe selami qofshin mbi të Dërguarin e All-llahut, . Muhammedin savs¹.

Singerisht të lutemi, o All-llah i Mëshirshëm, na mëso atë që është e dobishme dhe na ndihmo që ta shfrytëzojmë atë, çfarë na ke mësuar. Na shto diturinë, na forco imanin tonë dhe na mbrojtë nga zjarri i xhehennemit.

All-llahu svt² në Kur'an thotë:

“Ne do t’ua bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet tona në horizonte dhe në veten e tyre deri që t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë.”³

Librin, të cilin e hartuam për lexuesin e nderuar dhe të

¹ savs apo sal-lAll-llahu ‘alejhi we sel-lem - domethënë: “Mëshira, shpëtimi dhe paqja e All-llahut qofshin mbi të.”

² svt apo subhanehu we te’ala - domethënë: “I Lartëmadhëruari dhe i Lartësuari.”

³ Fussilet: 53.

cilin ngrohtësisht ia propozojmë për lexim dhe për të persiatur mbi përmbajtjen e tij, flet për gjërat më të rëndësishme në jetën tonë, mbi imanin - besimin Islam. Librin e kanë shkruar pesë autor, me Shejh Ez-Zindani në krye, ndërsa e kanë lexuar qindra dijetarë më eminentë, të profileve të ndryshme shkencore, duke e vlerësuar librin me nota të larta.

Shejh Ez-Zindani me bashkëpunëtorët e vet, këtë temë më të rëndësishme në jetën tonë e shtjellon në një mënyrë të re, moderne dhe të prerë, duke e përdorur nurin - dritën e All-llahut nga Kur'ani, Sunnetin e Muhammedit savs, dhe zbulimet moderne shkencore, të cilat kanë mbulesë reale.

Mund të thuhet që në mendimet e autorit dominojnë tri tema themelore: **njohja e All-llahut, Ahireti me të gjitha shfaqjet dhe përmbajtjet e veta, pastaj Sirati Mustekim - rruga e drejtë, e cila të shpie në kënaqësinë e All-llahut, mandej të arriturit e shpërblimit meritore në Ahiret.**

Të gjitha këto janë shkruar me një stil të qartë dhe të përshtatshëm, gati për çdo moshë. Do të thotë, Ez-Zindani, **“Nuk e kërkon macën e zezë në dhomën e errët”**, por në një mënyrë të thjeshtë dhe efikase i paraqet të vërtetat nga Kur'ani dhe Sunneti, duke i ndihmuar lexuesit që t'i njohin këto të vërteta. **“në hapësirat e Gjithësisë, si edhe në veten e tyre”!** Në këtë libër do të vijë gjithashtu deri te përgjigjja në ato pyetje të pashmangshme, me të cilat ngarkohet çdo njeri në jetë.

- Nga, dhe si erdha në këtë botë?
- Përse kam ardhur në këtë botë?
- Dhe ku pas të gjithave⁴ ?!

⁴ sh.p. Ku, pas të gjithave do të shkojë.

Sipas Kur'anit, janë katër faza të ekzistimit:

- Periudha para krijimit
- Jeta në dunja - në këtë botë
- Periudha në Berzah⁵
- Jeta e amshuar në Ahiret.

All-llahu fuqinë e vet e ka treguar përmes krijimit në katër mënyra:

- Mënyra e të krijuarit pa mashkull dhe pa femër (Ademit assa⁶)

- Mënyra e të krijuarit vetëm nga mashkulli (Hava nga Ademi assa)

- Mënyra e të krijuarit vetëm nga femra (Isa, assa, nga Merjemi)

- Mënyra e të krijuarit nga mashkulli dhe femra (lindjet e sotme)

Kur All-llahu ka dashur që t'i tregojë Ibrahimit assa se si i ngjall të vdekurit, i ka thënë “**...hudh erbeaten minet-tajri...**” (merri katër zogj)!!

Këto janë vetëm ca grimca të mençurisë, të cilat lexuesit tonë duhet që t'i shërbejnë si shkas më tepër, që sa më me studiozitet t'i çaset leximit të këtij libri. Ka për të parë, që vlera e personalitetit të tij, vjen në shprehje të plotë mu në iman!

Duaja jonë e fundit përherë qoftë:

El-Hamdu lil-lahi, Rabbil alemin!

Falënderimi i qoftë All-llahut

Stuttgart, R. Ahira, 1415. h./1994 Ebu Fuad

⁵ sh.p. Jeta në varreza.

⁶ assa apo ‘alejhisselam - domethënë: “Paqja qoftë mbi të.”

Hyrje

I gjithë falënderimi i takon All-llahut. Atë e falënderojmë, nga Ai ndihmë dhe falje kërkojmë. E lusim All-llahun që të na mbrojë nga e keqja e shpirtrave tanë dhe nga veprat jo të mira. Atë që All-llahu e udhëzon në rrugë të drejtë, nuk ka kush që mund ta shpie në humbje, e kush shkon në humbje, askush përveç Tij nuk mund ta nxjerrë nga humbja. Dëshmoj që nuk ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut dhe se Muhammedi savs është rob dhe i Dërguar i Tij.

Obligimi i parë i njeriut është që përveç arritjes së diturisë-ilmit, ta njohë All-llahun e Madhërishëm, i Cili thotë:

“Atëherë, dije se nuk ka të adhuruar tjetër pos All-llahut...”⁷

dhe që përsëri, përmes arritjes së diturisë-ilmit me të cilin njeriu arrin bindje të fortë, që të njihet me personalitetin dhe jetën e të Dërguarit savs dhe vërtetësinë e **Risaletit** (Shpalljes) - Misionit të tij.

All-llahu thotë:

“A është i nejtë ai që e di se ajo që t’u shpall ty nga Zoti

⁷ Muhammed: 19.

yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë, e kuptojnë të vërtetën.”⁸

Gjithashtu, është i detyruar, që ta njohë fisnikërinë e krijimit të tij në dunja, mandej, ta njohë vendin e kthimit të tij, të cilit çdo moment i afrohet dhe ta njohë Dinin - Fenë e Zotit të vet, të cilin është i obliguar që ta pasojë.

Nëse vlera e ndonjë shkence vlerësohet sipas lëndës e cila studiohet, atëherë shkenca mbi imanin-të besuarit Islam është direkt e lidhur për njohjen e All-llahut, të njohurit e jetës dhe personalitetit të të Dërguarit savs dhe të njohurit e Dinit të All-llahut. Nëse rëndësia e ndonjë pune i përgjigjet rezultateve të cilat i arrin njeriu, sikurse që i përgjigjet rrezikut, të cilin njeriu e mënjanon nga vetja me studimin e kësaj shkence, atëherë, njeriu me mësimin e imanit arrin dhe e realizon lumturinë, stabilitetin psikik dhe fitore të madhe në dunja dhe Ahiret. All-llahu besimtarëve në dunja u ka dhënë premtime të mëdha:

1. Ndihma në luftë kundër armikut:

All-llahu svt thotë:

“Obligim Yni është t’u ndihmojmë besimtarëve.”⁹

2. Ruajtja dhe mbrojtja e tyre:

All-llahu svt thotë:

“Me të vërtetë All-llahu i mbron ata që besuan...”¹⁰

3. Miqësia ndaj tyre:

All-llahu svt thotë:

“All-llahu është mik (mbikëqyrës) i atyre që

⁸ Er-Rra’d: 19.

⁹ Er-Rrum: 47.

¹⁰ El-Haxh: 38.

besuan,...”¹¹

4. Ka premtuar që do t’i udhëzojë në rrugë të drejtë:
All-llahu svt thotë:

“E All-llahu patjetër do t’i udhëzojë ata që besuan në rrugën e drejtë.”¹²

5. Të penguarit që kafirët - pabesimtarët t’i mbisundjonë mu’minët - besimtarët:

All-llahu svt thotë:

“...All-llahu kurrsesi nuk ua mundëson jobesimtarëve mbizotërimin e plotë mbi besimtarët.”¹³

6. Ndikimi absolut dhe të udhëhequrit në Tokë:
All-llahu svt thotë:

“Atyre nga mesi juaj, të cilët besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t’i bëjë mëkëmbës në atë tokë ashtu si i pat bërë mëkëmbës ata që ishin para tyre dhe Dinin (fenë) të cilin Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë e, në vend të frikës, Ai do t’u dhurojë siguri.”¹⁴

7. Ju ka premtuar risk - furnizim të mirë:
All-llahu svt thotë:

“E sikur banorët e këtyre vendbanimeve të kishin besuar dhe të kishin qenë të devotshëm, Ne do t’ju hapnim begati nga qielli e toka,...”¹⁵

8. Krenaria dhe dinjiteti:
All-llahu svt thotë:

“...Ndërsa e tërë krenaria i takon All-llahut, të

¹¹ El-Bekare: 257.

¹² El-Haxh: 54.

¹³ En-Nisa: 141.

¹⁴ En-Nur: 55.

¹⁵ El-A’raf: 96.

Dërguarit të Tij dhe besimtarëve,..¹⁶

9. Jetë të qetë:

All-llahu svt thotë:

“Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij jetë të mirë (në këtë botë),...”¹⁷

Këta janë vetëm disa nga faktorët e suksesit të besimtarit në dunja, të cilët i kanë realizuar të parët tanë të mirë.

Sa i përket Ahiretit, na mjaftojnë fjalët e All-llahut:

“S’ka dyshim se ata që besuan dhe bënë vepra të mira, vendpritje për ta janë xhennetet e Firdewsit. Aty do të jenë përgjithmonë, e nuk kërkojnë të largohen nga ai (ose t’u ndryshohet).”¹⁸ dhe fjalët:

“E ata që besuan dhe bënë vepra të mira, për ata janë xhenetet e begatshme, që në to janë përgjithmonë. Ky është premtimi i All-llahut, e premtimi i All-llahut është i vërtetë, e Ai është i Gjithfuqishmi, i Urti.”¹⁹

Kush mendon, për gjendjen e sotme të muslimanëve, do të vijë në përfundim, se ata janë shumë larg nga realizimi i asaj që All-llahu u premtoi, çfarë tregon qartë në dobësimin e imanit të tyre dhe në humbjen e shumicës, ose veçorive të shumta të imanit. Andaj janë shumë larg nga ajo çka All-llahu u premtoi besimtarëve në dunja, në pikpamje të fitorës dhe ndihmës, miqësisë, zbatimit të rrugës së drejtë, mëkëmbjes dhe ndihmës në Tokë, të paaftësuarit e kafirave, furnizimit të mirë-rizkut, krenarisë

¹⁶ El-Munafikun: 8.

¹⁷ En-Nahl: 97.

¹⁸ El-Kehf: 107-108.

¹⁹ Lukman: 8-9.

dhe dinjitetit, të jetës së mirë dhe të qetë.

Dhe çdo qëndrueshmëri në gjendje të këtyllë pa dyshim dhe sigurt shpie në humbjen e asaj, që All-llahu ka përgatitur për besimtarët në Ahiret, sikurse që përjetuan humbje në dunja, por jo vetëm kaq, vetvetes mund t'ia përgatisë qëndrimin në zjarrin e xhehennemit.

Për këtë shkak, është i domosdoshëm forcimi, stabilizimi dhe përtirja e imanit, e kjo arrihet duke përhapur diturinë në mesin e muslimanëve dhe të zbatuarit në praktikë të rregullave të Dinit. Andaj Ulematë - dijetarët janë veçanërisht përgjegjës për kryerjen e kësaj detyre delikate, aq më parë, kur çdo ditë vëren dhe bindet në sulmet e kafirëve ndaj muslimanëve, lëvizjet për kryqëzimin (krishterizim), sikurse që vëren dhe e përjeton përhapjen e shumë bestytnive dhe mashtrimeve të ndryshme, të cilat autorët e tyre mundohen që përmes gënjeshtreve t'ia përshkruajnë Dinit!

Andaj këtë libër, i cili flet mbi imanin dhe është vetëm njëri në vargun e studimeve mbi detyrat e Dinit, ua vë në duar muslimanëve, duke e lutur All-llahun ta bëjë vetëm për kënaqësinë e Tij, dhe që të jetë në dobi të të gjithë muslimanëve.

Andaj, kërkojmë nga të gjithë ata që janë të vetëdijshëm dhe xhelozë në Dinin e vet, që të bëjnë çdo përpjekje që këtë ta lexojnë dhe ta mësojnë, e pastaj të fillojnë me mësimin e familjes së vet, fqinjve dhe muslimanëve të tjerë, e All-llahu është gjithmonë në ndihmë. Duaja jonë e fundit është **“Falënderimi i takon All-llahut, Zotit të botëve”**.

IMANI DHE ESENCA E TIJ

All-llahu i Lartësuar, robërve të Vet ua ka sqaruar esencën e imanit, në bazë të së cilës, i pranon veprat e tyre dhe në bazë të së cilës, realizohet ajo çka All-llahu u ka premtuar robërve të Vet.

Imani: bindja e fortë ~ i'tikad dhe veprat e mira ~ amel

All-llahu thotë:

“Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All-llahut, të dërguarit të Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hirë të All-llahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Ata janë besimdrejtët.”²⁰

Nga ky ajet kuptojmë që imani i sinqertë dhe i pranuar, është bindje e cila në vete nuk ka përzierje të ndonjë dyshimi dhe vepër e shprehur përmes luftës, me pasurinë dhe jetën, në rrugë të All-llahut.

²⁰ El-Huxhurat: 15.

Kjo rrjedh nga ajo se bindja e zemrës nuk mjafton që imani të jetë i pranuar.

Po, Iblisi a nuk ishte i bindur në ekzistimin e All-llahut? Kur’ani i thekson fjalët e tij:

“Ai tha: »Zoti im, më jep afat deri në Ditën e Ringjalljes!«.”²¹

Megjithatë, edhe përkundër kësaj, All-llahu atë e përshkruan kufër, për shkak të mendjemadhësisë dhe padëgjueshmërisë në veprën, të cilën All-llahu ia urdhëroi. All-llahu thotë:

“...me përjashtim të iblisit (shejtanit). Ai refuzoi dhe u mbajt në të madh dhe u bë pabesimtar.”²²

Pra, imani i vërtetë është ai, i cili përmban:

1. Bindje të fortë - akidën - pa aspak përzierje të dyshimit

2. Vepra pozitive - amel - që e vërteton bindjen e fortë dhe që është frut-rezultat i saj.

Llojet e veprave

- **Veprat e zemrës**, siç janë: frika nga All-llahu, të kërkuarit mbrojtje tek Ai dhe të mbështeturit kryesisht në Të.

- **Veprat e gjuhës**, siç janë: shqiptimi i shehadetit, lavdërimi i All-llahut azvxh²³, istigfari dhe të thirrurit e

²¹ Sad: 79.

²² El-Bekare: 34.

²³ azvxh apo ‘Azze we Xhel-l - domethënë: “I Lartësuar dhe i

All-llahut.

- **Veprat e organeve trupore**, siç janë: namazi, zekati agjërimi, xhihadi në rrugën e All-llahut, studimi i shkencës me qëllim të arritjes së kënaqësisë së All-llahut, tregtia, bujqësia dhe prodhimi industrial, duke e realizuar me këtë urdhërin e All-llahut, në përpjekje të mëkëmbjes së njeriut në Tokë në pajtim me mësimet islame.

Imani shtohet (forcohet) dhe pakësohet (dobësohet)

Ekzistojnë shkaqet që e forcojnë imanin, ashtu që ai shtohet.

All-llahu thotë:

“...kur u lexohen ajetet e Tij u shtohet besimi...”²⁴

Ekzistojnë shkaqet, përkatësisht mëkatet të cilat e dobësojnë imanin, sikurse që thotë i Dërguari savs:

“Zinaqari nuk mund të bëjë zina, e që gjatë kohës kur bën zina të mbetet mu'min.”

Imanin e vërtetë do ta realizojmë:

1. Duke arritur bindje të fortë në zemër: përmes studimit të shkencës.

2. Me veprën e zemrës: përmes mëimit dhe të menduarit mbi ajetet e All-llahut në Kur'an dhe argumenteve në kozmos, mandej përmes ajeteve të premtimeve dhe kërcënimeve.

3. Me fjalët e gjuhës: vazhdimisht duke e përmendur

Madhëruar.”

²⁴ El-Enfal: 2.

All-llahun, duke e folur të vërtetën, duke e thirrur All-llahun, nxitja për kryerjen e veprave të mira dhe pengimi nga veprat e këqija, duke studiuar dhe hulumtuar, duke propozuar dhe këshilluar të vërtetën dhe sabrin - durimin.

4. Me veprat e organeve trupore: duke i praktikuar parimet e Islamit, me xhihad në rrugë të All-llahut me pasuri dhe me jetë, duke i luftuar negativitetet personale me qëllim të arritjes së nënshtimit ndaj All-llahut dhe të shoqëruarit me njerëz të vyer dhe të denjë.

All-llahu thotë:

“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që dëshirojnë Fytyrën e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar. E ti thuaj: »E vërteta është nga Zoti juaj, e kush të dojë, le të besojë, e kush të dojë, le të mohojë...”²⁵

Për t'i arritur të gjitha këto, është e nevojshme që zemrat t'i pastrojmë dhe t'i shërojmë nga sëmundjet që zbrapsin nga rruga e drejtë.

²⁵ El-Kehf: 28-29.

PASTRIMI DHE SHËRIMI I ZEMRËS

“Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (do të ketë dobi) Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë.”²⁶

Zemra e pastër është zemra e besimtarit:

Sikur që toka e plleshme përshkruhet me veçori të ndryshme, mu ashtu edhe zemra e besimtarit përshkruhet me përshkrime të ndryshme:

1. Përparësi të plotë, të vërtetës: nga e cila rezulton njohja e të vërtetës dhe pasimi i saj.

All-llahu thotë:

“...e ti përgëzoji robërit e Mi! Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që All-llahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.”²⁷

Ndërkaq, zemrat e sëmura të kafirëve janë përherë në kundërshtim me të vëretën, andaj përherë mbesin në

²⁶ Esh-Shuara: 88-89.

²⁷ Ez-Zumer: 17-18.

xhehalet (padituri), pa pasur mundësi që të udhëzohen.

All-llahu thotë:

“Nuk ka argument që u vjen atyre nga argumentet e Zotit të tyre, e që ata nuk i shmangen.”²⁸

2. Dashuria ndaj të vërtetës dhe zemërgjerësia ndaj Islamit.

Pronari i zemrës së pastër dhe të shëndoshë, e do të vërtetën dhe me afsh e hap krahërorin e vet për studimin e Islamit dhe me atë e meriton udhëzimin-hidajetin e All-llahut, ndërsa pronari i zemrës së papastër dhe të sëmurë e përbuzë të vërtetën dhe krahërori i tij është i ngushtë ndaj Islamit, me çka vetën ia ekspozon dënimit të All-llahut, duke shkuar në humbje-mashtrim.

All-llahu thotë:

“Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë si të ngjitej në qiell.”²⁹

E kjo është për atë, pse ata e urrejnë të vërtetën.

All-llahu thotë:

“...ai ka ardhur me të vërtetën, e shumica e tyre e urren të vërtetën.”³⁰

3. Përgjigjia në thirrjen Islame dhe dëshira për rritjen e vazhdueshme të tij:

Pronari i zemrës së pastër dhe të shëndoshë, përgjigjet

²⁸ El-En'Am: 4.

²⁹ El-En'Am: 125.

³⁰ El-Mu'minun: 70.

në thirrjen e Islamit, sikur që All-llahu transmeton fjalët e pronarit të zemrës së pastër dhe të shëndoshë:

“Zoti ynë, ne dëgjuaam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): Të besoni Zotin tuaj! E ne besuam! Zoti ynë, na i falë mëkatet tona, na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët!”³¹

Mu’mini dëshiron që imani i tij vazhdimisht të forcohet.

All-llahu thotë:

“E kur zbret ndonjë sure e re (kaptinë), ka prej tyre që thonë: »Cilit prej jush ia shtoi kjo besimin?« Sa u përket atyre që besuan, atyre u shtohet besimi dhe gëzohen për të.”³²

Pra, pronarët e zemrave të sëmura, përherë zbrapsen nga rruga e All-llahut.

All-llahu thotë:

“Ata që i japin përparësi jetës së kësaj bote ndaj botës tjetër, pengojnë nga rruga e All-llahut dhe kërkojnë shtrembërimin e saj. Të tillët qartas janë në humbje.”³³

Njerëzit me zemra të shëndosha, mendojnë mbi veten e tyre, mbi krijimin e qiejve dhe të tokës, mbi udhëzimin që u ka ardhur nga Krijuesi i tyre dhe i cili i njofton me qëllimin dhe kuptimin e jetës dhe vdekjes së tyre, i cili e përshkruan të kaluarën dhe të ardhmen e tyre, të menduarit mbi xhennetin të cilin All-llahu ua premtonte besimtarëve dhe adhabin - dënimin që i pret kafirat. Ata mendojnë mbi mu’xhizet e të Dërguarit savs, mbi argumentet e sinqeritetit të tij dhe ashtu të zbatojnë atë që i ka

³¹ Ali Imran: 193.

³² Et-Tewbe: 124.

³³ Ibrahim: 3.

urdhëruar, me çka do të arrinin lumturinë e dunjas dhe të Ahiretit dhe do të ruheshin nga adhabi i zjarrit të xhehennemit.

All-llahu thotë:

“Për ata që All-llahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): Zoti ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!”³⁴

Megjithatë kafirat i kanë paaftësuar shqisat dhe arsyet e veta, të cilat u janë dhuruar për të menduar dhe, të vërtetën nuk do ta pranojnë deri në Ditën e Kijametit, ditë kur do të pendohen.

All-llahu thotë:

“Dhe thonë: »Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit.«³⁵

4. Të ardhurit në vete:

Njeriu zakonisht harron, ndërkaq, njeriu me zemër të shëndoshë shpejt vie në vete dhe përkujtohet, e mandej bëhet i matur e jo i verbër:

“Vërtet, ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga shejtani, ata përkujtojnë (All-llahun) dhe atëherë shohin (të vërtetën).”³⁶

Andaj All-llahu e ka urdhëruar paralajmërimin dhe të përkujtuarit:

“Vazhdo me këshillë, sepse këshilla besimtarëve u bën

³⁴ Ali-Imran: 191.

³⁵ El-Mulk: 10.

³⁶ El-A'raf: 201.

dobi.”³⁷

All-llahu gjithashtu thotë:

“E ti këshillo aty ku këshilla bën dobi. Do të këshillohet ai që ka frikë. E do t’i shmanget asaj, ai që është më i keq. I cili do të hyjë në zjarrin e madh. E aty as nuk do të vdesë, por as nuk do të jetojë.”³⁸

Ndërkaq, njerëzit me zemër të sëmurë, janë të pakujdesshëm-në gaflet, ata nuk besojnë.

All-llahu thotë:

“Ti tërhiqja atyre vërejtjen për Ditën e dëshpërimit, kur të marrë fund çështja (e përgjegjësisë, e dikush në xhennet, dikush në zjarr), se ata (sot) janë të painformuar dhe ata nuk janë duke besuar.”³⁹

Nëse ndonjë njeriu indiferent ia përkujton Ahiretin, do të thotë: **“A, ti erdhe të më mësosh mbi Islamin, e unë jam musliman më i mirë se ti?!”**

5. Bindja e fortë:

Njeriu me zemër të shëndoshë, i cili mendon, e studion shkencën dhe është gjithnjë i vetëdijshëm dhe përkujtohet, padyshim arrinë bindje të fortë - El-Jekin, sikurse që All-llahu e shpjegon në ajetet Kur’anore vijuese, me fjalët:

“Për besimtarët ekzistojnë argumentet në qiej dhe në tokë. Për një popull që sinqerisht është i bindur, ka argumente edhe në krijimin tuaj dhe në krijimin e

³⁷ Edh-Dharijat: 55.

³⁸ El-A’la: 9-13.

³⁹ Merjem: 39.

shtazëve të përhapura.”⁴⁰

Megjithatë, njeriu indiferent dhe i pakujdesshëm, gjithnjë është në dyshim dhe në pasiguri.

All-llahu thotë:

“Por jo, ata (idhujtarët) janë në dyshim, janë duke luajtur (dhe duke u argëtuar).”⁴¹

Deri te bindja e fortë nuk do të vinë, përveç si thotë All-llahu:

“E sikur t’i shihje mëkatarët se si ulin kokat e veta pranë Zotit të tyre: »Zoti ynë tash pamë dhe dëgjuam, na kthe pra edhe një herë e të bëjmë vepra të mira, se tash jemi bindur.”⁴²

6. Gadishmëria e zemrës për ta kujtuar All-llahun.

Zemrat e pastërta dhe të shëndosha janë përherë të gatshme për ta kujtuar All-llahun dhe të ndieshme në ajetet e Tij, ndërsa zemrat e kafirave janë të pamëshirshme dhe të ashpra.

All-llahu thotë:

“Atij që All-llahu ia ka zgjeruar kraharorin për besim islam, ai është në një dritë të sigurt prej Zotit të vet. Të mjerë janë ata që nga zemërfortësia e tyre nuk përmendin All-llahun, të tillët janë në humbje të qartë. All-llahu e shpalli të folmën më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas here (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrënoqethen lëkurat e atyre që i kanë dronë Zotit të tyre, e pastaj me përkujtim ndaj All-llahut u qetësohen lëkurat dhe zemrat

⁴⁰ Exh-Xhathije: 3-4.

⁴¹ Ed-Duhan: 9.

⁴² Es-Sexhde: 12.

e tyre.”⁴³

Megjithatë, njerëzit me zemra të pamëshirshme dhe të ashpra, janë kryelartë, të neveritshëm, përherë i mohojnë ajetet dhe i injorojnë faktet.

All-llahu thotë:

“Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se ishin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me mendjmadhësi, pra shikojë se çfarë ishte fundi i shkatërrimtarëve.”⁴⁴

Dhe natyrisht, për kryelartësi dhe ashpërsi do të jenë të dënuar:

“Unë do t’i zbraps nga argumentet e Mia ata të cilët pa pasur të drejtë bëjnë kryelartësi në tokë,...”⁴⁵

Natyrisht, këtë e kanë në dunja, kurse në Ditën e Gjykimit shpërblimi i tyre do të jetë siç thotë All-llahu:

“E në ditën kur ata që nuk besuan paraqiten pranë zjarrit (e u thonë): ju i shfryëzuat të mirat në jetën e dynjasë dhe i përjetuat ato, e sot, për shkak se keni bërë mendjemadhësi në tokë pa të drejtë dhe për shkak se nuk respektuan urdhërat e Zotit, do të shpërbleheni me dënim nënçmues.”⁴⁶

7. Të pasuarit e Kur’anit dhe Sunnetit

Njeriu me zemër të pastër dhe të shëndoshë, përherë është i përlurur ndaj Zotit të vet dhe të Dërguarit të Tij savs, duke e formuar jetën e vet komplet në pajtim me

⁴³ Ez-Zumer: 22-23.

⁴⁴ En-Neml: 14.

⁴⁵ El-A’raf: 146.

⁴⁶ El-Ahkaf: 20.

Librin e All-llahut dhe Sunnetin e të Dërguarit savs, ashtu siç thotë All-llahu:

***“Besimtarët dhe besimtare të dashur për njëritjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë All-llahu. All-llahu është ngadhënjyes, i urtë.”*⁴⁷**

Ai shumë mirë, i kupton dhe iu përmbahet urdhërave të All-llahut, i Cili thotë:

***“O ju që besuat, bindjuni All-llahut dhe bindjuni të Dërguarit të Tij...”*⁴⁸**

***“...Çka t’ju jepë i Dërguari, atë merrnie e çka t’ju ndalojë, përmbanju dhe kini frikë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër.”*⁴⁹**

Andaj, nënshtrimi ndaj të Dërguarit savs në të vërtetë do të thotë nënshtrim ndaj All-llahut:

***“Kush i bindet të Dërguarit, ai i është bindur All-llahut...”*⁵⁰**

Njeriu me zemër të sëmurë e pason shejtanin e vet, i ndjek epshtet dhe ëndjet e veta dhe, veten e tij ia nënshtron të tjerëve përveç All-llahut. Ai për këtë shkak do të pendohet, por atë ditë, pendimi i tij aspak nuk do t’i bëjë dobi:

***“Ditën kur fytyrat e tyre do të përmbysen në zjarr e thonë: »Të mjerët ne, ta kishim adhuruar All-llahun e respektuar të Dërguarin!«.”*⁵¹**

⁴⁷ Et-Tewbe: 71.

⁴⁸ En-Nisa: 59.

⁴⁹ El-Hashr: 7.

⁵⁰ En-Nisa: 80.

⁵¹ El-Ahzab: 66.

Nëse zemrat tona kanë veçori fisnike të përmendura më parë, në këtë rast i takojnë grupit të njerëzve me zemra të pastërta dhe të shëndosha, nga të cilat mbijnë filizat e imanit, që rriten dhe japin fruta në formë të veprave të mira. Nëse nga zemrat tona nuk rrjedhin vepra të mira dhe fisnike, atëherë, kjo qartë tregon për atrofinë e drurit të imanit, i cili u rrit në zemrat tona, e i cili nuk është fisnikëri e veçorive të mira.

Gjendja jonë nuk do të ndryshojë, derisa të ndërmarrim masa për pastrimin e asaj që gjendet në zemrat tona:

“All-llahu nuk ndryshon gjendjen e një populli, përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre.”⁵²

I Dërguari savs ka thënë:

“Në trup gjendet një copë e mishit, e cila nëse është në rregull dhe e shëndoshë, në rregull dhe i shëndoshë është i tërë trupi, por, nëse nuk është në rregull dhe është e sëmurë, jo i rregullt dhe i sëmurë do të jetë i tërë trupi! E kjo (copë mishi) është zemra!”⁵³

Pastërtia dhe fisnikëria e zemrës mund të arrihet me forcimin e imanit dhe dominimin e tij në zemër!

⁵² Er-Rra’d: 11.

⁵³ El-Buhariu dhe Muslimi nga hadithi i Nu’mān b. Beshirit.

TË BESUARIT NË ALL~LLAHUN

Të besuarit në All-llahun është obligim i njeriut

Nëse njeriu mendon pak, ka për të parë që All-llahu, i Cili e ka krijuar, i dha mjete me ndihmën e të cilave mund të studiojë lloje të ndryshme të shkencave të dunjasë, pa të cilat nuk mund të arrinte asgjë nga dituria:

“All-llahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) që nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar, me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues.”⁵⁴

Falënderimin e parë që ia kemi borxh të Lartësuarit do ta shprehim duke i shfrytëzuar shqisat e njohjes të cilat na i dhuroi.

All-llahu thotë:

“Atëherë, dije se nuk ka të adhuruar tjetër pos All-llahut, kërko falje për mëkatin tënd...”⁵⁵

Derisa njeriu nuk e njeh Krijuesin e tij, ai nuk mund ta

⁵⁴ En-Nahl: 78.

⁵⁵ Muhammed: 19.

pasojë urdhërin e Tij, i cili e bën të lumtur në dunja dhe në Ahiret dhe për këtë është në një humbje të hatashme.

Andaj obligimi i parë i njeriut është që ta njohë Allahun e Lartësuar.

SHKENCA RRUGË PËR NË IMAN

Nëse njeriu dëshiron që ta arrijë imanin e rregullt, është i obliguar ta studiojë shkencën.

All-llahu thotë:

“A është i njëjtë ai që e di se ajo që t’u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën.”⁵⁶

Imani i atij i cili e imiton dikend tjetër, shumë shpejt, që në sprovë të parë dhe në problem të parë do të hamendet dhe lëkundet.

All-llahu thotë:

“...»A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?« Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.”⁵⁷

“Ka nga njerëzit që adhurojnë All-llahun me mëdyshje (luhatshëm) nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të mëparshme), ai e ka humbur dunjanë dhe Ahiretin, e ky është ai dështimi i qartë.”⁵⁸

⁵⁶ Er-Rra’d: 19.

⁵⁷ Ez-Zumer: 9.

⁵⁸ El-Haxhxh: 11.

ARGUMENTET SHKENCORE MBI TË BESUARIT NË ALL~LLAHUN

Principet logjike:

1. Ajo çka nuk ekziston - nuk mund të krijojë asgjë

Nëse diç nuk ekziston, ajo nuk është në gjendje të krijojë asgjë, sepse vetvetiu nuk ekziston.

Ajo çka ekziston

Nëse mendojmë mbi krijesat, të cilat çdo ditë vijnë në botë sikurse që është njeriu, kafsha, bima dhe nëse mendojmë mbi të gjitha fenomenet ekzistuese në botë, sikurse që janë: erërat, të reshurat, nata, dita dhe pandërprerë i vështrojmë lëvizjet e harmonishme të Diellit, Hënës dhe Yjeve dhe nëse mendojmë mbi të gjitha këto dhe ndryshime të akorduara me mençuri të cilat ndodhin çdo moment në botën ekzistuese, çdo moment, arsyeja jonë vie në përfundim të fortë, që të gjitha këto nuk janë të krijuara pa Krijues, por, këto janë krijime të All-llahut të Lartësuar, i Cili ekziston:

“A mos u krijuan prej kurrgjësë, apo ata vetë janë krijues? A mos ata krijuan qiejt e tokën. Jo, por ata nuk janë të bindur.”⁵⁹

2.Të menduarit mbi krijimin, na tregon mbi disa veçori të Krijuesit:

Çdo gjë që një send përmban, ose me çka dallohet, qartë tregon mbi aftësitë ose veçoritë e atij, i cili këtë send e ka prodhuar ose e ka bërë dhe prodhimi nuk mund të dallohet me diç, nëse prodhuesi ose ai i cili e ka bërë atë, nuk posedon aftësi ose veçori që ia mundësojnë që atë ta bëjë ose ta prodhojë.

Për shembull:

Nëse e shikon një derë të bukur të ndërtuar nga druri, do të arrish në përfundim që ai, i cili e ka ndërtuar atë derë, e posedon drurin, që ai mundet që atë dru ta përpunojë sipas nevojës, që posedon gozhda dhe që me ato gozhda mund t’i lidhë veç e veç disa pjesë të drurit dhe që ka eksperiencë në ndërtimin e dyerve.

Nëse i shikojmë në derë vrimat e shpuara me precizitet, sikurse vendin për dry dhe çelës, përfundojmë që mjeshtri me aftësi dhe shkathtësi e bën punën e vet.

Atëherë pra, e zbulojmë që çdo gjë na tregon për aftësitë dhe veçoritë e caktuara të atij që atë send e ka punuar, sepse është e pamundur që diçka të ekzistojë në atë send, e që prodhuesi i tij, të mos posedojë aftësi ose veçori që ia mundësojnë për ta bërë atë.

Ashtu, zbulojmë që të menduarit mbi atë send tregon mbi disa veçori dhe veti të prodhuesit të tij. Andaj dimë që të menduarit mbi krijesat na tregon mbi disa veçori të

⁵⁹ Et-Tur: 35-36.

Krijuesit.

“Për besimtarët ekzistojnë argumentet në qiej dhe në tokë. Për një popull që sinjerisht është i bindur ka argumente edhe në krijimin tuaj dhe në krijimin e shtazëve të përhapura. Edhe në ndërrimin e natës e të ditës, në atë furnizim që All-llahu e lëshon prej qiellit dhe me te, pasi të ketë vdekur e ngjall tokën; edhe në qarkullimin e erërave për një popull që logjikon ka argumente. Këto janë fakte të All-llahut që po t’i lexojmë ty në mënyrë të saktë; cilës fjalë pra, pos fjalës së All-llahut dhe argumenteve të Tij, ata i besojnë?”⁶⁰

Nëse mendojmë mbi krijesat, argumentet e All-llahut në to, do të na tregojnë mbi disa veçori të Krijuesit.

“Thua: »Vështroni me vëmendje çka ka (nga argumentet) në qiej e në tokë«. Po argumentet dhe qortimet nuk bëjnë dobi ndaj një populli që nuk beson.”⁶¹

“A nuk vështruan ata me vëmendje pushtetin e madh në qiej e në tokë dhe çka krijoi All-llahu prej sendeve, e edhe në atë se ndoshta u është afruar afati i tyre i vdekjes. Atëherë, cilës bisedë pos kësaj (Kur’anit) do t’i besojnë?”⁶²

⁶⁰ El-Xhathije: 3-6.

⁶¹ Junus: 101.

⁶² El-A’raf: 185.

El-Hajju, Ed-Daimu ~ i Përjetshëm

Ushqimin të cilin e hamë nuk dëgjon, nuk sheh, nuk lëviz, nuk zhvillohet, nuk merr frymë, nuk fle dhe nuk zgjohet, por kur ushqimi hyn në organizmin tënd, bëhet trup i gjallë, ndërsa dallohet me veçori të mëparshme. Rast i njejtë është me ushqimin e kafshëve, gjithashtu substanca e ujit, pluhurit tokësor dhe ajrit, me të cilat ushqehen bimët, nuk zhvillohen, nuk japin fruta, nuk marrin frymë dhe nuk ushqehen, por kur hyn në trupin e bimës shndërrohet në bimë të gjalla të ndryshme. Ky proces jetësor, i cili për çdo ditë dhe për çdo moment zhvillohet në çdo trup të bimës, kafshëve dhe njerëzve, dëshmon që krijesat, janë të Atij të Vetmit, i Cili është në gjendje të dhurojë jetë.

Njeriu është përpjekur që të krijojë jetë dhe çdo tentim i tij mbaronte me mospërfundim, ashtu që shkencëtarët e Lindjes dhe të Perëndimit e pranuan haptazi paafësinë e tyre në pikpamje të krijimit të jetës. Dhe me të vërtetë All-llahu e ka thënë të vërtetën, kur thotë:

“O ju njerëz, ja një shembull veni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuron në vend të All-llahut, ata nuk mund ta krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të, e po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata

nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është lutësi dhe i luturi. Ata nuk madhëruan All-llahun me madhërinë e Tij të vërtetë, që e meriton, All-llahu është i fuqishëm, ngadhënjyes.⁶³

Po. Njerëzit janë të paaftë për ta kthyer atë, çkado që na ka marrë mushkonja, sepse mushkonja posa e merr (atë) e lag me pështymë dhe, automatikisht e shndërron në diç krejtësisht tjetër, çka është e pamundur që ta kthesh më.!!

Jeta që është dhënë dhe e cila shfaqet përditë në qeniet e gjalla, nuk mund të krijohet pa të Përvetshmin dhe të Lartësuarin All-llah.

Vdekja e shemb çdo jetë, kur vie deri te shfaqja e shkaktarit, ndërsa, në shkaktarin e Krijuesit nuk mund të ndikojnë shkaqet. Ai është i Përvetshëm, i Cili nuk vdes.

All-llahu thotë:

“I Tij është pushteti në qiej e në tokë, Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje dhe Ai ka fuqi për çdo send.⁶⁴

“Ti mbështetju Atij të përvetshmit që nuk vdes kurrë,...”⁶⁵

⁶³ El-Haxhah: 73-74.

⁶⁴ El-Hadid: 2.

⁶⁵ El-Furkan: 58.

El-Alim ~ I Gjithdishmi

Nëse mendojmë mbi frutet në barkun e kafshëve, kemi për të parë se sytë u janë të krijuar në mitrat e nënave të tyre, ku mbretëron errësira e plotë, edhe pse dimë se sytë shohin vetëm në dritë. Çka na vërteton që Ai i cili krijon sy, e di që ato embrione do të dalin në botë, në të cilën ka dritë.

Gjithashtu shohim që krijimi i krahëve te zogjtë, zhvillohet në vezë, çka na vërteton se Krijuesi e di se këta zogj do të fluturojnë nëpër ajr, andaj ua krijon krahët para lindjes së tyre!

Dhe kështu shohim, që çdo krijesë, ende si embrion, gjatë krijimit merr atë, çka i përgjigjet rrethanave në të cilat do të jetojë.

Por edhe në embrionin e bimës-fara, All-llahu e jep pjesën nga e cila krijohen gjethet dhe degët, pjesën e cila nga toka do të thithë ujin, mineralet dhe kripërat, e të gjitha këto janë vepër e Atij, i Cili e di që bimëve do t'u duhej, uji, pluhuri tokësor, drita dhe ajri.

Kur e vështron krijesën e qenieve mashkullore, ke për të parë që Krijuesi e di numrin e tyre, andaj krijon numër përgjegjës të qenieve femërore, si kusht për vendosjen e bashkësive jetësore, çka na sjell qartë në përfundim që kjo

vepër është e All-llahut të Lartësuar dhe e të Gjithëdijsmit, i Cili thotë:

“Dhe Ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër) që ju të përkujtoni (madhësojnë e Zotit).”⁶⁶

Nëse uji i pijshëm nuk lëviz dhe nuk rrjedh, ai do të bëhet i amullt-pa shije, andaj për këtë arsye i Gjithëdijsmi detrat i ka bërë të njelmëta, e valët të lëvizshme ashtu që në rast të prishjes së ujit të detit, nuk do të vie deri te çrregullimi i jetës në tokë.

Këto, por edhe çdo gjë tjetër që është krijuar në Kozmos, vërteton që Krijuesit të këtij Kozmosi absolutikisht i janë të njohura të gjitha këto:

“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai dëpërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë.”⁶⁷

Dituria e All-llahut është gjithëpërfshirëse, Atij nuk i paraprinë padituria dhe as që në atë dituri mund të shfaqet harresa.

All-llahu thotë:

“All-llahu është Ai që krijoi shtatë palë qiej dhe prej tokës aq sa ata; në to zbatohet vendimi i Tij për ta ditur ju se All-llahu ka fuqi për çdo send dhe që me të vërtetë All-llahu ka përfshirë çdo send me dijen e vet.”⁶⁸

⁶⁶ Edh-Dharijat: 49.

⁶⁷ El-Mulk: 14.

⁶⁸ El-Talak: 12.

El-Hakim ~ Fisniku

Kur mendon mbi format e ndryshme të krijimit, gjen që Krijuesi i Lartësuar, çdo lloj krijon nga një mostër. Ashtu, te njeriu, sytë janë në fytyrë, e hunda në mes të dy syve, anash janë dy duar, kurse poshtë janë dy këmbë.

Kur nuk mund të hasësh, që syri të jetë përshembull mbi gju, ose dora në kokë, çka na flet qartë, që ky krijim është i Fisnikut, i cili krijimin e njeriut e bëri në mënyrë më të përkryer. Ashtu është me çdo lloj të kafshëve dhe të bimëve. All-llahu të gjitha i krijoi nga një mostër. E kush mund t'u ipte aq formë të përsosur, përveç Atij, i Cili thotë:

“Ai është që ju krijon (formon) juve në mitra ashtu si të dojë. S’ka Zot pos Tij, e që është Fuqiplotë dhe i Urtë.”⁶⁹

Mendo mbi ajrin të cilin e thithë, ke për të parë që ti harxhon oksigjen të pastër dhe e shndërron në ajr jo të shëndosh - *karbon dioksid* (CO₂), ndërkaq, sasia e ajrit nuk pakësohet, sepse Krijuesi e ka bërë që bimët ta kompenzojnë ajrin e pastër dhe të shëndoshë sakt sipas peshës së përcaktuar, duke e mbajtur gjithnjë në nivel të duhur, as nuk shtohet, e as nuk pakësohet. Po kjo, a nuk

⁶⁹ Ali Imran: 6.

dëshmon mbi fuqinë e krijimit të të Gjithëdijsmit dhe Fisnikut?!

Mendo mbi hundën tënde, ke për të parë, që është krijuar sakt, sipas funksionit të saj. Ajri hyn në dy zgavra në mes syve, por, Krijuesi Fisnik këto dy zgavra i ka mbuluar me hund, ashtu që pjesa e sipërme e saj është e eshtërt dhe ai (asht) këto zgavra i ruan nga shtypja e erës, e cila mund t'i mbyllte ato dy zgavra, për shkak të së cilës do të vinte deri tek çrregullimi i frymëmarrjes.

Ashti i hundës, gjithashtu merr pjesë në mbrojtjen e syve dhe në saje të këtij ashti, hunda është gjithnjë e hapur për hyrjen e ajrit.

Sikur hunda të ishte e tërë nga ashti, nuk do të kishim mundur që t'i qesim qyrat.

Krijuesi murin e hundës e ka bërë të pjerrtë, ashtu që ajri bie në atë zgavër të murit të hundës, e mandej ndalet në filtrat e hundës, të cilat janë të lagur me qyra, mbi të cilat ngjiten bakteriet dhe pluhuri dhe, në këtë mënyrë ajri pastrohet para se të hyjë në organizëm.

Gjatë dimrit, në hundë vie deri te rritja e sasisë së gjakut dhe, atëherë ajo duket e kuqe, e kjo është ashtu që ajri të jetë i ngrohur para se të hyjë brenda, ndërkaq, gjatë verës, kur ajri është i thatë dhe i nxehtë, hunda vetvetiu e kryen lagjen, zbutjen dhe ftohjen e ajrit. Po, të gjitha këto, A nuk flasin që kjo është vepër e të Gjithëdijsmit dhe Fisnikut?! Andaj, sikur të mendonim mbi të gjitha që janë të krijuara mbi tokë dhe në qiej, kemi për të parë, që të gjitha këto janë të krijuar në mënyrën më të përsour dhe më fisnike. Ndërsa fisnikëria e të krijuarit të çdo sendi, njeriut të arsyeshëm ia vërteton, që kjo vepër është vepër e Fisnikut dhe të Gjithëdijsmit, i Cili thotë:

“Ai është në qiell i adhruar dhe në tokë i adhruar, Ai

është i Urti dhe i Gjithëditshmi.”⁷⁰

El-Habiru ~ i njoftuar mbi çdo gjë

Nëse mendon mbi ushqimin tënd, se si nga toka dhe nga uji i njejtë, dalin fruta të ndryshëm me lloj-lloj ngjyra, do të vish në përfundim, që të gjitha këto janë vepër e Krijuesit me Eksperiencë, i Cili nga materia bazë, në mënyrën më të përsosur dhe fisnike, realizon lloje të ndryshme. Mendo mbi atë matricë, nga e cila, El-Habir e krijon mishin, gjakun, eshtrat, dhjamin, qumështin, lëkurën, qimet, flokët, gishtërinjtë, thonjtë, nervat dhe llangje të ndryshme. Analizojë fytyrën tënde, se si nga goja del pështyma, nga hunda qyrat, nga sytë lotët, nga veshi dylli, të gjitha këto janë sekrecione nga një materie. Krijimi i këtij sistemi, flet, që kjo vepër është e Krijuesit me Eksperiencë.

Si do të ishte, sikur pështyma të dilte nga hunda, qyrat nga goja, dylli nga sytë, kurse lotët nga veshët?! Po kush e krijoi këtë proces kaq të përbërë? Kush i programoi të gjitha këto vende? Po, a nuk është kjo vepër e të Gjithëditshmit me Eksperiencë dhe e të Gjithëditshmit, Fisnikut?!

⁷⁰ Ez-Zuhruf: 84.

Nga pikëza nga e cila është krijuar njeriu, Krijuesi Fisnik dhe me Eksperiencë, krijon organe të ndryshme, të renditura me precizitet dhe sisteme trupore të lidhura mes vete, ndërsa të gjitha këto në shërbim të funksionimit të organizmit të njeriut.

Peshkut në ujë i duhet ajri për frymëmarje, andaj Mëshiruesi, Krijuesi me Eksperiencë, ia siguroi oksigjenin përmes pikave të shiut që bien në ujë, te peshku krijoi sistem të posaçëm-verzat me ndihmën e të cilave e ndau nga uji oksigjenin e nevojshëm! Nëse pak më thellësisht mendon mbi krijesat në Kozmos, do të arrish në përfundim që këto janë rezultat i eksperiencës së jashtëzakonshme të krijimit dhe që këto janë vepër e Krijuesit të Gjithëdijshtëm.

Er-Rezak ~ Furnizuesi

Kur njeriu në mitrën e nënës ishte i mbështjellur me errësirë, askush nuk mund ta ndihmonte me asgjë, me ujë ose me ushqim, po bile as babai e as nëna në barkun e së cilës krijohej dhe formohej.

Megjithatë, mëshira e Er-Rezakut, përmes kërthizës ia siguroi ushqimin e gatshëm dhe të përpunuar, si furnizim. Kur fëmija vjen në botë dhe kur kërthiza i pritet, Er-Rezaku, ushqimin atij fëmiju ia siguron nga gjiri i nënës dhe e frymëzon, se në çfarë mënyre do ta thithë atë ushqim, edhe pse ende nuk sheh, nuk ndin dhe nuk mendon.

Mandej All-llahu, njeriun e furnizon me pemë dhe perime, të cilat ushqehen nga uji, pluhuri i tokës dhe ajri. All-llahu ua ekspozon Diellin bimëve, që të plotësohet prodhimi i ushqimit, i cili është i nevojshëm për njeriun dhe kafshët. Ushqim të tillë nuk do të kishte pasur, sikur All-llahu të mos jepte ujë të pijshëm, pluhur tokësor të pllëshëm për të mbjella, klimë të volitshme dhe kushte të tjera të përshtatshme dhe të nevojshme për prodhimin e ushqimit nga bimët.

All-llahu thotë:

“Njeriu le të shikojë ushqimin e vet. Ne lëshuam shi të

mjaftueshëm. Pastaj e çamë tokën sipas nevojës së bimës. Dhe bëmë që në të të mbijnë drithëra. Edhe rrush e perime. Edhe ullinj e hurma. Edhe kopshte të dendura. Dhe pemë e kullosa. Si mjete gjallërimi për ju dhe për bagëtinë tuaj.”⁷¹

Kur njeriu apo kafsha e han ushqimin, në sistemin për tretje, të cilin All-llahu ua krijoi çdo qenie të gjallë, vie deri te tretja e tij. Furnizuesi më i mirë këtë ushqim e shpie në çdo pjesë të trupit të qenieve të gjalla, pa marrë parasysh ku, në qendër të trurit, në sipërfaqe të lëkurës apo në brendësi të eshtrave.

All-llahu thotë:

“Kush është ai që ju ushqen, po që se Ai ua ndërpret furnizimin e vet? Jo, askush, por ata vazhdojnë me arrogancë e kundëvënie.”⁷²

All-llahu i madhërishtëm i ka garantuar furnizimin çdo krijese. Ashtu që i furnizon peshqit në thellësi të detit, i furnizon krimbat në brendësi të shkëmbinjve, Ai i sjell ushqim edhe embrionit në errësirën e mitrës dhe Ai i sjell ushqim bimës edhe në brendësi të farës.

All-llahu thotë:

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj, Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes). Të gjitha (këto) janë në librin e qartë.”⁷³

“O ju njerëz, përkujtoni të mirat që All-llahu u dhuroi! A ka ndonjë krijes tjetër përveç All-llahut që u furnizon juve nga qielli dhe toka? S'ka të adhuruar tjetër përveç

⁷¹ Abese: 24-32.

⁷² El-Mulk: 21.

⁷³ Hud: 6.

Tij, e si pra, e ktheni shpinën?”⁷⁴

Ai, i cili fortësisht është i bindur që furnizimi është i dhënë nga Krijuesi i tij, ai me siguri e di që furnizimin askush nuk mund t’ia marrë dhe për te nuk do të ketë frikë nga askush tjetër përveç se nga All-llahu.

⁷⁴ Fatir: 3.

El-Hadi ~ Udhëzuesi

Nëse i shikon qerpikët mbi kapakët e sipërm të syrit, ke për të parë se janë të kthyer përpjetë, ndërsa qerpikët e kapakut të poshtëm të kthyer teposhtë. Sikur të kishte qenë e kundërta, të pamurit e syrit kishte me qenë i çrregulluar! Po kush është ai, që udhëzoi dhe udhëzon çdo fije të qerpikëve të njeriut apo të kafshëve, përveç Atij, i Cili me të vërtetë udhëzon?!

Kush është ai, i cili dhëmbët e nofullës së poshtme, i udhëzon dhe i orienton për te nalt, kurse dhëmbët e nofullës së sipërme i orienton për te poshtë?! Kush është ai, i cili i krijoi dhëmbët e syrit mbi dhëmbët e syrit, dhëmbët mbi dhëmbët dhe dhëmballat mbi dhëmballat?! Kush? Përveç Atij.

“I cili krijoi dhe përsosi. Dhe i cili përcaktoi e orientoi.”⁷⁵

Kush e drejton çdo organ trupor në çdo trup të bimëve, kafshëve dhe njerëzve, që të gjenden në vende përkatëse në mesin e organeve të tjera dhe me pjesët e organeve të tjera ta kryejnë funksionin përkatës?!

Kush është ai që e drejton kokrrën e farës derisa mbinë

⁷⁵ El-A’la: 2-3.

dhe e shpërthen tokën, që gjatë rritjes së saj e drejton rrënjën e vet në tokë, ndërsa degët dhe gjethet mbi tokë? Si ashtu, asnjëherë nuk mund të hasim, që në një farë të zhvillohet procesi i kundërt?! Po kjo, a nuk e vërteton çdo njeri të vetëdijshëm, që të gjitha këto janë vepër e Atij, i Cili udhëzon?!

Kush është ai, i cili aq harmonishëm i krijon gjethet mbi drunj ose degët e një druri, ashtu që kur shfaqet gjethi në një anë, shfaqet edhe në anën tjetër?! Kush e udhëzon Diellin, Hënën, kush e harmonizon lëvizjen e yjeve, e drejton fluturimin e zogjve, deri te vendet e tyre të largëta?! Po a nuk është Ai i Cili udhëzon,

“I cili krijoi dhe përsosi. Dhe i cili përcaktoi e orientoi.”⁷⁶

I Cili e drejton qimën, kokrrën e grurit, gjethin e drurit, i Cili e përmbushi udhëzimin e njeriut, pastaj ia dërgoi të dërguarit dhe ia sqaroi rrugën e drejtë. Kush është fortësisht i bindur që All-llahu, Fisniku është Udhëzues. Ai nuk do ta pranojë asnjë ide që është në kundërshtim me udhëzimin e All-llahut. Ideja e tij përmbahet në fjalët e All-llahut:

“Thuaj, udhëzimi i All-llahut është udhëzim i drejtë.”⁷⁷

⁷⁶ El-A’la: 2-3.

⁷⁷ El-En’am: 171.

El-Hafidh ~ Mbikëqyrësi

Ai i cili të ruajti nga shumë rreziqe gjatë formimit tënd në barkun e nënës, është po ai i cili e ruan trurin aq të ndieshëm, në kafazin fortësisht të lidhur dhe të sigurt të kafkës. Ai gjithashtu me eshtrat e ballit i ruan sytë aq të ndieshëm, me ashtin e hundës e mbrojti gjithashtu zgavrën e hundës, ndërsa zemrën dhe mushkëritë i ruan në krahërorin e sigurt.

Ky është ai, i cili ta ruan jetën, t'i siguron kushtet e jetës, sikurse, ushqimin, ujin, ajrin, dritën, nxehtësinë dhe të tjera.

Ai nuk të detyroi ta fusësh ajrin në mushkëri ose ta lëshosh, për shembull, ta lëshosh në gjumë dhe kur je i zgjuar.

Sikur të të kishte obliguar, ti nuk kishe mundur të bësh asgjë tjetër, përveç futjes dhe lëshuarjes së ajrit. Nëse, ta zëmë, të zë gjumi, frymëmarrja do të të ndalej dhe do të të vinte vdekja.

Hafidh-Mbikëqyrës është ai i cili shtrin retë mbi kokën tënde, ashtu që shiu të mos bie me valë duke shkatërruar çdo gjë në tokë, por Ai e lëshon lehtaz. All-llahu thotë:

“Qieillin ua kemi bërë kulm të sigurt, por ata zbrapsen

prej atyre argumenteve.”⁷⁸

Hafidhi-Mbikëqyrësi, Tokën e ka mbështjellur me mbështjellës ajror (atmosferën), i cili e mbron jetën e njerëzve dhe i mbron qeniet e gjalla nga rrezatimi shkatërrues kozmik, i cili vie nga Dielli dhe yjet, duke e bërë këtë mbështjellës mburojë, si preventivë nga rrënja e meteorëve, të cilët çdo ditë dhe çdo natë me miliona bien në Tokë.

Ky është Ai, i Cili Tokën e përforcoi me male të larta, ashtu që nuk shkapërderdhet nën këmbët tona!

Andaj, a nuk do të jemi falënderues ndaj të Lartësuarit, i Cili na mbrojti-ruajti nga brenda, nga lart dhe nga poshtë:

“Ai (njeriu) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij, që me urdhërin e All-llahut e ruajnë atë.”⁷⁹

Kush është i bindur në atë që All-llahu është Ai që e ruan-mbron, atij nuk mund t’i sjellë dëm asgjë as nga qielli e as nga Toka. Bindja e tij rrjedh nga fjalët e All-llahut:

“Thuaj: »Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga All-llahu;...”⁸⁰

⁷⁸ El-Enbija: 32.

⁷⁹ Er-Rra’d: 11.

⁸⁰ Et-Tewbe: 51.

Veçori të tjera

Nëse mendon mbi një lloj ushqimi, për shembull, me të cilin ushqehet një familje. Ky ushqim në trupin e burrit e formon trupin e njeriut, në trupin e gruas i formon karakteristikat e gruas, ndërsa, në trupin e fëmijës, i formon vetitë dhe karakteristikat e fëmijës. Kur atë ushqim e ha maceja, ushqimi i formon vetitë trupore të macës, nëse e ha miu ose qeni, atëherë e formon trupin e miut respektivisht të qenit, edhe pse është në pyetje ushqimi i njejtë?!

Andaj, i Lartësuar qoftë Ai, i Cili krijesave u jep formën e dëshiruar.

Mendo mbi butësinë dhe ngrohtësinë e nënës, për mëshirën e saj ndaj foshnjës së vet, pa dallim mbi cilën nënë të qenieve të gjalla, ke për të parë sakrificë të jashtëzakonshme kur është në pyetje mbrojtja e foshnjës së saj.

Madje edhe pula, e cila i frikësohet zërit të thjeshtë të fëmijës, ke për të parë se si shakmisur e sulmon atë, i cili ia ngacmon zogjtë. Pikërisht ky rahmet-mëshirë, me të cilën janë të mbrojtura të gjitha krijesat e pafuqishme, dëshmon që është furnizim i Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Nëse mendon mbi madhësinë e krijimeve, siç janë

yjet, të cilët janë me miliona herë më të mëdhenj se sa toka dhe, pastaj mendon mbi krijesat më të imta, për shembull, të cilat në një pikë uji janë me miliona, pyete vetën:

Si është e mundur që të gjitha këto krijesa u janë nënshtruar një kontrolli, sistemi dhe rendi të vendosur me mençuri dhe precizitet?!

Pa dyshim që do të konkludosh se të gjitha këto janë vepra e të Fuqishmit dhe të Gjithëdijshtit, Krijuesit - Allahut svt.

NJËRI DHE I VETMI ALL~LLAH AZVXH

Ekzistimi i tërësishëm paraqet vërtetimin e llojit të vet, që vepra është e Njërit dhe të Vetmit All-llah svt. Ti e sheh, se ushqimi varet nga puna e lukthit dhe e zorrëve. Mjekët thonë që puna e zorrëve varet nga qarkullimi i gjakut, ndërsa roli i gjakut varet nga ajri dhe frymëmarja. Ajri i pastër për frymëmarje varet nga puna e bimëve, e cila, përsëri varet nga drita e diellit, ndërsa drita e diellit varet nga yjet dhe trupat e tjerë qiellor. Kështu zbulojmë që ekzistimi dhe funksioni i çdo gjëje varet nga gjërat tjera ose proceset sikurse që i kemi paraqitur më herët. Fakti që ekzistimi dhe funksioni i lukthit varet nga ekzistimi dhe funksioni i trupave qiellorë, tregon qartë, që të gjitha këto krijime janë vepër e një Zoti.

All-llahu thotë:

“All-llahu nuk ka marrë për Vete kurrfarë fëmije (as nga melaiket, e as nga njerëzit), nuk ka me Të ndonjë zot tjetër, pse (sikur të kishte zot tjetër), atëherë secili zot do të veçohet me atë që ka krijuar, dhe do të dominonte njëri mbi tjetrin! I lartë, i pastër është All-llahu nga ato

***që i përshkruajnë.*”⁸¹**

All-llahu gjithashtu thotë:

***“Thuaj: Ai, All-llahu është Një! All-llahu është Ai që çdo krijesë i drejohet (i mbështetet) për çdo nevojë. As s’ka lindur kë, as nuk është i lindur. Dhe Atij askush nuk i është i barabartë.*”⁸²**

Sikur të ekzistonin zotëra tjerë përveç All-llahut, mes tyre do të vinte deri te përleshja rreth udhëheqjes me krijesat, kurse kjo do të shkaktonte çrregullim të vërtetë mbi qiej dhe mbi Tokë.

All-llahu thotë:

***“Sikur të kishte në to (në qiej e në tokë) zota pos All-llahut, ato të dyja do të shkatërroheshin. Larg asaj që i përshkruajnë është All-llahu, Zot i Arshit.*”⁸³**

⁸¹ El-Mu’minun: 91.

⁸² El-Ihlas: 1-3.

⁸³ El-Enbija: 22.

KUSH ËSHË PRONAR I KËTYRE VEÇORIVE

Nga ato që përmendëm më lart, nëse mendojmë mbi Kozmosin dhe krijimet rreth nesh, vijmë në përfundim, se çdo gjë që ekziston, dëshmon qartë që të gjitha këto krijesa i krijoi: Krijuesi, i Përjetshmi, i Gjithëdijshti, Fisniku, mbi të gjitha i Lajmëruari, i Pafund, Furnizuesi, Udhëzuesi, Ai i Cili formon me përsosmëri, Mëshiruesi, i Gjithfuqishmi, i Forti, Njëri dhe i Vetmi All-llah svt. Sikur që i gjithë Kozmosi dëshmon dhe vërteton, edhe njeriu me gjithë Kozmosin, me vetëdije dhe fuqimisht i bindur, e vërteton këtë dëshmi duke thënë:

Me zemër besoj, me gjuhë shqiptoj dhe praktikisht vërtetoj që nuk ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet përveç All-llahut svt.

Nëse nga principi i parë mësuam që ajo që nuk ekziston, nuk mund të krijojë asgjë, ndërsa nga principi tjetër u njoftuam me disa veçori të Krijuesit, tani në bazë të principit të tretë do të bindemi, që këto veçori, nuk janë karakteristikë e askujt tjetër përveç All-llahut svt.

3. Nëse dikush nuk posedon diç, ai as nuk mund të ta japë atë

Ai që nuk ka të holla-para, njerëzit as nuk kërkojnë të holla nga ai, nga xhahilët - injorantët dija nuk vjen, sepse nëse dikush diç nuk ka, ai as nuk mundet të ta jap. Përmes të menduarit, pamë argumente dhe ajete mbi krijimet, të cilat na njoftojnë me veçoritë e Krijuesit të Lartësuar. Kur njihemi me veçoritë, do të njihemi edhe me bartësin e këtyre veçorive.

Ata që deklarojnë se i ka krijuar natyra, bien ndesh me arsyen dhe luftojnë kundër të vërtetës, sepse natyra dëshmon që Krijuesi i saj është Fisniku i Gjithëdijshmi, mbi të gjitha i Lajmëruari, Udhëzuesi më i mirë, Mbrojtësi, Mëshiruesi, Njëri dhe i Vetmi All-llah svt. Natyra nuk posedon asnjërën nga këto veçori, as dituri, as mençuri, as jetë, as mëshirë, as vullnet. Por, si atëherë xhahilët mund të dalin me tezë të këtillë, kur rregulla logjike thotë:

“nëse dikush diç nuk posedon, ai nuk mundet as të ta japë.”

Çka është në të vërtetë natyra?

Natyrën, me të gjitha veçoritë e saj, e përbëjnë të gjitha këto krijime. Idhujtarët, siç e kemi të njohur, i adhuronin disa pjesë të kësaj natyre, si për shembull: Diellin, yjet, zjarrin, gurët dhe njeriun. Idhujtarët e rinj - natyralistët, mendojnë, që të gjithë këta idhuj të mëparshëm, i ka krijuar natyra, edhe pse natyra nuk ka vetëdije, ndërsa ata (!) kanë!! Natyra nuk ka as dituri, ndërsa, ata kanë!!! Natyra nuk ka kurrfarë përvoje, ndërsa ata kanë përvojë, nuk ka vullnet, ndërsa ata kanë vullnet!

Po a nuk kuptojnë vallë, që nëse dikush nuk posedon

diç, ai nuk mundet as që të të japë (diç)!?

All-llahu thotë:

“O ju njerëz, ja një shembull, veni veshin pra: Vërtet ata që po i adhuronin në vend të All-llahut, ata nuk mund ta krijojnë asnjë mizë, edhe nëse tubohen të gjithë për të, e po ashtu, nëse miza ua rrëmben atyre ndonjë send, ata nuk do të mund ta shpëtojnë atë prej saj. I dobët është edhe lutësi edhe i luturi. Ata nuk madhëruan All-llahun me madhërinë e Tij të vërtetë, që meriton, All-llahu është i Fuqishëm, Ngadhnjyes.”⁸⁴

Dyshimi dhe përgjigjja

Disa ateistë pohojnë që natyra i ka krijuar krijesat, duke tentuar që këtë ta vërtetojnë me krijimin e krimbave, në plehërat e disa kafshëve dhe njerëzve. Ndërkaq, të arriturat shkencore kanë përparuar dhe ua kanë zbuluar, që krimbat që gjenden në plehëra, formohen nga vezët të cilat nuk mund t'i shohim me sy, por vetëm të zmadhuara me mikroskop, me çfarë u janë rrënuar pohimet e ateistëve. Ndërsa, ata prapë vijnë dhe thonë: Nëse krimbi krijohet nga krimbi i mëparshëm, nga vezët që nuk mund t'i shohim me sy, atëherë bakteriet, që e shkaktojnë kalbjen dhe prishjen e ushqimit, vijnë nga natyra, ato nuk janë krijuar nga bakteriet e mëparshme! Gjithashtu edhe ky pohim, është hudhur poshtë para më se tetëdhjetë vjetësh, kur hulumtuesit shkencorë e zbuluan mënyrën për ruajtjen e ushqimit nga kalbja dhe prishja. Në të vërtetë ushqimin e konzervonin në konzerva speciale, hermetikisht të mbyllura, në të cilat përmes nxehtësisë dhe rrezatimit, u janë asgjësuar bakteriet, çka njerëzve iu bë argument i

⁸⁴ El-Haxh: 73-74.

llojit të vet, që të gjitha krijesat formohen nga krijesat e mëparshme, ndërsa nuk lindin nga natyra, si pohojnë xhahilët-ateistët.

Asgjë e çuditshme, vëllau im, favorizuesit e ateizmit, i dinë fort mirë argumentet e para tetëdhjet vjetëve, por me këmbëngulje i përhapin marrëzitë e veta ateiste, të cilat mund të mbijetojnë vetëm në këtë mënyrë!!

PËRGJIGJA NË MASHTRIMET E TË KRISHTERËVE

Kur All-llahu e shpëtoi Isa-in assa, nga kurtha e armiqve të tij dhe e ngriti në qiej, ulemaja e mbetur krishtere ra nën terrorizmin Bizantin. Shumica e tyre u fshehën, ndërsa edhe shumica janë vrarë. Gjatë zhdukjes së ulemasë dhe gjatë fshehjes së Inxhilit të Isa-it assa, ishte përhapur padituri e madhe, ashtu që krishterët filluan t'i argumentonin gjërat, me inxhillët e trilluar dhe të imagjinuar.

Çdo autor, e shkruante emrin e vet në inxhilin, që dallohej prej inxhilëve tjerë, ashtu që erdhi deri te shfaqja e inxhilëve të numërt, sikurse: i Mateut, inxhili i Jovanit, Markut, Llukut, Bernabinit e të tjerë. Do të thotë se janë shfaqur më se shtatëdhjetë (70) inxhila të ndryshëm. Pastaj të krishterët, në një kongres, i kishin zgjedhur katër inxhila, kurse të tjerët i kishin djegur, duke deklaruar atëherë, që Zoti është i treti nga këta tre dhe që Isa-i është djali i Zotit!!

Ndërsa All-llahu është larg mbi të gjitha që ata flasin.

Mandej pas kësaj, kishin thënë: - Zoti është Një. Dhe filluan të besojnë në diç, çfarë arsyeja e shëndoshë kurr nuk mund ta pranojë, e kjo është që Zoti është Një dhe, që

në të njëjtën kohë ekzistojnë tre zotëra!!!

Gjithashtu kanë thënë: - që Zoti - Isa assa vdiq i kunguar (kryqëzuar), madje besojnë, që melaiket nuk vdesin dhe që Jehudët dhe Bizantinët e vranë Isa-në assa.

Në Inxhilët e tyre, pohojnë, që disa nga pasuesit e Mesihut⁸⁵, pas kungimit të tij, atë e kanë parë të gjallë! Ndërsa All-llahu thotë:

“Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan (nuk e kryqëzuan në gozhda), por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytën atë. Përkundrazi, All-llahu e ngriti atë pranë Vetes. All-llahu është i Plotëfuqishëm, i Dijshëm.”⁸⁶

Sa i përket pohimit të tyre, që Isa-i assa nuk ka baba, dhe që kjo sipas pohimeve të tyre është argument që All-llahu është babai i tij. Në këtë Kur’ani u përgjigjet:

“Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek All-llahu është sikurse çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: »Bëhu!« ai u bë.”⁸⁷

Mëtej All-llahu u shpjegoi, që Isa-i assa është njeri, i cili hante ushqim, ndërsa kush ha ushqim, ka nevojë biologjike! Po si atëherë dikush mund të bëhet Zot, kur i nënshtrohet domosdoshmërisë së marrjes së ushqimit dhe pijës, e me këtë edhe kryerjes së nevojave biologjike!?

All-llahu thotë:

“Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, vetëm se i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e

⁸⁵ sh.p. Mesih - quhet Isai assa.

⁸⁶ En-Nisa: 157-158.

⁸⁷ Ali Imran: 59.

drejtë (e ndershme). Që të dy ata ishin që ushqeheshin (si njerëzit tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj se si i kthejnë shpinën të vërtetës!”⁸⁸

I Cili e dëgjon lutjen e nevojtarit kur lutet

Secili njeri mund ta ndijë afërsinë e Zotit të vet, do të thotë, përmes plotësimit të duasë së njeriut. Sa herë njerëzit kanë dalur, që sinqerisht dhe pendueshëm, t’i luten All-llahut për shi, dhe plotësimi i lutjes së tyre, kryesisht direkt është realizuar. Shiu ra mbi katundin ose qytetin, banorët e të cilit kishin dalë t’i luteshin All-llahut për shi, ndërsa katundet dhe qytetet që ishin në afërsi të tyre kishin ngelur pa shi!

Se sa nevojtarë me lutje i kanë thyer fatkeqësitë e tyre:

“E kush është Ai që i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërret dhe ia largon të keqen, e juve ju bën mbizotërues të tokës. A ka zot tjetër pos All-llahut? Jo, por ju shumë pak përkujtoni.”⁸⁹

⁸⁸ El-Maide: 75.

⁸⁹ En-Neml: 62.

QËNDRIMI I KAFIRAVE, MBI PYETJEN E ARGUMENTEVE TË IMANIT

Argumentet mbi të besuarit në All-llahun, me të vërtetë janë numerikisht të shumta. Në të vërtetë, numri i tyre është në numrin e krijimeve, sepse çdo krijim tregon për veçorinë e Krijuesit. Ndërkaq, këto fakte, kafirëve as pak nuk u bëjnë dobi, sepse zemrat e tyre janë të sëmura dhe nuk janë të përgatitura për ta pranuar udhëzimin, sikur që është rasti me zemrat e besimtarëve, siç e pamë më parë. Dhe e shohim kafirin se si, përherë, i udhëheqë diskutimet e kota dhe të pabaza, mbi ajetet-argumentet e All-llahut dhe vazhdimisht sillet në kundërshtim me to.

All-llahu thotë:

“E ka ndonjë prej njerëzve që bën polemikë rreth çështjes së All-llahut, duke mos pasur kurrfarë dije, kurrfarë udhëzimi dhe kurrfarë libri të besueshëm.”⁹⁰

E shohim kryelartësinë e madhe të tyre, kundruall (ndaj) ajeteve të All-llahut.

“Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se ishin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me

⁹⁰ El-Haxh: 8.

mendjmadhësi,...⁹¹

I shohim se si të vërtetën e mbulojnë me të pavërtetën:

“E mos e ngatërroni të vërtetën me të pavërtetën dhe me vetëdije të fshihni realitetin.”⁹²

Ata (vazhdimisht) me këmbëngulësi tërhiqen nga rruga e All-llahut:

“Ata që nuk besuan dhe penguan nga rruga e All-llahut, ata kanë humbur shumë larg.”⁹³

Pasimi i verbër i kufrit

Karakteristika më e rëndësishme e kafirëve është, se ata i refuzojnë të gjitha argumentet e qarta mbi imanin, ndërsa kufrin e pranojnë pa kurrfarë argumenti, ata kufrin e pasojnë me verbëri të plotë.

All-llahu thotë:

“E kur ju thuhet atyre: »Ejani tek ajo që e zbriti All-llahu dhe te (çka thotë) i dërguari«, ata thonë: »Na mjafton ajo që i gjetëm prindërit tanë«, (a mjafton) edhe nëse prindërit e tyre ishin që nuk dinin asgjë dhe nuk ishin në rrugë të drejtë.”⁹⁴

Inicimi i gënjeshtreve dhe trillimeve

Si metodë për zbrapsjen e besimtarëve nga feja, është përdorimi i gënjeshtreve dhe i trillimeve të ndryshme, që kanë ndikim në ata, besimi i të cilëve është formuar mbi baza të xhehaletit-paditurisë dhe, të cilët nuk janë në gjendje të përgjigjen në këto gënjeshtër të ateistëve.

⁹¹ En-Neml: 14.

⁹² El-Bekare: 42.

⁹³ En-Nisa: 167.

⁹⁴ El-Maide: 104.

Për shembull: Ateistët sot e përsërisin atë, çfarë populli i Beni Israelit i thoshte Musait assa, siç na thotë Kur'ani:

“Dhe kur i thatë: »O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim All-llahun haptazi«,...”⁹⁵

Ndonëse ata besojnë në ekzistimin e arsyes intelektuale, në ekzistimin e ajrit, në gravitacionin e tokës, që tërheq çdo gjë kah Toka, besojnë në valët e radios, që nga largësia arrijnë deri tek ata, kurse asgjë nga këto nuk kanë parë, por padyshim që i kanë ndier gjurmët e arsyes në praktikën e mendimtarit, e shohin ndikimin e erës, që i luhet degët e drunjve, e ndiejnë fuqinë e gravitacionit të tokës, se si ata dhe gjërat tjera i tërheq kah Toka, e ndiejnë ndikimin e radiovalëve përmes zërave që lajmërohen në aparat dhe ata besojnë në ato arsye, besojnë në erë, fuqinë e gravitacionit të tokës dhe radiovalë. Besojnë pasi që i kanë ndier gjurmët e tyre të dukshme dhe ndikimin në natyrë.

Kur sytë, për shkak të dobësisë dhe kufizimit, janë të pafuqishëm për perceptimin e një sendi ose një dukurie, arsyeja ka aftësi për t'i njohur gjurmët dhe ndikimet e dukshme që shfaqen nga një send ose dukuri.

Sikur kafirët, me shqisat e të pamurit të kufizuar, të cilët nuk mund ta shohin ajrin, i cili i prek, e as çfarë ka pas perdeve të rëndomta, të mund të liroheshin nga mendjemadhësia dhe mashtrimi, e mandej të medoheshin pak, pa dyshim se do të vinin deri te përfundimi, që në të vërtetë, ata dhe çdo gjë në Kozmos, sikurse Toka dhe qiejt, nuk janë asgjë tjetër, përveç gjurmët dhe argumentet e qarta, të cilat tregojnë mbi Krijuesin e tyre të Lartësuar.

⁹⁵ El-Bekare: 55.

Të pamurit e kufizuar, nuk është në gjendje t'i regjistrojë yjet, të cilët paraqesin stolinë dhe zbukurimin e qiellit, **po si atëherë ta regjistrojë Atë, që është Sundues i Arshit?**

“E çka janë shtatë qiej në krahasim me Kursinë e Tij, po sikur shtatë dërhëmë në mburojën e kalorësit, po çka është Kursija në krahasim me Arshin e Tij, po sikur hallka në shkretëtirën e gjerë.”!

Nëse të pamurit e syve në këtë botë, nuk është në gjendje që të shikojë drejtpërdrejt në Diell, po si atëherë të jetë në gjendje të shikojë All-llahun?! (Të cilit asgjë nuk i gjason)!

Një herë, shumë më parë, Musai assa, kishte kërkuar që ta shohë Zotin e vet:

***“Kur u drejtua kah kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri atë (kodrën) thërmijë, e Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, tha: »E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti (për atë që kërkoja) dhe unë jam i pari i besimtarëve«!*”⁹⁶**

Të gjithë njerëzit, e në mesin e tyre, natyrisht edhe kafirët, i besojnë mjekëve, ekspertëve edhe profesorëve, kur ata i lajmërojnë mbi atë se çfarë kanë parë me sytë e tyre, sepse, këta ekspertë gëzojnë besim te dëgjuesit. Sikur kafirët të ishin liruar nga kryelartësia dhe mashtrimi, do ta njihnin Zotin e tyre, përmes të dërguarve të sinqertë, që vijnë me mu'xhize dhe argumente të ndryshme, çfarë i bënë njerëzit më të besueshëm në Tokë, të cilët flasin mbi Zotin e vet.

⁹⁶ El-A'raf: 143.

Kushtëzimi i të përgjigjurit në thirrje

Disa njerëz, të besuarit në All-llahun e kushtëzojnë me kërkesa të ndryshme, sikurse, për shembull, kur thonë: Nëse All-llahu dëshiron që të besojë në Të, le t'm'i plotësojë këto dhe këto (dëshira).

Kjo është e ngjashme me atë çka thonë kafirat, sikur që All-llahu për ta thotë:

“Ata thanë: »Nuk të besojmë ty derisa që të na nxjerrësh prej tokës burime. Ose, (nuk të besojmë deri që) të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh të rrjedhin vazhdimisht lumenj në mesin e tyre. Ose, (nuk të besojmë derisa) të bjerë mbi qiell copa - copa, ashtu si po mendon ti (se do të na dënojë Zoti), apo të na sjellësh All-llahun dhe melaiket pranë nesh«.”⁹⁷

Sikur All-llahu, rrugën e imanit ta bënte të varur nga shantazhet dhe nga kushtëzimet e njerëzve, me siguri që do të kishte të tillë, që të besuarin e All-llahut do ta kishin kushtëzuar me kërkesën që All-llahu natën ta bënte ditë, Diellin ta zëvendësonte me qiej, femra të bëhej mashkull e të ngjashme, po me siguri do të kishte pasur të tillë, që do të kërkonin të kundërtën! Dikush, i treti, të besuarin në All-llahun, do ta kushtëzonte me vrasjen e ndonjë personi të përcaktuar, ose me shkatërrimin e ndonjë vendi. Të katërtit, natyrisht do ta kishin kërkuar të kundërtën e kësaj. Atëherë me siguri që do të vinte deri te çrregullimi i vërtetë në qiej dhe në tokë.

All-llahu thotë:

“E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në

⁹⁷ El-Isra: 90-92.

to. ⁹⁸

All-llahu ka vendosur argumente të mjaftueshme në krijesat e Tij, na i ka krijuar veshët, sytë dhe zemrën, përmes së cilave njihemi me argumentet. Me këtë vendosen argumentet, e hudhen poshtë supozimet.

TË NJOHURIT E ALL-LLAHUT PËRMES CILËSIVE DHE EMRAVE TË TIJ TË BUKUR

Rëndësia e njohjes së emrave të bukur të All-llahut dhe cilësive të Tij

Nëse, për shembull, për dikend flitet se është fisnik dhe që posedon cilësi që të japë, kur dikush diç i kërkon, atëherë anojmë kah dhënia e tij, e respektojmë në vete dhe në rast nevojë shërbehemi me njohjen e cilësisë së tij. Ndërkaq, ndryshe do të ishte, sikur të dinim që ai është koprrac.

Nëse flitet që një qeveri ka pushtet të drejtë, që kujdeset për qytetarët e vet, dënon atë që i thyen ligjet dhe qetësinë publike, ke për të parë që njerëzit do të sillen në

⁹⁸ El-Mu'minun: 71.

mënyrë më të mirë, mënyra me të cilën do t'i shfrytëzonin shërbimet që ia ofron kjo qeveri, duke i respektuar principet e drejtësisë dhe ligjet e sistemit. Njerëzit këtë pushtet do ta duan në atë masë, aq sa ky pushtet dallohet me cilësi pozitive dhe natyrisht që do të kujdesen që veten e tyre të mos ia ekspozojnë dënimit dhe masave edukativo përmirësuese.

“E All-llahut i takon shembulli më i Lartësuar.”

Ai i cili i di cilësitë dhe emrat e bukur të Zotit të vet, rrethi i diturisë së tij zgjerohet deri tek Ai, në duart e të cilit janë pushteti i qiejve dhe i Tokës, ashtu që ai sjelljen e vet e harmonizon me njohjen e cilësive dhe emrave të bukur të All-llahut. E, sa u përket kafirëve, All-llahu për ta thotë:

“Ata nuk madhëruan All-llahun me madhërinë e Tij të vërtetë, që e meriton, All-llahu është i fuqishëm, ngadhënjyes.”⁹⁹

Kur’ani energjikisht paralajmëroi për shtrembërimin e emrave të bukur të All-llahut:

“All-llahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirrnie me ata e hiquni nga ata që bëjnë shtrembërime me emrat e Tij. Ata kanë për t’u shpërblyer (me dënim) për veprimet e tyre.”¹⁰⁰

Gjithashtu ka paralajmëruar për përshekrimin e All-llahut në mënyrë jo të denjë:

“All-llahu nuk ka marrë për Vete kurrfarë fëmije (as nga melaiket, e as nga njerëzit), nuk ka me Të ndonjë zot tjetër, pse (sikur të kishte zot tjetër), atëherë secili zot do të veçohet me atë që ka krijuar dhe do të dominonte njëri

⁹⁹ El-Haxh: 74.

¹⁰⁰ El-A’raf: 180.

mbi tjetrin! I lartë, i pastër është All-llahu nga ato që i përshkruajnë.”¹⁰¹

Shpallja ~ rrugë më e mirë, për kuptimin e veçorive dhe emrave të bukur të All-llahut

Dituria e njeriut mbi krijimet e All-llahut është jashtëzakonisht e kufizuar, andaj ai nuk është në gjendje që me diturinë e vet ta përfshijë All-llahun. Shtatë qiej në krahasim me **Kursin**, janë sikur shtatë dërhem në mburojë, ndërsa **Kursijja** në krahasim me Arshin është sikur hallka e hudhur në shkretëtirë.

“Mëshiruesi, mbi Arsh qëndron.”¹⁰²

Dituria jonë nuk është në gjendje ta regjistrojë madhësinë e yjve, të cilët janë stoli e qiellit, andaj me diturinë tonë, nuk jemi në gjendje ta përfshijmë All-llahun.

All-llahu thotë:

“...E nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursijja e Tij përfshin qiejt dhe tokën, kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i Larti, më i Madhi.”¹⁰³

Do të thotë, ne All-llahun nuk mund ta njohim ashtu si është dashur ta njohim, përveç me ndihmën e diturisë me të cilën Ai na dhuroi. Nga All-llahu na erdhi shpjegimi dhe dituria dhe ne e njohëm Atë me këtë dituri, përmes cilësive të Tij dhe emrave të bukur të Tij, të cilët i madhërojmë dhe me përluje i përmendim në përditshmëri.

¹⁰¹ El-Muminun: 91.

¹⁰² Ta Ha: 5.

¹⁰³ El-Bekare: 255.

Përsosmëria e All-llahut mbi krijesat

Kur thuhet, që ndonjë mbret është fisnik, që portieri i tij është fisnik dhe që fëmija i tij është fisnik, dëgjuesi pa dyshim do ta bëjë dallimin mes mbretit, portierit dhe fëmijës, pa marrë parasysh, që të gjithë i takojnë gjinisë njerëzore. Kur të thuhet që All-llahu është fisnik, ti padyshim do të kuptosh që fisnikërisë së All-llahut nuk mund t'i gjasojë fisnikëria e krijesave të varura dhe të dobëta të Tij. Ashtu është me të gjitha cilësitë e All-llahut të Lartësuar. Dituria e Tij nuk është si dituria e robit të Tij, Mençuria e Tij nuk është si mençuria e robit të Tij dhe as Mëshira e Tij nuk është si mëshira e krijesave të Tij dhe të ngjashme. Pra, në këtë dhe çdo gjë tjetër, shihet qartë përsosmëria e All-llahut me çka asgjë nuk mund të krahasohet.

All-llahu thotë:

“Asnjë send nuk është si Ai; Ai dëgjon dhe sheh (çdo gjë).”¹⁰⁴

Çdo gjë tjetër është e kufizuar, e Atij i takon përsosmëria e vërtetë!

¹⁰⁴ Esh-Shura: 11.

TË BESUARIT NË EMRAT E BUKUR TË ALL~LLAHUT DHE CILËSITË E TIJ, SIPAS KUR'ANIT DHE SUNNETIT

Për ne është shpërblim i madh nga All-llahu, që me mençurinë dhe me diturinë e Tij të pakufizuar, na mjaftoi me Vetën e Tij përmes Kur'anit dhe Sunnetit. Ashtu kuptuam që Ai ka emrat e Vet të bukur dhe cilësi të larta të përsosurisë dhe, askush nuk është në gjendje ta përshkruajë më bukur dhe më plotësisht All-llahun, se sa Ai që e përshkroi Vetën e Tij, sikurse që është e pamundur që dikush ta zvogëlojë rëndësinë e ndonjëres prej cilësive, me të cilat i Lartësuari e përshkroi Vetën e Tij.

Pamundësia e njohjes së qenies së All-llahut¹⁰⁵

Me ndihmën e argumenteve racionale dhe tradicionale kuptojmë që All-llahu është i ndryshëm nga krijesat e Tij. Andaj, është e domosdoshme që edhe cilësitë e Tij të janë të ndryshme nga cilësitë e Krijesave. Të gjitha krijesat kanë cilësi të kufizuara, ndërsa All-llahu i Lartësuar është i përsosur (i përkryer).

Nga Ai na arriti përshkrimi dhe shpjegimi, në bazë të së cilit besojmë në Të, ashtu si e përshkroi Vetën në Librin e nderuar dhe se si kanë ardhur në Sunnetin e të Dërguarit savs, pa parashtruar pyetje mbi esencën e Qenies.

All-llahu thotë:

“Ai është krijues i qiejve e i tokës. Ai nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte edhe nga kafshët krijoi çifte, ashtu

¹⁰⁵ Një anglez e kishte pranuar islamin para Shejh El-Hakimiut, mandej erdhi gruaja e këtij anglezi për ta shqyrtuar këtë rast dhe në diskutim e sipër, thoshte se si nuk i besonte All-llahut, përveç nëse kishte pasur mundësi ta shihte. Në këtë Shejhu me mendjemprehtësi e pyeti: “Po a e don ti burrin tënd?” - “E dua”-tha gruaja. “Por unë këtë nuk e besoj” - përsëriti Shejhu. “Si nuk më beson”-e habitur pyeti gruaja. “Nuk besoj kurrë, derisa ta shoh se çfarë dashurie është kjo, sa është e rëndë, çfarë ngjyre ka, sa është e gjatë dhe sa është e gjerë!” “Dashuria ekziston, por ne nuk mund ta shohim cilësinë e saj” - përfundoi gruaja krenare. Në këtë Shejhu me zë triumfues tha: “All-llahut i takon shembulli më i Lartësuar. Ne besojmë në Te, por Ai është larg mbi mundësitë tona të njohjes. Sa shumë gjëra ka, në të cilat besojmë, por nuk mund ta njohim cilësinë e tyre!? Na vie gjumi, por ne nuk dijmë se çfarë është dhe si ndodh ai. Gjithashtu realiteti, gëzimi dhe lumturia. E të mos flasim se sa njerëz nuk e dinë esencën e rrymës, e i besojnë asaj. Ashtu ndodh edhe me shumë gjëra!.

që t'ju shumojë. Asnjë send nuk është si Ai; Ai që dëgjon dhe sheh.¹⁰⁶

Ai të gjitha i dëgjon dhe çdo gjë sheh, por shqisa e Tij, nuk është si shqisa e krijesave. Të pamurit e Tij, nuk është si të pamurit e krijesave të Tij. Ne Atë nuk mund ta përfshijmë me diturinë tonë. Ai është i Përsosur dhe i Lartësuar.

Arsyeja dhe të kuptuarit e gjërave

All-llahu njeriut i dhuroi arsyen me ndihmën e së cilës e kupton esecën e gjërave, e dallon të vërtetën nga e pavërteta, dëmin nga dobia dhe kjo arsye është mjet i domosdoshmërisë së sheriatit-teklifit dhe kush e humb arsyen, nga ai do të ngritet penda, domethënë, që nuk i nënshtrohet obligimeve të sheriatit. All-llahu kësaj arsye i ka dhënë mundësi jashtëzakonisht të gjerë.

All-llahu në njeriun e krijoi potencialin me të cilin i kupton gjërat, Ai njeriut i ndihmon në perceptimin dhe rënditjen e këtyre gjërave, por, për t'i kuptuar gjërat, (sh.p. njeriu) është i kufizuar dhe i dobët. Për shembull, kur dikush e përshkruan një qytet, ti përfundon që në atë qytet ekzistojnë disa gjëra. Ti i parafytyron dhe mbi ta formon imagjinatë, ndërkaq, kur e sheh atë qytet, e vëren që duket ndryshe nga ai që e ke paraftyrar.

Sikur për shembull, kur dikush troket në derë, ti je në gjendje ta kuptosh që dikush trokiti në derë, por arsyeja e jote është e pafuqishme që ta njohë qenien e atij, që ka trokitur në derë. Kush është, sa është i gjatë, i gjerë, çfarë ngjyre ka, çfarë madhësie është dhe të ngjashme.

Do të thotë, që fuqia e arsyes depërtoi nëpër perden e

¹⁰⁶ Esh-Shura: 11.

derës dhe ti vetëm ke kuptuar që dikush ka trokitur në derë, ndërkaq, forca e të kuptuarit është e pafuqishme dhe për te dera është pengesë për ta përcaktuar.

“All-llahut i takon shembulli më i Lartësuar.”

Arsyeja beson në All-llahun, ndërsa forca e të kuptuarit është e pafuqishme që Ta njohë.

“Asnjë send nuk është si Ai; Ai është që dëgjon dhe sheh.”¹⁰⁷

Emrat e bukur

All-llahu ka 99 emra të bukur. Kush i mëson përmendsh do të hyjë në xhennet. Ai ka edhe emra të tjerë, që janë cekur në hadithe.

All-llahu në Kur'an thotë:

“All-llahu ka emrat më të mirë, andaj Atë thirrnie me ata....!”¹⁰⁸

Disa nga emrat e Tij të bukur janë: ***Një - El-Wahid, I Vetmi - El-Ehad, Ai, të Cilit çdo gjë i drejtohet - Es-Samed, Ai i Cili Vet-Vetiu ekziston dhe me ndihmën e të Cilit çdo gjë tjetër ekziston - El-Kajjum, Krijues - El-Halik, Ai, i Cili jep formë të përsosur - El-Musawir, Mëshiruesi - Err-Rrahman, i Gjithëmëshirshmi - Err-Rrahim, i Miri - El-Latif, Furnizuesi - El-Rezzak, i Cili me mëshirën dhe diturin e Vet, përfshin çdo gjë - El-Wasiru, i Madhi - El-Adhim, i Gjithëfuqishmi - El-Aziz, i Urti - El-Hakim, i Gjithëdijshtmi - El-Alim, Ruajtësi - El-Hafidh, Udhëzuesi - El-Hadi, i Cili jep jetë dhe vdekje - El-Muhji, El-Mumitu dhe, i Cili mbetet pas zhdukjes së krijesave - El-Warithu.***

¹⁰⁷ Esh-Shura: 11.

¹⁰⁸ El-A'raf: 180.

TË DËSHMUARIT QË MUHAMMEDI SAVS ËSHTË I DËRGUAR I ALL~ LLAHUT

Argumente të qarta mbi vërtetësinë e Muhammedit, savs, dhe Risaletin ~ Misionin e tij

All-llahu të Dërguarit e Vet i ndihmon me argumente të qarta, që flasin mbi vërtetësinë e shpalljeve të tyre, që njerëzit të mos i konsiderojnë të rrejshëm.

All-llahu thotë:

*“Ne i dërguam të dërguarit Tanë me argumente-
mu’xhize të qarta...”¹⁰⁹*

All-llahu Muhammedin savs e ndihmoi me argumente të qarta, ose më sakt e thënë, me Mu’xhize.

Argumenti Kur’anor ~ mu’xhiza

All-llahu mu’xhizen e Muhammedit savs e bëri të vazhdueshme, për t’i bindur njerëzit deri në Ditën e

¹⁰⁹ El-Hadid: 25.

Kijametit. Kur'ani është mu'xhiza më e fortë¹¹⁰ dhe All-lahu ka garantuar që atë do ta mbrojë nga shtrembërimet.

All-lahu thotë:

“A ai që është (i mbështetur) në argument nga Zoti i tij dhe atë e përforcon dëshmia nga Ai, e para tij (Kur'anit) ishte (dëshmitar) libri i Musait (Tewrati) që ishte udhërrëfyes e mëshirë - (është i njejtë me atë që ka për qëllim vetëm këtë jetë)? Të tillët (që janë në rrugë të drejtë) e besojnë atë (Kur'anin). E kush prej atyre grupeve refuzuan atë, vendi i tij është zjarri.”¹¹¹

Ky argument Kur'anor ka aspekte të veta, që e shpjegojnë mu'xhizën e Kur'anit, ndërsa këtu do t'i përmendim si vijon:

Të shqiptuarit e Kur'anit dhe madhështia e vazhdueshme e tij

Kur'ani përbëhet nga harfet - shkronjat, sikur që janë elif, ba, ta, tha. Të folurit e njeriut, gjithashtu përbëhet nga harfet e njejta, por stilistika e Kur'anit me superioritetin e vet, tregoi dobësinë (pafuqinë) e xhinnit dhe njeriut, që të bëjë, dhe të sjellë diç të ngjashme me surën më të shkurtër të Kur'anit.

Për shembull, kur dëgjon një ligjeratë bukur të përshtatur, ose një kaside - poezi të shkruar bukur, natyrisht që kjo të pëlqen dhe je i fascionuar, por shumë shpejt, gjatë persiatjes, kjo në shqisën tënde e humb vlerën, sepse nuk ekziston të folurit e njeriut, e që gjatë persiatjes, mos ta humbë vlerën e tij.

Megjithatë, muslimanët, sa muslimanët e mësojnë

¹¹⁰ sh.p. më e madhe.

¹¹¹ Hud: 17.

Fatihan apo ndonjë sure të shkurtër? Sa herë, lexuesi i Kur'anit, e bën hatme, sa herë e lexon Librin e All-llahut, e që asnjëherë nuk vëren që Fatiha-ja apo ndonjë sure tjetër është duke e humbur vlerën e saj!?

Çfarë na tregon kjo? Pa dyshim, ky fenomen i dëshmon çdo arsyeje që Kur'ani është fjala e All-llahut, vlera e së cilës asnjëherë nuk bie.

Përkundrazi, Kur'ani e thërret secilin që dyshon në vërtetësinë e tij, që ta formojë dhe ta sjellë bile edhe një sure të ngjashme me suret e tij.

All-llahu thotë:

“E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillne ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos All-llahut, nëse jeni të sigurtë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit). E mos e paqit bërë (deri më tash), e as që do ta bëni kurrë (edhe në të ardhmen), atëherë ruajuni zjarrit, lëndë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët.”¹¹²

Paraqitja Kur'anore e lajmeve (gjërave) të fshehta ~ gajbit

Gajbin - të padukshmën (të fshehtën) vetëm All-llahu e di, ndërsa Kur'ani na lajmëron mbi shumë gjëra të gajbit, çka është edhe argument, që Kur'ani është nga Ai dhe që Muhammedi savs, i cili njerëzve ua ka kumtuar Kur'anin, është i Dërguar i All-llahut. Nga këto lajme gajb, do t'i përmendim këto që do të pasojnë:

1. Në atë kohë, kur Persianët - adhuruesit e statujave,

¹¹² El-Bekare: 23-24.

ngadhnyen mbi Bizantinët - Pasuesit e Librit në Palestinë, mushrikët e Mekës, e festonin këtë fitore dhe iu kërcënuan muslimanëve, që do t'u ndodhë e njejta, gjë çka i brengosi muslimanët, pastaj All-llahu i shpalli fjalët që vijojnë:

“Elif, Lamë, Mimë. Bizantinët (rumët) u mundën, në tokën më afër (tokës së arabve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjejnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i All-llahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen, për ndihmën e All-llahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Gjithëfuqishëm, Mëshirues. Premtimi i All-llahut është (ky), All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, por shumica e njerëzve nuk po dinë.”¹¹³

Kur u shpallën këto ajete, muslimanët vazhdimisht i përsërisnin dhe e prisnin atë çka All-llahu u premtoi kafirëve, kurse Ebu Bekrit rda¹¹⁴ iu kundërvua një kafir duke vënë bast, që Bizanti nuk do të pësojë disfatë në kohën që e kanë caktuar ajetet Kur'anore me fjalët **“fi bid'i sinin”**, ndërsa kjo është periudhë kohore, mes tre deri dhjetë vjet, e jo më shumë. Ebu Bekri rda e pranoi bastin, para se të bëhej haram, ndërsa i Dërguari i All-llahut e toleroi. Kafirët qëndronin pranë kafirit që vuri bast, kurse muslimanët pranë Ebu Bekrit rda, duke e pritur realizimin e premtimit të All-llahut. Atëherë i Dërguari savs kishte thënë:

“Periudha kohore - El-Bid'u - është në mes tri deri nëntë vjetëve”.

Me këtë, misioni është vënë në provim. Megjithatë,

¹¹³ Er-Rrum: 1-6.

¹¹⁴ rda apo radijAll-llahu ‘anhu - domethënë: “All-llahu qoftë i kënaqur me të.”

arriti haberi-lajmi i All-llahut mbi fitoren e Bizantinëve.

Para kësaj, nuk ka pasur asgjë tjetër që do të kishte treguar mbi fitoren e tyre, kurse këtu madje është precizuar edhe koha, më pak se dhjetë vjet. Ky haber është paralajmëruar në formë, e cila nuk pranon kurrfarë supozimesh.

“Premtimi i All-llahut është (ky), All-llahu nuk e thyen premtimin e Vet, por shumica e njerëzve nuk po dinë.”¹¹⁵

Të gjithë kafirët e dinë, që Muhammedi savs është njeriu më i mençur dhe që veten e tij, nuk e kishte vënë në sprovë aq lehtë, sikur të mos ishte absolutikisht i bindur dhe i sigurt në Zotin e tij.

Andaj, nuk kaluan as shtatë vjet, e premtimi i All-llahut u realizua, besimtarët gëzoheshin, kurse, singeriteti i të Dërguarit erdhi në shprehje të plotë. Atëherë, numër i madh i njerëzve filluan të besojnë dhe ta pranojnë islamin, Dinin e All-llahut.

2. Shumë herë mushrikët dhe jehuditë tentuan të bënin atentat mbi të Dërguarin savs, gjatë luftave komplete të ndryshme, ndërkaq vjen Kur’ani dhe i premtonte të Dërguarit, që armiqtë e tij, kurrë nuk do të mund të arrijnë deri tek ai. All-llahu thotë:

“Përkujto, kur Ne të thamë: »Zoti yt ka përfshirë (me dijen e Vet) të gjithë njerëzit (e di që këta nuk besojnë edhe nëse ju sjellë mrekulli)«.”¹¹⁶

“O ti i Dërguar! Komunikojë atë që t’u zbrit prej Zotit tënd, e nëse nuk bën (kumtimin në tërësi), atëherë nuk e ke komunikuar misionin (revalatën-risalen). All-llahu të

¹¹⁵ Er-Rrum: 6.

¹¹⁶ El-Isra: 60.

garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve). ”¹¹⁷

Pas shpalljes së këtij ajeti, i Dërguari savs , as-habët - ruajtësit e vet i urdhëroi:

“O njerëz, lirisht mund të shkoni, All-llahu na garanton mbrojtje!”¹¹⁸

Dhe me të vërtetë kopmplotet ishin të shumta, por All-llahu, të gjitha i zbulonte dhe i shkatërronte, në pajtim me premtimin që e kishte dhënë. Tre halifet pas të Dërguarit savs kishin rënë shehid, edhe pse islami ishte forcuar, e kufri ishte dobësuar, edhe pse masat e sigurisë gjatë kohës së halifeve, ishin në të vërtetë në nivel të lartë, ndërsa gjatë kohës së të Dërguarit savs nuk ishin në atë nivel. Megjithatë, mbrojtja e All-llahut, në të cilën i Dërguari ishte absolutisht i bindur, për çka edhe i shpërndau ruajtësit e tij, ishte garancion më i mirë, për thirrje të papenguar në islam.

3. Të dërguarit vinin njëri pas tjetrit në Tokë, por pas shfaqjes së Muhammedit savs, dërgimi i tyre ndalet, në pajtim me fjalët e All-llahut:

“Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i Dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë të dërguarve, e All-llahu është i dijshëm për çdo send.”¹¹⁹

Ky është njëri nga lajmet gajb, të cilin e vërtetuan shekujt pas dërgimit të Muhammedit savs, të cilët dëshmojnë, që nuk ka të Dërguar pas ***“vulës së Lajmëtarëve të fesë”***

¹¹⁷ El-Maide: 67.

¹¹⁸ Hadithin e transmeton Ebu Hatimi, Ibn Xheriri, Tirmidhiu dhe El-Hakimi, dy të fundit tregojnë që hadithi është i besueshëm, por nuk e kanë radhitur në përmbledhjet e tyre.

¹¹⁹ El-Ahzab: 40.

Aspektet bashkëkohore-shkencore të mu'xhizës Kur'anore

All-llahu thotë:

“Ne do t’u bëjmë atyre të mundshme që t’i shohin argumentet tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa t’u bëhet e qartë se ai (Kur’ani) është i vërtetë. A nuk mjafton që Zoti yt është dëshmitar për çdo gjë?”¹²⁰

Premtimi i All-llahut u vërtetua në këtë shembull, kështu që kafirët, të cilëve, e vërteta e All-llahut dhe argumentet e Tij, nuk iu bënë të qarta-të dukshme, i kanë parë në dritën e krijimeve, përmes mjeteve precize teknike, sikurse që janë aeroplanët, nëndetëset, e të cilat njeriu deri në këtë shekull nuk i ka poseduar. Ky për ta është argument i llojit të vet, që All-llahu është Ai, i Cili Muhammedit s’ka ia zbulonte fshehtësitë mbi krijimin, në kohën kur nuk ekzistonin të arritura shkencore, aeroplanët, nëndetëset dhe të ngjashme. Ky ishte një fenomen i mu'xhizës Kur'anore, që kafirëve të sodit u tregon qartë mbi sinqeritetin e të Dërguarit s’ka, por me këtë edhe mbi sinqeritetin e këtij Dini. Disa shembuj mbi këtë:

1.-Askush, as nuk ka vërejtur që qiejt, yjet dhe trupat e tjerë qiellor, se janë formuar nga nebuloza (sh.p. mjegulla) - Ed-Duhan, derisa nuk përparuan hulumtimet shkencore dhe derisa ekspertët nuk i panë mbeturinat e nebulozës dhe u vërtetuan, që trupat qiellorë përbëhen kryesisht nga nebuloza deri në ditët e sotme. All-llahu thotë:

“Mandej e mësyu qiellin e ai ishte tym (mjegullinë që ishte si materie e parë) dhe atij e edhe tokës i tha: »Qasuni urdhërit Tim me dëshirë ose me dhunë!« Ato të

¹²⁰ Fussilet: 53.

dyja thanë: »Po i qasmi me dëshirë!«¹²¹

2.-Shkenctarët, mu tani kanë zbuluar që yjet (trupat) qiellorë edhe më tej formohen dhe që hapësira në mes tyre është e ndryshme, në bazë së cilës kanë ardhur në përfundim që qiejt vazhdimisht zgjerohen.

All-llahu thotë:

“Ne, me forcën tonë e ngritëm qiellin dhe Ne e zgjerojmë atë.”¹²²

3.-Shkenctarët më në fund kanë zbuluar që Hëna ka qenë e zjarhtë, mandej është fikur, kurse drita e saj është zhdukur. Ndërsa drita që vjen nga ajo në të vërtetë është reflektimi i ndriçuesit tjetër, e ky është Dielli.

All-llahu thotë:

“...e shenjën e natës e shlyem (e errësuam), e shenjën e ditës e bëjmë të ndritshme...”¹²³

Komentuesit e Kur'anit thonë që shenjë e natës është Hëna, kurse shenja e dritës është Dielli! Ibn Abbasi thotë: “Hëna është dritë si Dielli.” Mandej Kur'ani e përmend Hënën dhe ndriçimin e saj:

All-llahu thotë:

“I Madhërishëm është Ai që krijoi yje në qiell dhe vendosi në të kandil (diell) e Hënë që ndriçon.”¹²⁴

Shiko se si thotë All-llahu: “**siraxhen - kandil**”! Po sikur të ndriçonte Hëna do të kishte thënë, duke menduar edhe për Diellin e edhe për Hënën: “**siraxhejni - dy kandila**”!?

4.-Njerëzit mendonin se ai që fluturon mbi lartësitë,

¹²¹ Fussilet: 11.

¹²² Edh-Dharijat: 47.

¹²³ El-Isra: 12.

¹²⁴ El-Furkan: 61.

thith ajr të pastër, por kur njeriu shpiku aeroplanët bashkëkohorë dhe me ta fluturoi mbi lartësitë, erdhi në përfundim që krahërori në atmosferë jashtëzakonisht ngushtohet, sepse sa më lart që njeriu fluturon, ajri bëhet më i rrallë.

All-llahu thotë:

***“Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë, ia zgjeron zemrën për (të pranuar) islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur, zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë si të ngjitej në qiell.”*¹²⁵**

5.-Askush nuk mund të paramendonte që malet janë mbjellë në Tokë sikurse shtyllat, për të zbuluar shkenctarët, që nën shtresën e fortë të Tokës mbi të cilën jetojmë, ekziston një shtresë e butë e shkrihtë, por edhe që nën secilin mal ekziston rrënja e cila sharron në këtë shtresë, ashtu që kjo e lidh me shtresën e sipërme të fortë, mbi të cilën jetojmë dhe e mbron nga lëkundjet nën ne, për shkak të butësisë nën ne.

All-llahu thotë:

***“Dhe në të (tokë) Ne kemi krijuar bjeshkë të paluhatshme që të mos i lëkundë ata...”*¹²⁶**

6.-Shkenctarët kanë vërtetuar, që gjatë të reshurave bimët rriten, kurse bimët krijojnë klorofil, material me ngjyrë të gjelbër, nga e cila krijohen sythët dhe frutat.

All-llahu thotë:

***“Ai është që lëshoi nga lart shiun e me të nxori bimën e çdo sendi dhe prej bimës gjelbërim dhe prej tij (prej gjelbërimit) kokrra të dendura në kallinj.”*¹²⁷**

¹²⁵ El-En’Am: 125.

¹²⁶ En-Enbija: 31.

¹²⁷ El-En’Am: 99.

7.-Hulumtuesit kanë zbuluar, që te të gjitha bimët ekzistojnë çifte-mashkullore dhe femërore, e që këtë askush nuk e ka ditur më herët.

All-llahu thotë:

“I pastër nga të metat është Ai që krijoi të gjitha çiftet nga ajo që nxjerr toka dhe nga vetë ata, dhe nga ajo që ata nuk dinë.”¹²⁸

8.-Shkenctarët e mjeksisë kanë zbuluar, që nervat përmes të cilëve e ndiejmë dhëmbjet nga të djegurit ose nga të ftohtit, gjenden vetëm në lëkurë, sikur që edhe nervat e tjerë të ndieshëm gjenden kryesisht nën lëkurë.

Ashtu, njeriu ndien dhëmbje nga gjilpëra mjekësore vetëm derisa të shpohet shtresa e lëkurës, kurse kur kalon në indin muskolor dhembja pushon.

Kur`ani kaherë ka shpjeguar në fjalët e All-llahut të madh, që dhembja nga djegiet ndihet vetëm në lëkurë:

“Është e vërtetë se ata që mohuan argumentet Tona, do t’i hudhim në zjarr. Sa herë që u digjen lëkurat e tyre, Ne ndërrojmë lëkura të tjera që të shijojnë dënimin. All-llahu është i Plotëfuqishëm, i Drejtë.”¹²⁹

9.-Hulumtuesit gjithashtu kanë zbuluar që qumështi te shtazët, krijohet nga përbërja e lëngut të ushqimit të përpunuar në lukth, pasi që mënjanohe mbeturinat e forta, të cilat dalin në forma të plehërave dhe të ngjashme. Nga lëngu i cili ka mbetur, materia ushqyese hyn në gjak, mandej përmes gjakut ushqehen gjëndrat qumështore, që prodhojnë qumësht.

All-llahu thotë:

“Ju edhe në kafshët keni mësim (përvojë). Ne nga një

¹²⁸ Jasin: 36.

¹²⁹ En-Nisa: 56.

pjesë e asaj që kanë në barqet e tyre mes ushqimit të tyre dhe gjakut, ju japim të pini qumësht të pastër, të shijshëm (të lehtë) për ata që e pinë.¹³⁰

10.-Njerëzimi për shembull, nuk ka ditur që në det përkrah valëve sipërfaqësore, ekzistojnë edhe valët e brendshme. Njerëzit nuk kanë ditur, që në thellësitë e detit ekzistojnë errësirat, mandej All-llahu peshqve ua krijoi dritat që u bëjnë dritë në ato errësira. Dhe askush nuk ka ditur, që valët me sipërfaqet e veta të përdredhura e absorbojnë dritën që bie mbi to nga lart, duke e krijuar kështu errësirën, sikur që retë i pengojnë rrezet të depërojnë nga lartë - poshtë, Ndërkaq të gjitha këto fshehtësi All-llahu i ka përmendur vetëm në një ajet Kur'anor.

All-llahu thotë:

“Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë, të cilin e mbulojnë valët mbi valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Atij të cilit All-llahu nuk i jep dritë, ai nuk ka për të pasur dritë.”¹³¹

Këto dhe fshehtësitë e tjera, në thellësitë qiellore dhe detare, në thellësitë tokësore, në brendësitë e kafshëve, në brendësitë e bimëve dhe përsosmërisë së organizmit të njeriut, njeriu zbulon dhe mu tani kupton, në kohën e tashme, pasi që i shpiku pajisjet dhe aparatet më të përsosura, përmes së cilave arrin të zbulojë dhe të njihet.

Kush këto fshehtësi ia zbuloi Muhammedit savs para më se një mijë e katërqind vjetëve, kur nuk ekzistonin aeroplanët, raketat, nëndetëset dhe zbulimet shkencore?!

¹³⁰ En-Nahl: 66.

¹³¹ En-Nur: 40.

Të gjitha këto njeriut të arsyeshëm, që jeton në Amerikë, Rusi, Indi, Kinë, Evropë apo Australi, i tregon qartë, që Kur'ani është shpallje nga All-llahu i Gjithëdijshmi, që thotë:

“Thuaj: »Atë e shpall Ai, që e di të fshehtë në qiej e në tokë,...”¹³²

që tregon qartë, se Muhammedi savs është i Dërguari i All-llahut.

SHENJAT E DITËS SË KIJAMETIT

All-llahu thotë:

“Ai është që e di të fshehtë, por fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt. Me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do...”¹³³

Të paralajmëruarit e Muhammedit savs për parashenjat e Ditës së Kijametit, lajmtarët e së cilës shfaqen mu në këtë kohë, janë argument të vërtetësisë së dërgimit (Risaletit), vërtetësisë së Ditës së Kijametit dhe afërsisë së saj. Parashenjat që tanimë janë shfaqur apo shfaqja e tyre vërehet, janë:

¹³² El-Furkan: 6.

¹³³ Exh-Xhinn: 26-27.

1. Ngjarjet e mëdha që deri më tani askujt nuk i kanë rënë ndërmend:

Këto çudira dhe ngjarje të mëdha, që kanë ndodhur dhe që edhe më tutje do të ndodhin, në pikpamje të zbulimeve të mëdha të ndryshme, në botën politike, sistemeve shoqërore, të shkencës, mandej ngjarjeve botërore, të cilave u përgjigjet titulli **ngjarjet e mëdha**, e të cilat më herët as ndërmend nuk u kanë rënë, qofshin ato të lidhura për gjendjen e muslimanëve apo kafirëve, për gjeneratat e mëparshme ishin të pakuptimta. Këto na i ka paralajmëruar Muhammedi savs me fjalët.

“Dita e Kijametit nuk do të paraqitet, derisa nuk do t’i përjetoni ngjarjet, të cilat deri më tani nuk i keni përjetuar dhe as që ju janë kujtuar ndonjëherë.”

2. Kur të zhveshurit dhe të zbathurit dhe barinjte e varfër bëhen të pasur dhe kur ata do të garojnë në ndërtim

Njeriu i zbathur që nuk ka çfarë të mbathë, i zhveshur që nuk ka çfarë të veshë, i varfëri që varet nga tjetri dhe ai i cili nuk ka çfarë të punojë përveç të bëhet bari, është e paparamenduar që një ditë do të vijë në një situatë, që të bëhen të pasur dhe që do të garojnë në ndërtimin e shtëpive të mëdha dhe luksoze edhe pse kjo nuk i ngjan një individi, por grupeve të shumta të të varfërve, të zhveshurve, të zbathurve, më parë ka qenë e paparamenduar, por megjithatë kjo ngjan. Pasiqë All-llahu muslimanëve dhe të tjerëve u dha zbulime të pasura tokësore, e para së gjithash naftën, kemi parë se si shumica e të zhveshurve, të zbathurve, barinjve të uritur dhe të varfër, fillojnë të bëjnë gara në ndërtimin e ndërtesave të

mëdha dhe luksoze, sikurse që na ka paralajmëruar i Dërguari i All-llahut duke shpjeguar që të gjitha këto janë parashenja të Ditës së Kijametit me fjalët:

“Kur sheh, që të zhveshurit të zbathurit, të varfërit dhe barinj të bëjnë gara në ndërtimin e ndërtesave, prite Ditën e Kijametit.”¹³⁴

3. Shfaqja e femrave të zhveshura, në mënyrë provokuese, lakuriqe dhe mashtruese, kokat e të cilave janë sikurse gunga e devës

Vështirë është ta kuptosh gjendjen e grave, të cilat do të paraqiten në gjeneratat e fundit, e të cilat i Dërguari i All-llahut i përshkruajti që në të njejtën kohë do të jenë të veshura por lakuriqe (të zhveshura)?! Njeriu ishte pak i habitur se si, gruaja mundet që në të njejtën kohë të jetë e veshur por e zhveshur?! Ndërkaq, përgjigjen e gjejmë tani, në kohën tonë. Gruaja mund të jetë e veshur, por vesha e saj mund të jetë e ngushtë dhe e tejdukshme, ashtu që trupi shihet dhe pasqyrohet. Disa pjesë të trupit mund t'i mbulojë, por disa mund t'i lë me qëllim të zbuluara. Janë të përshkruara si ***provokuese dhe mashtruese***. Ndërsa provokimi mund të bëhet duke ecur, me trup, me veshje dhe mbathje.

Si mund ta shpjegojmë bartjen e këpucëve me take jashtëzakonisht të larta, pos si dëshirë për t'ia tërhequr vëmendjen dikujt!?

Kokat e tyre janë sikurse gunga e deve: sikur gungat që janë shumë të shprehura dhe të vërejtura, çfarë shohim

¹³⁴ Buhariu dhe Muslimi.

në kohën tonë, ngjashëm me fjalët e të Dërguarit savs të cilit All-llahu ia zbuloi këtë gajb-fshehtësi ende para njëmijë e katërqin vjtëve.

“Dy lloje nga Ummeti im do të jenë banorë të xhehennemit, e të cilët nuk i kam parë; Ata të cilët kanë kamxhik të ngjashëm me bishtin e lopës dhe me të cilët i rrahin njerëzit, duke u shkaktuar padrejtësi dhe zullum dhe, gratë e veshura në mënyrë provokuese dhe lakuriqe, të cilat do të mashtrojnë dhe do të jenë të mashtruara ndërsa kokat e tyre do të jenë të ngjashme me gungën e deveve, ata nuk do të hyjnë në xhennet dhe as që do ta shijojnë erën e tij.”¹³⁵

4. Të folurit e gjërave

I Dërguari savs kishte thënë:

“Njëra nga parashenjat e Ditës së Kijametit është edhe kjo; që kur njeriu del dhe para se të kthehet, të mbathurat dhe kamxhiku i tij do të lajmërojnë mbi atë se çfarë kanë bërë familja e tij gjatë mungesës së tij.”¹³⁶

Të mbathurat do të jenë gjëra sikurse kamxhiku. Askush nuk ka mundur të paramendojë që këto gjëra do të flasin. Por këto me të vërtetë kanë folur! Ndërkaq, çfarë është të folurit e të mbathurave dhe kamxhikut, që e lajmërojnë njeriun mbi atë se çfarë ka bërë familja e tij gjatë mungesës së tij?

Në të vërtetë, sot janë shpikur mikro instalime, të cilat njeriu i bart me vete në dorë dhe këto mikroinstalime i

¹³⁵ Hadithin e transmetojnë Ahmedî dhe Muslimi.

¹³⁶ Hadithin e transmeton Ahmedî në Musenedin e tij, Tirmidhiu dhe Hakimi, i cili thotë se hadithi është sahih - i vërtetë në bazë të kushteve të Muslimit.

transmetojnë zërat dhe bisedat nga shtëpia e tij ose ndonjë shtëpi tjetër dhe tani nuk ka mbetur asgjë tjetër pos që këto instalime të bëhen në formë të kamxhikut për shkak të bartjes së tij më të lehtë, ose me shkathtësi të kamufllohet në këpucët e tij, por ndoshta edhe në majë të shkopit, ashtu që shumë vështirë mund të vërehet!

5. Zhdukja e diturisë, termete të shpeshta, të afruarit e kohës, shfaqja e fitnës-ngatërresave dhe ndërtimi i rrokaqiejve

Zhdukja e diturisë është pasojë e vdekjes së ulemave, të cilët nuk do të ketë kush t'i trashëgojë. Këtu mendohet për ulematë islam çfarë edhe na tregon hadithi.

Sa i përket *tërmeteve të shpeshta*, ne jemi dëshmitarë të përditshëm të këtyre tërmeteve dhe fuqisë së tyre shkatërrimtare.

Shkurtimi i kohës, do të thotë që ditët do të kalojnë shpejt sikurse orët. Shkaktarë i kësaj janë ngjarjet e ndryshme, të cilat te njeriu do të krijojnë ndjenjë të shkurtimit të kohës - e All-llahu më së miri e di dhe kur njeriu është duke punuar diç, ora shpejt kalon sikur të ishin minuta, e nëse është i papunësuar atëherë e ndjen bezdi dhe dita i duket shumë e gjatë. Koha jonë është e përmbushur me veprime të shumta dhe me dinamikë, e pasojë e kësaj është preokupimi i njeriut ashtu që nuk e lejon të merret me Dinin e vet, gjithashtu shfaqja e ngatërresave do të jetë në shërbim të realizimit të interesave personale.

Ndërtime të mëdha - na mjafton t'i krahasojmë shtëpitë e para pesëdhjetë viteve, me shtëpitë e kohës sonë dhe të bëjm dallim, e për çfarë na paralajmëroi i Dërguari i All-llahut me fjalët:

“Dita e Kijametit do të paraqitet me zhdukjen e diturisë, me tërmete të shpeshtuara, me shkurtimin e kohës, me shfaqjen e fitneve dhe në garimin e njerëzve në ndërtimin e ndërtesave jashtëzakonish të mëdha.”¹³⁷

6. Të përshëndeturit e njerëzve të veçantë, tregtia masovike, shkëputja e lidhjeve fisnore, leximi i jashtëzakonshëm dhe dëshmia e paarsyehme-e rrejshme

Duke i përshëndetur vetëm personat e caktuar, njerëzit do të bëjnë dallim mes tyre. Do të vijë deri te përhapja e madhe e tregtisë dhe deri te përdorimi i madh i lapsit, me çka aludohet në atë se njerëzit do të lexojnë dhe do të shkruajnë shumë. Të gjitha këto janë të përmendura në hadithin e të Dërguarit të All-llahut i cili thotë:

“Shenja (të afërta) jo të largëta të Ditës së Kijametit janë: të përshëndeturit e njerëzve të veçantë, përhapja e jashtëzakonshme e tregtisë, ashtu që gruaja do të jetë e obliguar që t'i ndihmojë burrit në punë, ndërprerja e lidhjeve fisnore, përdorimi i shpeshtë i lapsit, shfaqja e dëshmisë së rrejshme dhe shtrembërimi i dëshmisë së vërtetë.”¹³⁸

7. Shfaqja e zinasë ~ imoralitetit dhe përdorimi i madh i alkoolit

I Dërguari i All-llahut s'ka thënë:

“Parashenjat e ditës së Kijametit janë: - zhdukja e diturisë, dominimi i xhehaletit - mosnjohja e Dinit,

¹³⁷ Hadithin e transmeton El-Buhariu.

¹³⁸ El-Buhariu.

përhapja e zinasë dhe përdorimi i madh i alkoolit.”¹³⁹

8. Të marrurit me kamat

I Dërguari i All-llahut ka thënë:

“Njerëzit do të përjetojnë kohë të tillë, që të gjithë do ta hanë kamatën. Po nëse dikush kujdeset-ruhet që mos ta hajë, bile pluhuri i saj do ta prek.”¹⁴⁰

Edhe pse ekzistojnë bankat islame që nuk merren me kamatë, ndër muslimanët, marrja me kamatë është shumë e përhapur. I lutemi All-llahut që të na ndihmojë që të hapim sa më shumë banka islame dhe të ruhem nga ky haram i rëndë.

9. Të përshëndeturit me mallkime dhe imitimi reciprok i femrës dhe i mashkullit

Islami na urdhëron të përshëndetemi bukur dhe përshëndetjen ta shkëmbejmë edhe më bukur. Muslimanët i përmbaheshin gjithnjë kësaj, derisa njerëzit në kohën tonë nuk filluan të përshëndeten me mallkime.

I Dërguari i All-llahut ka thënë:

*“Ummeti im do të ketë gjithnjë sistem të mirë, derisa nuk shfaqen tri (gjëra) - zhdukja e diturisë, shfaqja e kopilëve - fëmijëve jashtë martese dhe shfaqja e të mallkuarve!”
E kush janë të mallkuarit? - pyetën të pranishmit. “Ata janë njerëzit që do të shfaqen në kohën para Kijametit dhe do të përshëndeten me mallkime.”¹⁴¹* - U përgjigj i Dërguari i All-llahut.

Vështirë që dikush do ta paramendonte kohën që do të

¹³⁹ El-Buhariu dhe Muslimi.

¹⁴⁰ Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe.

¹⁴¹ Hadithin e transmetojnë Ahmed, El-Hakimi dhe Taberaniu.

vijë, koha kur meshkujt do t'i imitonin gratë dhe e kundërta, deri sa nuk na befasoi koha jonë me këtë fatkeqësi. Ndërkaq i Dërguari savs të gjitha këto i lajmëroi me fjalët:

“Parashenja e Ditës së Kijametit do të jetë, kur meshkujt do të fillojnë t'i imitojnë femrat dhe femrat fillojnë t'i imitojnë meshkujt!”¹⁴²

10. Grupi i rrugës së drejtë

Sado që shfrenimi dhe çrregullimi janë dominante, fisnikëria e All-llahut ka dëshiruar që një grup të luftojë për të vërtetën, me argumente të thërras në Dinin e All-llahut dhe fortësisht-fuqimisht t'i përmbahet Librit të All-llahut dhe Sunnetit të Dërguarit savs çka edhe qartë vërehet sot.

Gjegjësisht nuk ekziston vend, e që në te të mos ekzistojë dikush, i cili vazhdimisht dhe me këmbëngulje lufton për Dinin e All-llahut dhe i përmbahet fortësisht Librit (Kur'anit) dhe Sunnetit. Për të tillët i Dërguari i All-llahut thotë:

“Në ummetin tim, çdoherë do të ekzisojë një grup, i cili do të luftojë për të vërtetën, e të cilit (grup) nuk mund t'ju bëjnë dëm ata të cilët dëshirojnë ta përulin gjithnjë derisa të vijë emri-urdhëri i All-llahut.”¹⁴³

Dhe në fund kjo është vetëm diç nga ajo mbi çfarë na lajmëroi i Dërguari i All-llahut tonë para njëmijë e katërqind viteve, çka na tregon qartë mbi vërtetësinë e dërgimit të tij, mandej mbi atë që ka ardhur të na paralajmërojë për dënimin e ashpër dhe shpërblimet e

¹⁴² Ebu Neim.

¹⁴³ Muslimi, Tirmidhiu, Ebu Dawudi.

mëdha. Sikurse që i pamë parashenjat e Ditës së Kijametit, ashtu do t'i shohim shenjat e reja, sepse ai që na lajmëron mbi të është i njëjti, i sinqerti dhe besniku, Muhammed ibn Abdull-llah, savs.

ARGUMENT I CILI E NDËRRON SISTEMIN E KRIJIMIT

Nga Kur'ani Kerimi:

All-llahu Gjithësinë e krijoi me një sistem stabil (të caktuar), por këtë sistem stabil All-llahu mund ta çrregullojë duke u dhënë përkrahje të dërguarve të Vet, për t'i bindur njerëzit në vërtetësinë e dërgimit të tyre. Kurse shembull më i mirë për këtë janë ndodhitë që i kanë ndodhur Muhammedit savs, e ishin argumente të llojit të vet, për shumë njerëz mbi vërtetësinë e dërgimit të tij. Disa nga këto ndodhi janë:

1. Ndarja e Hënës

Sipas sistemit të caktuar Hëna është një trup i pandarë qiellor, të cilin askush përveç All-llahut nuk mund ta ndajë në dy pjesë. Kur kafirët, duke e konsideruar dërgimin e Muhammedit savs të rrejshëm kërkuan që t'i bind me një argument të bindshëm me atë me çka ka ardhur, All-llahu para syve të tyre e ndau Hënën në dy pjesë, pastaj Muhammedi savs u tha: ***“Binduni tani!”*** Por kafirët flisnin mes vete se si Muhammedi savs i magjepsi me

sihire, por argumentin nuk e mohuan dhe All-llahu e shpalli ajetin që vijon:

“Momenti (i katastrofës së përgjithshme) është afruar, e hëna është çarë (në dysh).”¹⁴⁴

2. Isra’ja dhe Mi’raxhi

All-llahu dëshiroi që të Dërguarin savs ta ngrisë deri në **Sidretul Munteha** mbi shtatë qiej. Ai atë nuk e ngriti nga Meka, por është bartur natën deri në **Bejtul-l-Makdis** dhe Mi’raxhi ndodhi nga ai vend. Në **Isra’** Muhammedi savs kishte argument të qartë për kafirët mbi dërgimin e tij, sepse ata të Dërguarin savs e konsideronin të rrejshëm, andaj kërkonin ta vërtetojnë sinjeritetin e tij, duke kërkuar nga ai që t’ua përshkruaj **Bejtul-l-Makdi**-sin, duke e ditur që kurrë më parë Muhammedi savs atë vend nuk e kishte parë.

Muhammedi savs ua përshkroi **Bejtul-l-Makdes**-in gur më gur. Pastaj e pyetën për karvanin e tyre i cili ishte nisur për në Meke nga Bejtul el-Magde-si, e ai sakt ua përcaktoi vendin se ku gjendej karvani, sa vetë e përcillnin dhe nga cili fis ishin, në përgjithësi ua përshkroi devetë, ndërsa veçanërisht e përshkroi devenë, e cila i paraprinte karvanit dhe çfarë mbante mbi vete, madje e përcaktoi edhe kohën e ardhjes së karvanit në Meke. Dhe me të vërtetë ashtu edhe ndodhi.

Karvani arriti mu në kohën kur e kishte përcaktuar Muhammedi savs.

Të gjitha këto ishin argumente të veçanta për udhëtimin e natës nga Meka në Kudus, ndërsa udhëtimi El-Isra’ është përsëri argument për ngritjen e tij në Qiej.

¹⁴⁴ El-Kamer: 1.

Kur'ani e përmend El-Isra'-në. All-llahu thotë:

“I Lartëmadhëruar qoftë Ai që robin e Vet e ngriti për një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Kabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t’ia treguar atij disa nga argumentet Tona...”¹⁴⁵

All-llahu i Lartësuar mbi Mi’raxhin thotë:

“A po i bëni polemikë atij për atë që e ka parë? Atë (Xhibrili) e ka parë edhe herën tjetër. (E ka parë) te Sidretul Munteha. Që pranë saj është xhenneti Me’va (kopsht strehimi i...). Atëherë kur Sidrën e mbuloi çka e mbuloi. Shikimi (i Muhammedit) as nuk lakoi e as nuk e tejkaloi. Ai (i Muhammedi) vërtet pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.”¹⁴⁶

Xhenneti dhe Xhehennemi ishin shenjat e All-llahut, të cilat Muhammedi savs i kishte parë.

Isra’-ja dhe Mir’axhi janë ndodhitë, të cilat e trazojnë sistemin e krijimit të caktuar (stabil), por All-llahu këto i bëri argument të vërtetësisë së dërgimit të të Dërguarit savs.

3. Erërat dhe ushtria e padukshme e ndihmojnë në luftë të Dërguarin savs dhe as’habët e tij

Me një rast, derisa muslimanët qëndronin para hendeqeve, që i kishin gropuar rreth Medinës, për ta penguar hyrjen e mushrikëve në qytet dhe derisa mushrikët ishin në anën e kundërt, filloi të fryejë një erë e fortë dhe u shfaq ushtria e padukshme, duke e shuar zjarrin e mushrikëve, kurse meshinaret me ujë ishin shpuar dhe uji

¹⁴⁵ El-Isra: 1.

¹⁴⁶ El-Nexhm: 12-18.

ishte derdhur, strehimoret dhe tendat ishin të shkatërruara. Kuajt dhe devetë ia dhanë vrapit lemeritshëm.

Mushrikët, të cilët kishin bërë rrugë të gjatë për t'u përleshur me muslimanët, ishin të detyruar që të turpëruar dhe të dëshpëruar të tërhiqen nga pozitat e tyre, kurse muslimanët me të Dërguarin e tyre, të ngazëllyer dhe të kënaqur përsërisnin:

“Falënderimi i takon vetëm All-llahut, Ai e përmbushi premtimin e dhënë, i ndihmoi robit të Vet dhe ushtrisë së Tij dhe ngadhënjyen mbi armikun.”

Mbi këtë pyetje në surën El-Ahzab, All-llahu i shpalli fjalët që vijojnë:

“O ju që keni besuar, përkujtonie të mirën e All-llahut ndaj jush, kur juve u erdhi një ushtri e Ne kundër tyre lëshuam një furtunë dhe ushtri që ju nuk e shihnit, e All-llahu e shihte atë që ju vepronit.”¹⁴⁷

4. Në luftën e Bedrit

Muslimanët u nisën në luftë kundër mushrikëve, por kishin frikë dhe pasiguri, sepse numerikisht ishin të pakët dhe të dobët, atëherë All-llahu dërgoi kotje mbi ta, ashtu që dikend nga ata i zuri gjumi i thellë dhe në gjumë përjetuan pollucion (u bënë të palarë) që shejtani pastaj t'i frikësonte me vdekje dhe t'i zbrapste nga lufta. Pastaj All-llahu lëshoi shi të butë që të lahen dhe të pastrohen dhe që t'ua forcojë rërën nën këmbët e tyre gjatë lëvizjes së tyre në luftë. Kur ushtarët u përleshën, All-llahu i dërgoi melaiket dhe kafirët përjetuan disfatë të bindur në luftën e parë, në mes muslimanëve dhe mushrikëve.

¹⁴⁷ El-Ahzab: 9.

Mbi këtë janë shpallur fjalët e All-llahut të Lartësuar siç vijojnë:

“Dhe kur Ai ju kaploi me një kotje (gjumë) që ishte siguri për ju nga ana e Tij, ju lëshoi shi nga qielli për t’ju pastruar me të, largoi prej jush shtimet e shejtanit, e që të fuqizojë bindjen në zemrat tuaja dhe t’ju përforcojë me të (me shi) këmbët tuaja. Edhe kur Zoti yt u kumtoi melaikeve se: »Unë jam me ju, pra, inkurajoni ata që besuan! Unë do të hedh frikë në zemrat e atyre që nuk besuan, e ju goditni në qafë e lart, mëshonju atyre në çdo gjymtyrë (gishtërinj)«.”¹⁴⁸

5. Ushtria e All-llahut e ndihmon Muhammedin savs gjatë hixhretit kundër kafirëve.

Paria e fisit kurejsh vendosën që të bëjnë atentat mbi Muhammedin savs. E rrethuan shtëpinë e tij dhe e prisnin momentin e volitshëm. Por, i Dërguari i All-llahut doli nga shtëpia dhe kaloi afër tyre, e ata (kurejshët) nuk e mundën, sepse All-llahu ua kishte mbuluar të pamurit (verbuar sytë).

Pastaj ishte fshehur në shpellën Hira, ndërsa as’habi i tij fisnik Ebu Bekri, tërësisht i frikësuar dhe i shqetësuar priste, se kur kafirët do të hyjnë brenda në shpellë për t’i zbuluar.

Por, ushtria e All-llahut i zbrapsi nga vështrimi në shpellë. Kur Muhammedi savs dhe përcjellësi i tij besnik, Ebu Bekri dolën nga Meka, kalorësi i shkathët Suraka b. Malik u nis në ndjekje pas tyre dhe kur iu afrua atyre, këmbët e kalit të tij u futën në rrëzë gjer në bark, ashtu që kali i tij më nuk mund të lëvizte, ndërsa ai u rrëzua nga

¹⁴⁸ El-Enfal: 11-12.

kali në tokë, duke e lutur Muhammedin savy për mëshirë dhe siguri. Mbi këtë na flasin fjalët e ajetit vijues:

“Në mos e ndihmofshit atë (Resulull-llahun), atë e ka ndihmuar All-llahu; kur ata që nuk besuan, e nxorën atë vetë të dytin; kur që të dy ishin në shpellë, kur po i thoshte shokut të vet: »Mos u pikëlloni (frikësoni), All-llahu është me ne!« E All-llahu i zbriti qetësi (në shpirtin e) atij, e fuqizoi me një ushtri që ju nuk e patë; e fjalën e atyre që nuk besuan e bëri më të ultën, kurse fjala e All-llahut është më e larta. All-llahu është më i fuqishmi, më i urti.”¹⁴⁹

Pyetje dhe përgjigje

Ndoshta dikush do ta parashtrojë pyetjen:

-Si mund ta arrijmë imanin sikur të atyre që janë bindur (kanë qenë dëshmitarë) dhe i kanë përjetuar këto ngjarje të pazakonshme dhe mbinjerëzore?

Përgjigjja:

Duke menduar mbi këtë dhe duke e përdorur arsyen tonë, ne do të arrijmë këtë nivel të imanit.

Për shembull, erërat e pazakonshme, ushtria e padukshme, ndarja e Hënës dhe ndodhitë tjera, kanë ndodhur në praninë e qindra dhe mijëra muslimanëve dhe mushrikëve, pastaj është shpallur Kur`ani, në të cilin të gjitha këto që kanë ndodhur janë shënuar. Këtë muslimanët dhe kafirët e dëgjojnë. Muslimanët besojnë në atë që përmend Kur`ani dhe kjo ua forcon imanin dhe ua shton nevojën për ibadet dhe xhihad. Mushrikët gjithashtu këtë e pohojnë, domethënë që nuk e mohojnë, por për shembull ndarjen e Hënës e shpjegojnë si “sihir i

¹⁴⁹ Et-Tewbe: 40.

vazhdueshëm” mandej e pranojnë islamin, fillojnë të besojnë dhe vet ata bëhen bartës dhe komentues (transmetues) të islamit në Lindje dhe Perëndim.

All-llahu e ruajti Kur'anin nga çfarëdo ndryshimi dhe shtrembërimi. Kështu për shembull ekzemplari i Kur'anit, që gjendet në Amerikë, Kinë, Indi, Rusi, Evropë ose në Afrikë është i njëjtë me ekzemplarën të cilin e kanë bërë të parët tanë të mirë (*selefus-salih*) anembanë botës - dunjasë.

Ky është ekzemplari i njëjtë, që i është shpallur Muhammedit savs. Nga kjo kuptojmë që të gjitha këto ndodhi janë të shënuara në regjistrin më të madh, në pikëpamje të besueshmërisë së të cilit pajtohen të gjithë njerëzit, përkundër prejardhjes gjeografike të tyre, atdheut dhe prejardhjeve të ndryshme kohore.

Sikur Kur'ani të shpallte, që njerëzve do t'u ndodhë diç, e kjo nuk ka ndodhur, sikurse ndarja e Hënës, të lëvizurit e erërave kundër mushrikëve në luftën El-Ahzab¹⁵⁰, as muslimanët e as mushrikët në këtë nuk do të kishin besuar dhe me këtë rast askush nuk do të kishte mbetur në Islam.

Kjo tregon qartë, që të gjitha këto që janë shënuar në Kur'an, janë e vërtetë absolute, në të cilën janë vërtetuar edhe muslimanët edhe mushrikët, e të cilin All-llahu e ka ruajtur edhe nga shtrembërimi më i vogël ose çfarëdo ndryshimi.

¹⁵⁰ sh.p. apo lufta e grupacioneve.

ARGUMENT I CILI E NDRYSHON SISTEMIN E KRIJIMIT TË ZAKONSHËM

Nga hadithi i nderuar

Muslimanët kanë mësuar shprehje të urta nga i Dërguari i tyre savs, veprat e tij dhe atë me heshtje që e ka lejuar, e kanë mësuar përshkrimin e sjelljes së tij, vetitë e tij fizike dhe çdo gjë që është e lidhur me personalitetin e tij. Me admirim dhe pietet të veçantë i përshkruanin ngjarjet mbinjerëzore gjeneratë pas gjenerate, me precizitet i zbërthenin dhe i vërtetonin rivajetet-transmetimet dhe me kujdes i verifikonin zinxhirët e transmetuesve-senedet.

Ngjarje të tilla të pazakonshme dhe mbinjerëzore të të Dërguarit savs, kanë ngjarë shumë.

Ato janë të shenuara në librat e Hadithit, kurse ne këtu do t'i përmendim disa nga ato.

1 - Rritja e sasisë së vogël të ujit

Me një rast, kur muslimanët ishin në Medine, u nevojitej uji për abdest dhe Enesi rda tregon:

“Derisa Muhammedi savs ishte në vendin Ez-Zewra me as’habët e vet, i është sjellë pak ujë dhe ai e vuri dorën e vet mubarek - të bekuar në enë dhe në befasinë tonë, uji buroi mes gishtërinjve të tij, ashtu që të gjithë morëm abdest!”

Katade e kishte pyetur Enesin: ***“Sa vetë ishit atëherë?”***

Enesi iu përgjigj: ***“Atëherë ishim afër treqind vetë!”***¹⁵¹

E ngjashme kishte ndodhur, kur Muhammedi savs udhëtonte me shtatëdhjetë as’habë të vet, ndërsa këtë na transmeton Buhariu.

Kjo gjithashtu ka ndodhur edhe në Hudejbi, siç e transmeton Buhariu, kur për shkak të të Dërguarit savs u rrit sasia e ujit në bunar.

Kështu ka ngjarë kur Muhammedi savs me as’habët e vet udhëtonte dhe me duart e veta të bekuara i preku dy enë të zbrazta të një gruaje, të cilat u mbushën me ujë, ashtu që nga këto enë, ujë, pinë dyzet vetë dhe jo vetëm kaq, por të gjithë i mbushën meshinaret me këtë ujë, ashtu që gruaja u kthye duke bërtitur se si e ka parë “njeriun më magjik”, e për të cilin thonë se është “i Dërguar”!. I gjithë populli i saj e pranoi Islamin.

2- Rritja e e ushqimit nga sasia e vogël e tij

Një herë i Dërguari savs ishte i uritur dhe Talha ia solli disa kokrra të elbit, e ai urdhëroi që këto kokrra të shtypen dhe iu drejtua All-llahut me dua, duke i thirrur as’habët që në grupe nga dhjetë vetë të hanë, kurse ishin rreth shtatëdhjetë vetë!

¹⁵¹ Hadithin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi.

Kur i Dërguari savs me as'habët ishin duke e gropuar Hendekun, e uria i kishte kapluar aq sa që më nuk mundnin të punonin, Xhabiri rda preu një dele, kurse i Dërguari savs i kishte thirrur të gjithë të pranishmit që ishin rreth një mijë, iu lut All-llahut për bereket dhe të gjithë u ngopën!¹⁵²

Në betejën e Hendekut dhe Tebukut, muslimanët gjithashtu i kishte kapluar uria, andaj as'habët kërkonin që ta thernin një deve, ndërkaq Umeri rda propozoi që të tubohet i tërë ushqimi i mbetur, që i Dërguari savs ta luste All-llahun për bereket, çka ai edhe e bëri, ashtu, All-llahu u dha bereket, që në tendën e tyre nuk mbeti asnjë pa u mbushur me ushqim. Atëherë Muhammedi savs tha:

“Dëshmoj që nuk ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet përveç All-llahut dhe që unë jam i Dërguari i All-llahut.”¹⁵³

3- Vajtimi i pikëllueshëm i palmës dhe tesbih-ët e ushqimit

*Gjatë mbajtjes së hutbës të xhumave, Muhammedi savs mbështetej mbi një dru të palmës, kur iu ndërtua mimberi dhe për herë të parë filloi të ngritet mbi të, të gjithë të pranishmit u habitën kur e dëgjuan rënkimin e palmës, rënkim që i gjasonte rënkimit të devesë. Ai iu afrua dhe e përkëdheli me butësi. Druri e ndali rënkimin!*¹⁵⁴

Buhariu dhe Tirmidhiu transmetojnë se si as'habët e dëgjonin tesbih-un e ushqimit që e hante Muhammedi

¹⁵² Buhariu.

¹⁵³ Muslimi.

¹⁵⁴ Buhariu, Nesaiu dhe Tirmidhiu.

savs.

4~ Mrojtja e Muhammedit savs nga armiqtë e tij

Me një rast Ebu Xhehli ishte betuar, që do ta shkelte në fyt Muhammedin savs kur do ta shihte duke bërë sexhde. Njëherë, kur e kishte parë të Dërguarin savs duke bërë sexhde, u nis për ta kryer qëllimin e vet dhe për ta përmbushur premtimin. Por u kthye katërkëmbësh dhe kur e kishin pyetur se çfarë ka, u ishte përgjigjur:

“Në mes meje dhe tij është një gropë e madhe nga zjarri, greminë e hatashme dhe krahë mbrojtës.”

Një çifute ishte betuar që do ta shkatërrojë të Dërguarin savs, ashtu që në mishin e deles kishte vënë helm. Muhammedi savs e dinte që mishi ishte i helmuar dhe nuk e hëngri, por disa as'hab atëherë veç ishin helmuar.

5~ Paralajmërimet e tij mbi gjërat e fshehura - gajb

Resulull-llahu savs u ka treguar as'habëve të vet se çfarë do të ndodhë në jetën e tij, pas shpërnguljes së tij në Ahiret e deri në Ditën e Kijametit.

Populli në Jemen e pranoi Islamin duke iu falënderuar asaj që Muhammedi savs i njoftoi Persianët dhe Jemenasit që All-llahu do ta dënojë mbretin e Bizantit, duke e përcaktuar sakt natën në të cilën kjo do të ndodhë. Kisrau në natën e caktuar, më të vërtetë ishte vrarë, ndërsa populli i Jemenit dhe Persisë e pranuan Islamin të gjithë në grupe.

PARALAJMËRIME TË GËZUARA TË SHPALLURA NË LIBRAT E MËPARSHËM

Askush nuk mund të pohojë, që në Librat e Jehudëve, të Krishterëve, zjarrputistëve dhe Hindusëve, se Muhammedi savs e përshkroi veten e tij, e shënoi emrin e vet, i shënoi karakteristikat e kohës në të cilën do të jetojë dhe qytetin i cili do të dëshmojë, që ai është i Dërguar savs, i Dërguar nga All-llahu, sepse të gjitha këto janë të shënuara në librat e tyre shumë shekuj më herët, para lindjes së tij. All-llahu thotë:

“Dhe se Ai (Kur’ani) është i përmendur edhe në librat e mëparshëm.”¹⁵⁵

Këto paralajmërime ishin shkak i bindjes dhe i besimit të shumë Krishterëve, zjarrputistëve, Jehudëve dhe Hindusëve, ndërsa ata që qëndronin armiqësisht ndaj Muhammedit savs, tentonin që këto paralajmërime të shlyhen, ta ndryshojnë kuptimin e tyre, ose më në fund me shkathtësi të kamuflohen. Por, përkundër asaj, këto paralajmërime edhe më tutje gjenden në librat e tyre dhe

¹⁵⁵ Esh-Shuara: 196.

dëshmojnë mbi singëritetin e Risaletit të Muhammedit savs.

Këto paralajmërime janë:

Në Tewrat:

Në Tewrat thuhet se do të shfaqet i Dërguar në Mekke (qytet në të cilin ishte Kidari - njëri nga djemtë e Ismailit) dhe që emri i tij do të ngritet në nivel më të lartë, që do të kalërojë mbi deve, që do të luftojë me shpatë, që ai dhe as'habët e tij do të ngadhënjëjnë dhe që njerëzit do të luten për bekimin e tij për çdo ditë. - Aludim mbi atë, çfarë bëjnë muslimanët për çdo ditë në teshehud (në ulje) gjatë namazit!

Qëndron gjithashtu që mbretërit e Jemenit do të vijnë duke i afruar viktimat, që mbi shpatull do të ketë shenjë dhe udhëheqësisë (vulën e Resultetit) së vet, në formë të vesë së pëllumbit dhe me të vërtetë kjo shenjë gjindej në shpatullën e Muhammedit savs. Domethënë, të gjitha këto përshkrime në formë të paralajmërimit i përgjigjen vetëm të Dërguarit të All-llahut.

Në Tewrat gjithashtu qëndron që All-llahu u është treguar njerëzve në tri vende dhe atë:

1-Në Sinaj - ku Musa assa e pranoi shpalljen - Tewrat-in,

2-Në Saiir - kodra në Palestinë - ku Isai assa e pranoi Inxhilin dhe

3-Në Mekke - Faran - ku Muhammedi savs e pranoi Kur`ani Kerim-in.

Në Tewratin, i cili gjendet në duar të Jehudëve edhe më sot qëndron kështu:

“Dhe u shfaq Zoti nga Sinaji, na shndriti nga Saiiri dhe shkëlqeu nga kodra Farana.” Kurse farana është

emërtim i vjetër, i Mekkes, sikurse që përmend edhe vetë Tewrati. »Libri Gjenezë 1 (21-22)«!

Disa hulumtues konsiderojnë që Kur`ani aludon mbi këto katër vende me fjalët:

“Pasha fikun dhe ullirin! Dhe (kodrën) Turi Sina-en! Dhe këtë qytet të sigurisë!”¹⁵⁶

Fjalët: ***“Pasha fikun dhe ullirin”*** janë shenjë - isharet për Palestinën sepse atje rriten (kultivohen).

“We turi Sinin” isharet për pyellin e Sinait, ndërsa ***“Hadhel beledil emin”*** isharet për Mekken.

Në Inxhil:

Në kapitullin e 22 në Inxhilin e Bernabiut qëndron që Isai assa u ka thënë pasuesve të vet:

“Kjo do të zgjasë gjithnjë derisa nuk do të vijë Muhammedi, i Dërguari i All-llahut, i cili këtë mashtrim do t’ua zbulojë atyre, të cilët do t’i besojnë ligjeve të All-llahut.”

Në Inxhilin e Ivanit qëndron se Isa assa e lajmëroi popullin e vet mbi arrdhjen e të Dërguarit pas tij me fjalët:

“Ka shumë gjëra që nuk mund t’ua them, sepse ju nuk mund t’i përballoni ato, ndërkaq kur do të vijë ai shpirt i së vërtetës, ai do të udhëheqë kah e vërteta e plotë, sepse ai nuk flet nga vetja e tij, por çdo gjë që ndien ai edhe e thotë dhe ai do t’u lajmërojë për gjërat që pasojnë.”

Muhammedi savs erdhi pas Isas assa. Ky është ai i cili i transmetonte shpalljet dhe njerëzit i lajmëronte mbi gjërat, gajb, që do të ndodhin (në të ardhmen).

Njëri nga dijetarët e mëdhenj krishterë Ati - Abdul

¹⁵⁶ Et-Tin: 1-3.

Ehad Dawud el-Ashuri, në librin e vet “Inxhili dhe kryqi” thotë; Fjalët që tani i përsërisin të Krishterët:

“El-Mexhidu lil-lahi fil a'ëla we al-el erdis-selamu we bin-nas el-eseretu.” (Lavdërimi dhe falënderimi i takojnë All-llahut mbi lartësitë më të larta, mbi Tokë qoftë paqja, ndërsa njerëzve gëzimi), që nga fillimi nuk kanë qenë në formë të tillë, por duhet të qëndrojnë kështu:

“El-Mexhidu lil-lahi fil a'ëla we al-el erdis-selamu we bin-nasi Ahmedu.!”

“Lavdërimi dhe falënderimi i takojnë All-llahut, mbi lartësitë më të larta, mbi Tokë qoftë paqja, ndërsa njerëzve Ahmedu.!”

Në librat e Hindusëve:

Në librin e shenjtë brahmat “Veda e vetmuar” në rreshtin e gjashtë dhe të tetë të pjesës së dytë qëndron kështu:

“Ahmedi mori ligjin nga Zoti i tij dhe në të ka plot fisnikëri!”

Ndërsa në librin “Atharwa Veda”, e ky është libër i shenjtë i Hindusve, qëndron kështu:

“O njerëz, dëgjoni dhe kuptoni, në mesin e njerëzve do të dërgohet Muhammedi savs, kurse madhësia e tij do të jetë e lavdëruar edhe në (xhennet) parajsë, e ai është i Lavdëruari-Muhammedi savs!”

Edhe në një libër të shenjtë Hindus “Babush Brahmit” qëndron:

“Në atë kohë do të dërgohet një i huaj me shokët e vet me emrin Mehamid (i shtrembëruar nga Muhammed) do të jetë i pastëruar me pesë pastërti.!” (pesë vakte të namazit) (Pjesa e dytë, kapitulli i tretë, fjalia numër tre dhe ajo që vijon.)

Në librat e mexhusive ~ zjarrëputistëve:

Në librin “Zinda Efseti” qëndron që All-llahu do ta dërgoj të Dërguarin savs me përshkrim të këtillë:

“Mëshirë për njerëzimin, do t’i kundërvihet armikut me emrin Ebu Leheb, ndërsa ai do të thërrasë në adhurimin e një Zoti!”

Dhe, me të vërtetë, të vërtetën e tha All-llahu i Lartësuar:

“Atyre që u kemi dhënë librin, ata e njohin ate (Muhammedin) siç i njohin bijtë e vet,...”¹⁵⁷

Jehuditë dhe të Krishterët janë pasues të Librit, ndërsa për Hindusët dhe Mexhusët i Dërguari savs na ka urdhëruar që t’i trajtojmë si “Ehli Kitabët”, por që të mos e hamë mishin e therur në mënyrë të tyre dhe që të mos martohemi me gratë e tyre, sepse (All-llahu e di më së miri) librat e tyre janë shumë të vjetër, por kryesisht të shtrembëruar.

Në fund të fundit, këto paralajmërime të gëzuara ishin shkak, që shumë Jehudi, të Krishterë, Mexhusijas dhe Hindusë me bindje të plotë e pranuan Islamin.

¹⁵⁷ El-Bekare: 146.

DËSHMIA E GJENDJES SË PËRDITSHME E TË DËRGUARIT SAVS MBI VËRTETËSIN E DËRGIMIT TË TIJ

Çdo personalitet, i cili i kushtohet ndonjë pune shoqërore, nuk mund të bëhet i pavërejtur nga njerëzit dhe që të mos e fillojnë hulumtimin për gjendjen e tij të përgjithshme. Brenda një kohe të shkurtër, e vërteta mbi të del në dritë, veçanërisht nëse ai person i tejkalon sprovat në mes dobësisë dhe forcës, frikës dhe sigurisë, varfërisë dhe pasurisë, numrit të vogël dhe të madh të ithtarëve (pasuesve), fatkeqësisë dhe të mirës, sikurse ndër të gjitha që kanë ngjarë edhe në jetën e Muhammedit savs. Nëse me kujdes e analizojmë gjendjen e tërësishme të jetës së tij, arrijmë deri te bindja e pashmangshme, që gjëra të tilla mund t'i ngjajnë kryesisht të Dërguarit. T'i përmendim vetëm disa nga momentet dhe segmentet nga jeta e tij.

1.Sinqeriteti

Vet populli i tij e kishte theksuar dhe vërtetuar sinqeritetin e tij, ashtu që, para se të dërgohet si i Dërguar e quajtnë “Es-Sidik, El-Emin” (i sinqerti, besniku). Me një rast Ebu Xhehli, i kishte thënë plotësisht qartë: **“Ne ty nuk**

të konsiderojmë të rrejshëm, por të rrejshëm e konsiderojmë atë me çka ke ardhur.”¹⁵⁸

Mandej All-llahu i shpalli fjalët që vijnë:

“Ne dimë se ty të brengos ajo që thonë, e ata nuk të gënjejnë ty, por ata mizorë mohojnë argumentet e All-llahut.”¹⁵⁹

2.Konsekuencë absolute në atë në çfarë i ftonte njerëzit

Shpirti i njeriut, sipas natyrës së vet nuk pranon që t'i imponohen prangat, obligimet dhe detyrimet, veçanërisht kur në shoqëri e arrin shkallën e ndikimit dhe pushtetit. Nëse mendojmë mbi gjendjen dhe personalitetin e Muhammedit s'ka kemi për të parë që kemi të bëjmë me personalitetin më modest, me moral të përsosur dhe me ibadet më intenziv. Agjëronte aq shpesh, saqë familja e tij thoshte se assesi nuk e ndërpriste agjërimin, ndërsa natën bënte aq namaz, saqë këmbët i dridheshin dhe lëkundeshin; mandej Aishja, All-llahu qoftë i kënaqur me te, e pyeste:

“Pse e bën këtë kur All-llahu t'i ka falur të gjitha mëkatet, të mëparshmet dhe të ardhmet? Kurse ai i përgjigjej: “A të mos jem rob falënderues i All-llahut.”¹⁶⁰

E ndante pasurinë aq sa në shtëpi nuk linte asgjë. U shpërngul në Ahiret, kurse mburoja e tij kishte mbetur peng te një Jehudi.

Llojet e ndryshme të dhikrit dhe duatë e tij që mbahen

¹⁵⁸ Këtë e shënon Tirmidhiu, ndërsa Ibn Kethiri thotë, që El-Hakimi e transmeton nga Ebu-Is'haku.

¹⁵⁹ El-En'Am: 33.

¹⁶⁰ Muslimi dhe Buhariu.

në mend, dëshmojnë qartë, që ditë e natë, pa i lënë pas dore edhe punët e veta i bënte ibadet Zotit të vet dhe përkrah të gjitha këtyre, ishte i Dërguar savs, i obliguar (ngarkuar) që ta sqarojë Dinin e All-llahut, udhëheqës ushtarak dhe strateg luftarak, njeri, të cilit muslimanët i drejtoheshin në vështirësi, shembull i guximit dhe vendosmërisë.

Kështu në luftën e Hunejnit, i qëndrueshëm dhe i palëkundshëm, me njëqind as'habët e vet, i doli për ballë katër mijë mushrikëve dhe All-llahu u dha fitore mbi armikun.

Mushrikët e Mekes i afronin pasuri, respekt dhe pushtet vetëm që ta braktisë Dinin, në të kundërtën, nëse vazhdon me përhapjen e Islamit, e pret lufta, provokimet e vazhdueshme dhe ndjekjet.

Ndërkaq, mbet i vendosur në shpjegimin e asaj që All-llahu e urdhëroi. Dhe, kur gjithë njerëzit me përlulje shprehën respekt ndaj tij, erdhën fjalët e All-llahut të Madh:

“O ti i Dërguar, thuaju grave tuaja: »Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj, atëherë ejani: Unë po ju jap furnizimin (për lëshim) dhe po ju lëshoj ashtu si është e rrugës...”¹⁶¹

Të gjitha e zgjodhën të Dërguarin savs dhe ishin shumë modeste në pikëpamje të dunjasë dhe stolive të saj.

Ishte shembull i lartësuar në gjykimin e njerëzve në mënyrë të drejtë, andaj edhe kishte thënë:

“Sikur Fatimja, vajza e Muhammedit savs, të vidhte, Muhammedi savs dorën do t’ia kishte prerë.”¹⁶²

¹⁶¹ El-Ahzab: 28.

¹⁶² Buhariu dhe Muslimi.

Duke pasur parasysh, që ishte shembull në çdo gjë, atëherë nuk është vështirë që ta shpjegoj dëshirën e bijve të Ummetit të tij, që ta pasojnë në çdo segment të jetës, por pa pasur sukses që ta arrijnë gradën e tij, sepse vetitë e tilla të shembullit të lartësuar (dhe mënyra shëmbullore e sjelljes së tij), shëmbëlltyra e tij mund të shpjegohet vetëm në personalitetin e Lajmëtarit të fesë dhe të Dërguarit, mbi moralin e të cilit dëshmojnë fjalët e All-llahut:

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë morali!”¹⁶³

All-llahu e ka caktuar si shembull për njerëzimin duke thënë:

“Ju e kishit shembullin më të mirë në të Dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në Ahiret, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun.”¹⁶⁴

3. Zbatimi i tij konsekuent i shpalljes dhe sqarimi i saj njerëzve

Muhammedi savs e shfrytëzonte çdo rast për kryerjen e detyrave, në komunikimin e shpalljes dhe mësimin e saj njerëzve. Ndonjëherë këtë e bënte gjatë takimeve personale me njerëz, ndonjëherë u përgatiste ushqim dhe i ftonte, ndonjëherë me këmbëngulje dhe durim i drejtohej fiseve të ndryshme, përkundër asaj që njëri pas tjetrit shpesh e refuzonin, ndonjëherë organizonte tubime të mëdha, por ndonjëherë individualisht bisedonte me njerëz. Për këtë qëllim i dërgonte edhe as’habët e vet si mësues të Dinit.

Mbretërve dhe sunduesve të ndryshëm i dërgonte

¹⁶³ El-Kalem: 4.

¹⁶⁴ El-Ahzab: 21.

përfaqësuesit e vet specialë për t'i thirrur në Islam, ndërsa, kundër atyre që i zbrapsnin njerëzit nga rruga e All-llahut, bënte xhihad. Thirrjet e tij kafirët i pengonin në mënyrë më çnjerëzore, përmes sulmeve të tërbuara armiqësore dhe provokimeve. Kurejshët, për shembull, e përqeshnin Muhammedin savs dhe as'habët e tij, i digjin, i vrisnin dhe në mënyrë më mizore (çnjerëzore) i dënonin muslimanët.

Pastaj Muhammedin savs dhe muslimanët i mbajtën tri vjet të rrethuar, ashtu që, muslimanët ishin të detyruar të hanin gjethe, lëvore dhe rrënjë të drurit. Gjatë këtyre armiqësive të vazhdueshme e të pamëshirshme nga ana e kurejshëve, muslimanët ishin të detyruar që dy herë të shpërngulen dhe të ikin nga vatrata e tyre.

Herën e parë në Abisini, kurse herën e dytë në Medine, për ta ruajtur Dinin e tyre. Madje, njerëzit e fisit Kurejsh e kishin planifikuar edhe vrasjen e të Dërguarit të All-llahut, por All-llahu e urdhëroi të bëjë hixhret (të shpërngulet), që të shpëtonte nga kurthi i tyre.

Atë, çka e urdhëronte Zoti i tij, ai edhe e shpallte atë, madje edhe kur i erdhi çortimi (vërejtja) nga Zoti, sikur që erdhi në fjalët e All-llahut:

“Ai vrenjti (fytyrën) dhe u kthye. Ngase atij i erdh i verbëri. E ku mund ta dish ti, ndoshta ai do të pastrohet. Apo do të këshillohet dhe këshilla do t'i bëjë dobi! E ai që nuk ndien nevojë (për Zotin) pse ka pasuri. Ti atij i vë veshin (i drejtohesh)!. Po ti nuk ke përgjegjësi, pse ai nuk pastrohet. Ndërsa ai që nxiton dhe vjen te ti. Ndonëse ai frikësohet, ti nuk e zë asgjë (dhe nuk ia vë veshin fjalës së tij).”¹⁶⁵

¹⁶⁵ Abese: 1-10.

Në të vërtetë, shkak i këtij qortimi është, pse Muhammedi savs ishte duke thirrur një kafir me respekt në Islam dhe kur i erdhi Ibnu Umi Mektumi, i cili ishte i verbër, duke dëshiruar që ta pyeste diç, ai ktheu kokën, ashtu që mos ta pengonte në të sqaruarit e Islamit këtij njeriu të parë dhe të respektuar të një populli, sepse, kur të tillët e pranojnë islamin, me vete bartin hajr të madh për muslimanët.

Muhammedi savs kishte kthyer kokën nga Ibnu Umi Mektumi dhe ishte mrolur në të.

Duke pasur parasysh, që Ibnu Umi Mektumi ishte i verbër, ai nuk mund ta shihte fytyrën e tij të mrolur dhe kjo nuk mund ta fyente, por, All-llahu e shpalli qortimin dhe i Dërguari e transmetoi ashtu siç ishte shpallur!¹⁶⁶.

Pa i pasur parasysh vështirësitë dhe pengesat e ndryshme, me të gjithë mundin dhe tentimet e Muhammedi savs në jetën e tij, ka pasur për qëllim që të kumtojë atë çka e urdhëronte Zoti i tij.

Në Haxhxin e Lamtumurës ai u thoshte muslimanëve: ***“A ju kam lajmëruar”*** Kur ata dëshmuar që me besnikëri e barti Dinin e All-llahut, e ai tha: ***“O Zot bëhu dëshmitari im!”***¹⁶⁷

Dhe me të vërtetë, çdo moment nga vdekja e të Dërguarit të All-llahut dëshmon qartë, që ai me të vërtetë ka qenë Lajmëtar i fesë dhe i Dërguar, savs.

¹⁶⁶ Hadithin e transmetojnë El-Tirmidhiu dhe Ebu Ju'la, kurse hafidhi El-Iraki për transmetuesit e tij thotë se janë të besueshëm.

¹⁶⁷ Transmetojnë Ahmedi dhe Muslimi.

SJELLJA E PASUESVE DHE ARMIQVE NDAJ TIJ DËSHMUAN QARTË MBI MISIONIN E TIJ

Pasuesit e tij:

Aftësia e një mësuesi pasqyrohet mbi nxënësin e tij, butësia e një trajneri manifestohet përmes atij që e ushtron. Ndërsa, sinjeriteti i të Dërguarit savs shprehet te pasuesit e tij. Ata janë që jetuan me të. Ai i edukoi, shpirtërisht i pastroi dhe i mësoi. Dhe kush mendon mbi as'habët e të Dërguarit të All-llahut, ka për t'i njohur në përshkrimin e All-llahut:

“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve...”¹⁶⁸

Populli i tërë rruzullit tokësor në atë kohë ka dëshmuar për muslimanët, që janë Ummeti më i mirë që ka njohur njerëzimi. Sepse rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare dhe ndërshtetërore janë që, nëse një shtet lufton kundër shtetit tjetër, ose nëse një popull lufton kundër popullit tjetër, kjo patjetër rezulton me urrejtje dhe mosdurim mes

¹⁶⁸ Ali-Imran: 110.

atyre popujve, në çka mund të bindemi edhe sot, në bazë të marrëdhënieve të kolonizuesit dhe popullit të kolonisë së tij. Ndërkaq, ky rregull u abrogua me arrdhen e pushtuesve muslimanë, të cilët në kohën e tyre mbizotëronin Tokën, kur pushtimi islam e sillte lirinë, vendoste besim dhe dashuri në mes muslimanëve dhe popullatës lokale. Andaj kjo popullatë e falënderonte All-lahun për dërgimin e këtyre pushtuesve muslimanë si shpëtimtarë nga zullumi-tirania. Nëse gjurmon për shkakun e sjelljes dhe qëndrimit të tillë, do të vish në përfundim që përleshjet (trazirat) mes njerëzve bëhen kryesisht për shkak të dunjasë. Pushtuesit muslimanë e vënin peng dunjanë e vet, për t'i bërë të lumtur njerëzit në Ahiret, sepse fortësisht besonin në Ahiret. Imani dhe sjellja e tyre janë fryt i bindjes absolute në argumentet, që ua paraqiste i Dërguari i All-llahut, andaj e merrnin si shembull sjelljen e tij të jashtëzakonshme dhe praktikitetin e tij, që e stolisnin gjatë tërë jetës së tij.

Miqt e tij:

Pas armiqësive kryeneqe dhe intenzive dhe provokimeve të ndryshme, armiqtë bëheshin më të mirët, ndërsa pasuesit e shumtë të shpalljeve të mëhershme e pranonin Islamin. Të gjiha këto flasin qartë për bindshmërinë në dërgimin (misionin) e tij dhe të besuarit në atë me çka ka ardhur.

UNIVERZIALITETI I SHERIATIT PËR ÇDO KOHË DHE PËR ÇDO VEND

Vendosja e ligjit ose rregullimi i çfardo gjëje, bazohet në esencën e asaj që dëshirohet ligjshmërisht të sanksionohet, ose juridikisht të rregullohej sikurse edhe në njohjen e rrethanave të dhëna.

Duke e përfillur faktin që njeriu nuk e njeh esencën e shpirtit të vet dhe ardhmërinë me të cilën do të ballafaqohet, as nuk është në gjendje që të vendosë rregulla dhe ligje të pandryshuara të cilat do të vlenin në çdo kohë dhe në çdo vend, ndërsa Krijuesi i Lartësuar njeriun e njeh absolutisht dhe thotë:

“A nuk e di Ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë.”¹⁶⁹

Ai shumë mirë e di atë se çka ka qenë dhe atë se çka do të bëhet dhe për këtë, njeriu nuk është në gjendje të vendosë ligj të qëndrueshëm, që do të ishte përkatës dhe adekuat për çdo kohë dhe për çdo vend, përveç nëse është si i dërguar, i dërguar nga Zoti i tij.

Muslimanët me qindra vite dominonin në Lindje dhe

¹⁶⁹ El-Mulk: 14.

Perëndim dhe ligji i sherijatit gjatë gjithë këtyre qindra viteve ka qenë univerzal dhe adekuat në të gjitha meset dhe rrethanat.

Ligji islamik pashmangshëm u imponua edhe në kohën tonë, përkundër dobësisë së pasuesve të tij, ashtu që Organizata e Kombeve të Bashkuara, e përdor si një nga burimet e ligjeve ndërkombëtare derisa për shmebull, ligjet ruse dhe amerikane nuk konsiderohen si burim i të Drejtave Ndërkombëtare.

Ekspertët e të drejtave Ndërkombëtare, kanë dëshmuar vet, që ligji i sherijatit Islam është adekuat dhe univerzal për çdo kohë dhe për çdo vend.

Ashtu, Dr. Iziko E. Towhein, njëri nga juristët më eminent botëror, thotë:

“Islami plotësisht i përgjigjet rrethanave dhe nevojave që shfaqen në praktikë. Gjatë gjithë shekujve është zhvilluar, e nuk humbi asgjë, por mbeti autentik në principet e veta. Ai në tërësi e ruajti fuqinë dhe fleksibilitetin e vet, pa e pasur parasysh vendin dhe kohën. Ai botës i dha dispozitat më themelore dhe sistemi i tij juridik fuqishëm dominon mbi sistemet juridike të Evropës.”

Konferenca Ndërkombëtare mbi të Drejtat, e cila është mbajtur në vitin 1932 në Lahaj, nga organizatat juridike botërore kërkonte që ligji i sherijatit Islam të jetë njëri nga zgjedhjet e të drejtave Ndërkombëtare, pasi që ekspertët e të drejtave ishin bindur në vlerën e ligjeve të sherijatit Islam dhe dobisë e tij të mëdha për njeriun bashkëkohor. Ndërsa njëra nga kërkesat e konferencës Ndërkombëtare e të drejtave Komparative, e cila u mbajt në vitin 1952 në Paris, është që organet kompetente të të drejtave Ndërkombëtare, t’ua mundësojnë mbajtjen e konferencës

në nivel Ndërkombëtar mbi ligjet e sherijatit Islam jo për çdo dhjetë vjet si ishte paraparë atëherë, por për çdo vit, çka e arsyetonin me dëshirë, që të mësonin shumë dobi nga studimet mbi sherijatin Islam.

“Duke i marrë parasysh konkluzionet dhe argumentet (faktet), deri te të cilat kanë arritë pjesëmarrësit e Konferencës, duke i ndjekur studimet në “Java mbi ligjet Islame” dhe të gjitha diskutimet që u zhvilluan gjatë kësaj Konference, u bë absolutisht e qartë, se ligji Islam qëndron mbi principe të forta, në vlerat dhe dobitë e të cilit nuk ka asnjë çik dyshimi, llojllojshmëria e principeve, të këtij sistemi ligjeve komplekse, në vete prembajnë pasuri të jashtëzakonshme të mendimeve juridike dhe zinxhirë të tërë të mrekullueshëm të nismave artistike, çka këtij Ligji i mundësojnë, që t’iu përgjigjet të gjitha kërkesave dhe dëshirave që shfaqen dhe paraqiten në jetën bashkëkohore.

Ne, pjesëmarrësit e kësaj Konference, kërkojmë që “Java mbi ligjet (të drejtat) Islame” të mbahet çdo vit!” - përfundojnë pjesëmarrësit e konferencës.

Si atëherë, njeriu i cili nuk ka ditur as të shkruajë, e as të lexojë, e i cili është dërguar para njëmijë e katërqind vjetëve, të sillte një sistem juridik të Sherijatit sikur të mos ishte Lajmëtar i fesë, i Dërguar nga Zoti i vet?!

Në këtë masë edhe të befason dëshira e muslimanëve xhahilë, që t’i asgjësojnë ligjet e Zotit, e t’i vendosin ligjet e njerëzve!

TË PËRULURIT NË IBADET

1. Çka është ibadeti

Ky është emër i përgjithshëm për çdo gjë që All-llahu e don, me çka All-llahu është i kënaqur e me çka na ka urdhëruar. Pra çdo gjë që na ka urdhëruar All-llahu, e ne e zbatojmë në praktikë është ibadet, mandej çdo gjë që na e ka ndaluar All-llahu e ne nuk e bëjmë nga çfarë largohemi, gjithashtu është ibadet. Zakonet e urdhëruara sikurse që janë: ushqimi, pijet dhe veshmbathjet, bëhen ibadet nëse e kemi për qëllim nënshtrimin ndaj urdhërave të All-llahut.

Ibadeti nuk është në rregull, nëse nuk i është kushtuar ekzkluzivisht Atij, nëse nuk është në pajtim me urdhërat e Tij dhe që nuk është pasqyrim i të nënshtruarit absolut që rrjedh nga dashuria e plotë ndaj Tij. Duke i përshkruar besimtarët All-llahu thotë:

“...dashuria e atyre që besuan All-llahun është shumë më e fortë.”¹⁷⁰

Përmes ibadetit pasqyrohet kuptimi dhe qëllimi i krijimit të krijesave të All-llahut, të cilëve u dërgonte të dërguar. Nëse All-llahu ia nënshtroi njeriut gjithçka ka në

¹⁷⁰ El-Bekare: 165.

qiej dhe në Tokë, kjo është për arsye, se njeriu të gjitha duhet t'i nënshtrojë dhe t'i drejtojë kah nënshtrimi ndaj All-llahut të Madh. All-llahu thotë:

***“A nuk e dini ju se All-llahu nënshtroi për të mirën tuaj çka në qiej e çka në tokë dhe plotësoi ndaj jush të mirat e Tij të dukshmen e të fshehtat,...”*¹⁷¹**

All-llahu gjithashtu thotë:

***“Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër pos që të Më adhurojnë.”*¹⁷²**

Edhe në surën en-Nahl, në ajetin 36 All-llahu thotë:

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar (misionar) që t'u thonë: »Adhuroni vetëm All-llahun dhe largohuni shejtanëve (adhurimit të tyre)!« Por, pati nga ata që All-llahu e udhëzoi e pati nga ata që ishte i gjykuar me humbje,...”

Që ibadeti të jetë i pranuar, ekzistojnë dy kushte themelore:

a) - Singëriteti i plotë ndaj All-llahut

Ibadeti i bëhet vetëm All-llahut, ndërsa qëllimi ekskluziv i tij është, të arrihet kënaqësia e All-llahut.

All-llahu thotë:

***“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singërtë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ai është Dini i drejtë.”*¹⁷³**

b) - Pasimi me konsekuencë i të Dërguarit savs

¹⁷¹ Lukman: 20.

¹⁷² Edh-Dharijat: 56.

¹⁷³ El-Bejjine: 5.

Kjo do të thotë, që ibadeti ndaj All-llahut të bëhet në mënyrën që është shpallur përmes të Dërguarit savs.

All-llahu thotë:

“Thuaj: »Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë.”¹⁷⁴

Kur i përshkruan kafirët, All-llahu thotë:

“A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fe, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?... ”¹⁷⁵

Për shembull, kush e kryen namazin (e akshamit) me katër rekate, namazin nuk e ka në rregull, e kush e kryen me tre rekate, namazin e ka të saktë, sepse kjo i përgjigjet asaj me çka ka ardhur i Dërguari savs. Pra akshami i kryer në mënyrën e parë është në kundërshtim me atë me çka ka ardhur i Dërguari savs.

I Dërguari savs ka thënë:

“Kush shpik në çështjen (fenë) tonë diç që nuk është prej saj, ajo nuk pranohet.”¹⁷⁶

2. Llojet e ibadetit

Robërimi ndaj All-llahut arrihet me nënshtrimin e plotë të njeriut, haptazi (publikisht) dhe fshehtazi, me bindje, me fjalë, me vepra dhe me sjellje të përgjithshme ndaj All-llahut të Lartësuar azvxh.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të ibadetit:

¹⁷⁴ Ali-Imran: 31.

¹⁷⁵ Esh-Shura: 21.

¹⁷⁶ El-Buhariu dhe Muslimi.

a) Ibadeti nga bindja

1. Të bindurit që nuk ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet përveç All-llahut dhe që Muhammedi s'është rob dhe i Dërguar i All-llahut.

Deri te kjo bindje arrihet përmes studimit të shkencës, e cila nuk lë asnjë grimcë më të imtë dyshimi. All-llahu thotë:

“Atëherë, dije se nuk ka të adhuruar tjetër pos All-llahut, kërko falje për mëkatin tënd...”¹⁷⁷

All-llahu gjithashtu thotë:

“A është i njëjtë ai që e di se ajo që t’u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën.”¹⁷⁸

2. Dashuria ndaj All-llahut të Lartësuar

All-llahu thotë:

“...dashuria e atyre që besuan All-llahun është shumë më e fortë...”¹⁷⁹

Kjo është dashuri, e cila është e tërthortë, me përlulje absolute, nënshtrim dhe besnikëri dhe me pasimin e plotë dhe konsekuent të të Dërguarit s'është.

“Thuaj: »Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t’ju dojë...”¹⁸⁰

Arritja e shkallës së tillë të dashurisë ndaj All-llahut, varet nga dashuria jonë ndaj të Dërguarit s'është. Sa i përket

¹⁷⁷ Muhammed: 19.

¹⁷⁸ Er-Rra'd: 19.

¹⁷⁹ El-Bekare: 165.

¹⁸⁰ Ali-Imran: 31.

dashurisë sonë ndaj fëmijëve dhe familjes, kjo nuk paraqet ibadet kushtuar atyre, sepse nuk obligon në nënshtrim dhe përkushtim të plotë ndaj tyre. Andaj, kjo dashuri nuk guxon të jetë më e madhe dhe më e fortë se sa dashuria e mu'minit ndaj All-llahut dhe të Dërguarit. Nëse vie deri te kacafytja e dashurisë ndaj All-llahut dhe të Dërguarit savs, me ndonjë dashuri tjetër, atëherë dashuria ndaj ndonjë gjëje tjetër zhduket nga zemra e mu'minit. All-llahu thotë:

“Thuaj (o i Dërguar): »Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikoheni se do të dështojë, vendbanimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se All-llahu, se i Dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, pritni derisa All-llahu të sjellë vendimin e Tij. All-llahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur.”¹⁸¹

3. Frika dhe drojtja nga All-llahu, dëshira e përhershme dhe shpresa për rahmetin-mëshirën e Tij.

All-llahu thotë:

“(A jobesimtari e ka gjendjen më të mirë) Apo ai që kohën e natës e kalon në adhurim, duke bërë sexhde, duke qëndruar në këmbë, i ruhet (dënimit të) botës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të vet? Thuaj: »A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?«.¹⁸²

Duke i përkrahur mu'minët All-llahu thotë:

“Edhe ata që i frikësohen dënimit nga Zoti i tyre. Sepse është e vërtetë që nuk ka shpëtim prej dënimit nga Zoti i

¹⁸¹ Et-Tewbe: 24.

¹⁸² Ez-Zumer: 9.

tyre.”¹⁸³

Ndonjëherë njeriu ka frikë nga gjërat e dunjasë, por kjo frikë nuk paraqet ibadet ndaj këtyre gjërave, sepse kjo frikë është frikë e natyrshme nga shkaqet, për të cilat mu’mini beson që janë të përcaktuara nga All-llahu dhe kjo frikë në zemrën e besimtarit nuk e arrinë shkallën më të lartë nga frika ndaj All-llahut, duke konsideruar që besimtari ka bindje që All-llahu mund ta ruajë nga çdo gjë që është e padëshiruar.

All-llahu thotë:

“Nëse All-llahu të godet me ndonjë të keqe, s’ka kush që ta largojë atë pos Tij, e nëse të dhuron ndonjë të mirë, duhet ditur se Ai është i gjithëfuqishëm për çdo send.”¹⁸⁴

4. Të menduarit e vazhdueshëm për All-llahun

Ndërsa, kjo do të thotë dëshirë e vazhdueshme për ta arritur kënaqësinë e All-llahut, të kthyerit tek Ai në çdo moment dhe të kërkuarit e faljes për mëkatet e bëra nga Ai. All-llahu thotë:

“Dhe, kthehuni te Zoti juaj dhe përruljuni Atij para se t’u vijë dënimi, se pastaj nuk do të ketë kush t’ju ndihmojë. Dhe përmbajuni asaj më të mirës që u është shpallur nga Zoti juaj, para se t’ju vijë dënimi befás e ju të mos dini.”¹⁸⁵

Kur i përshkruan mu’minët All-llahu thotë:

“Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetës së tyre, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë

¹⁸³ El-Mearixh: 27-29.

¹⁸⁴ El-En’Am: 17.

¹⁸⁵ Ez-Zumer: 54-55.

mëkatet përveç All-llahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen). ”¹⁸⁶

5. Të mbështeturit në All-llahun dhe të kërkuarit e ndihmës vetëm nga Ai

Thelbi i të mbështeturit: Sinqeriteti i zemrës gjatë mbështetjes ekskluzivisht në All-llahun, në realizimin e interesit dhe nevojave, në menjanimin e mohimeve të kësaj bote dhe të Ahiretit. All-llahu në gjithësi i ka vendosur dispozitat, ligjet dhe shkaqet, kurse ibadeti jonë është në harmoni me to. Njëra nga mënyrat më të forta për realizimin e shkakut është të mbështeturit në All-llahun. All-llahu thotë:

“Kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij, All-llahu realizon dëshirën e Vet dhe All-llahu çdo gjëje ia ka caktuar kohën (afatin). ”¹⁸⁷

All-llahu gjithashtu thotë:

“Musai tha: »O populli im, nëse i keni besuar All-llahut, vetëm Atij mbështetjuni, nëse jeni të dorëzuar (vendimit të Tij)«! ”¹⁸⁸

“...vetëm All-llahut le t’i mbështeten mu’minët (besimtarët). ”¹⁸⁹

All-llahu robërit e Vet i ka urdhëruar që gjatë çdo namazi të shqiptojnë...

“Vetëm Ty të bëjmë ibadet dhe vetëm te Ti kërkojmë ndihmë!. ”¹⁹⁰

¹⁸⁶ Ali Imran: 135.

¹⁸⁷ Et-Talak: 3.

¹⁸⁸ Junus: 84.

¹⁸⁹ Et-Tegabun: 13.

¹⁹⁰ El-Fatiha: 5.

Në hadithin e nderuar, gjithashtu qëndron:

“Kur ndihmë kërkon, kërko ekskluzivisht nga All-llahu!”¹⁹¹

b) Ibadeti në fjalë

1. Të shqiptuarit e dy shehadeteve

Islami i një njeriu nuk është i plotë, nëse nuk i shqipton dy shehadetet, përveç se në rast se njeriu të jetë memec, kur do të mjaftojë çfardo shenje, e cila do të tregonte për imanin e tij. I Dërguari i All-llahut thotë:

“Më është udhëruar që të luftoj kundër njerëzve gjithnjë derisa nuk dëshmojnë që nuk ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut dhe që Muhammedi s'është rob dhe i Dërguar i All-llahut, derisa nuk fillojnë ta falin namazin dhe ta japin zekatin, kur fillojnë që ta bëjnë këtë, nga unë e kanë të siguruar gjakun e tyre dhe pasurinë, vetëm sipas ligjeve të islamit, ndërsa përgjegjësinë e tyre do ta bartin para All-llahut.”¹⁹²

2. Të përmendurit, të madhëruarit e All-llahut dhe të kërkuarit e faljes nga Ai

All-llahu thotë:

“O ju që besuat, përkujtoni All-llahun sa më shpesh. Dhe madhëronie Atë mëngjes e mbrëmje.”¹⁹³

“E të kërkonit falje Zotit tuaj dhe pendohuni (kthehuni)

¹⁹¹ Pjesë nga hadithi, të cilin e transmetojnë Ahmed dhe Tirmidhiu nga Ibn Abbasi.

¹⁹² Në pyetjen e besueshmërisë së hadithit, të dy imamët pajtohen - Mutefikun Alejh.

¹⁹³ El-Ahzab: 41-42.

tek Ai, se Ai do t'ju mundësojë përjetime të mira (në këtë jetë) deri në një afat (të caktuar) dhe çdo punëmiri i jep shpërblimin e merituar. Në qoftë se refuzojnë (të kërkojnë falje), unë pra kam frikë për ju, dënimin e Ditës së Madhe.”¹⁹⁴

“Ti, pra, lartësoje Zotin tënd duke falënderuar dhe kërko nga Ai falje. Ai vërtet pranon shumë pendimin, është Mëshirues i Madh.”¹⁹⁵

3. Duaja dhe të kërkuarit e ndihmës

Ai i cili lutet dhe kërkon ndihmë, është i mençur vetëm atëherë, nëse atë ndihmë e kërkon nga Ai, i Cili dëgjon në çdo kohë dhe në çdo vend, pa marrë parasysh se në çfarë gjuhe (lutësi) lutet dhe kërkon ndihmë.

Është i mençur edhe atëherë kur i lutet Atij, në të Cilin është i bindur që Ai mund ta dëgjojë lutjen e tij dhe t'ia plotësojë dëshirën, t'ia largojë fatkeqësinë dhe t'i kënaqë nevojat e tij, që me shkaktarë të padukshëm dhe fuqi mbinatyrore paprekshëm dominon mbi këtë Kozmos.

Natyrisht kjo i përket ekskluzivisht All-llahut, sepse këtë nuk është në gjendje ta bëjë asnjëra nga krijesat e Tij, qofshin ato të gjalla ose të vdekura. Ndërkaq, kush beson që dikush tjetër përveç All-llahut mund të bëjë diç nga këto dhe ia drejton duat e veta, ai bie në shirk. All-llahu thotë:

“Ai është që e zgjat natën në pjesë të ditës dhe e zgjat ditën në pjesë të natës, i nënshtroi diellin dhe hënën që secili lëviz (udhëton) deri në afatin e caktuar. Ky është All-llahu, Zoti juaj, i tërë sundimin është i Tij, e ata që i

¹⁹⁴ Hud: 3.

¹⁹⁵ En-Nasr: 3.

lutni në vend të Tij, nuk posedojnë as sa një cipë (e hurmave, fije). Nëse ata i thirrni, ata nuk dëgjojnë thirrjen tuaj, po të zëmë se dëgjojnë nuk mund t'ju përgjigjen juve në Ditën e Kijametit, ata do të mohojnë adhurimin tuaj ndaj tyre. E askush nuk të informon ty si i Dijshmi (All-llahu).”¹⁹⁶

“Zoti juaj ka thënë: »Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë të nënçmuar në xhehennem«.”¹⁹⁷

All-llahu gjithashtu thotë:

“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të Më besojnë Mua.”¹⁹⁸

Nëse ai, i cili lutjet e veta ia drejton dikujt tjetër përveç All-llahut, është i paditur-xhahil, detyrë e atij që di është: që t'ia tërheq vërejtjen dhe t'i shpjegojë, kurse ai i (padituri) është i obliguar që të shpëtojë nga ky mashtrim dhe të lirohet nga shirku.

4. Të betuarit në All-llahun

Muslimani betohet ekskluzivisht në All-llahun.

Në këtë mënyrë ai e madhëron Atë dhe ia shpreh besnikërinë e vet. I Dërguari i All-llahut sava thotë:

“Kush betohet, le të betohet në All-llahun ose le të heshtë.”¹⁹⁹

Kush betohet në diç tjetër, duke ia përshkruar

¹⁹⁶ Fatir: 13-14.

¹⁹⁷ Gafir: 60.

¹⁹⁸ El-Bekare: 186.

¹⁹⁹ El-Buhariu, Muslimi, En-Nesaiu nga Abdull-llah ibn Amri.

madhështinë, ose frikësohet nga ai sikur nga All-llahu, ai padyshim bie në shirk. I Dërguari i All-llahut thotë:

“Kush betohet në diç tjetër përkras All-llahut, ka bërë shirk!”²⁰⁰

Të betuarit në amanetin gjithashtu nuk është i lejuar, sipas hadithit të të Dërguarit të All-llahut:

“Kush betohet në amanet, ai nuk na takon neve!”²⁰¹

5. Të mbështeturit në All-llahun, të nxiturit për të mirën dhe të ndaluarit nga e keqja

All-llah thotë:

“E kush flet më mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: »Unë jam prej muslimanëve«?»²⁰²

Thua: »Kjo është rruga ime, thërrasim tek All-llahu unë dhe çdonjëri që më pason mua me syçeltësi. Larg të metave është All-llahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.«²⁰³

“Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.”²⁰⁴

c) Ibadetet praktike

1. Të falurit e namazit

²⁰⁰ Transmeton Tirmidhiu, Ibn Maxhe, Ahmed, En-Nesaiu dhe Ed-Darimi.

²⁰¹ Ahmed dhe Ebu-Dawudi.

²⁰² Fussilet: 33.

²⁰³ Jusuf: 107.

²⁰⁴ Ali Imran: 104.

All-llahu thotë:

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ai është Dini i drejtë.”²⁰⁵

“Ata janë njerëz që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend për ta përmendur All-llahun, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zekatin, ata i frikësohen një Dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.”²⁰⁶

“(Ai ndihmon) Ata të cilët kur Ne u mundësojmë vendosjen në Tokë, e falin namazin, japin zekatin, urdhërojnë për të mirë dhe largojnë prej të keqes. All-llahut i takon përfundimi i çështjeve.”²⁰⁷

“Urdhëro familjen tënde të falë namaz, e edhe ti vetë zbatoje atë, ngase Ne nuk kërkojmë prej teje ndonjë furnizim (për ty as për familjen tënde), Ne të furnizojmë ty (dhe ata), ardhmëria e mirë është e atij që ruhet.”²⁰⁸

2. Kryerja e obligimeve të zekatit

“E duke qenë se ata nuk ishin të urdhëruar me tjetër, pos që ta adhuronin All-llahun me një adhurim të singertë ndaj Tij, që të largohen prej çdo besimi të kotë, ta falin namazin, të japin zekatin, se ai është Dini i drejtë.”²⁰⁹

“Kryeni faljen (namazin) dhe jepne Zekatin, e çfarëdo të

²⁰⁵ El-Bejjine: 5.

²⁰⁶ En-Nur: 37.

²⁰⁷ El-Haxh: 41.

²⁰⁸ Ta Ha: 132.

²⁰⁹ El-Bejjine: 5.

mirë që e përgatitni për veten tuaj, atë e gjeni tek All-llahu.”²¹⁰

“Po ata, prej tyre që kanë thesar të diturisë dhe besimtarët, besojnë atë që t’u shpall ty dhe atë që u shpall para teje, besojnë edhe ata që e falin namazin dhe japin zekatin dhe besimtarët në All-llahun e në jetën e ardhme. Të tillëve do t’u japim shpërblim të madh.”²¹¹

3. Agjërimi i Ramadanit²¹²

All-llahu thotë:

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.”²¹³

“(ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në te (filloi të) shpallet Kur’ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj (në shtëpi), le të agjërojë...”²¹⁴

I Dërguari i All-llahut thotë:

“Kush agjëron Ramadanin me iman të fortë duke pritur shpërblimin e All-llahut, do t’i falen mëkatet që i ka bërë

²¹⁰ El-Bekare: 110.

²¹¹ En-Nisa: 162.

²¹² Sh.r. Këtu në vend të shprehjes shqipe Ramazan përdorëm shprehjen arabe Ramadan, ashtu që të jemi as më afër origjinalitetit. Po ashtu lexues të nderuar edhe më parë keni hasur në këto shprehje të cilat ne i përdorëm, për shkak se në disa raste shprehja në origjinal ka kuptim më të gjerë derisa shprehja në gjuhën shqipe është e përkufizuar. Shpresojmë se kemi arsye për këtë, e Allahu më së miri e di.

²¹³ El-Bekare: 183.

²¹⁴ El-Bekare: 185.

deri më tani (deri në muajin e Ramadanit)?!”²¹⁵

4. Obligimi i kryerjes së Haxhshit për ata që kanë mundësi

All-llahu thotë:

“Për hirë të All-llahut, vizita e shtëpisë (Ka’bes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi te ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); All-llahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që e bëjnë) njerëzit.”²¹⁶

“Dhe thirr ndër njerëz për haxhshin, se të vijnë ty këmbësorë e edhe kalorës me deve të rraskapitura që vijnë prej rrugëve të largëta.”²¹⁷

I Dërguari i All-llahut thotë:

“Islami themelohet mbi pesë kushte:

-Të dëshmuarit që nuk ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet përveç All-llahut dhe që Muhammedi savs është rob dhe i Dërguar i All-llahut, -falja e namazit, -dhënia e zekatit, -kryerja e Haxhshit dhe -të agjëruarit e Ramadanit.”²¹⁸

5. Të udhëhequrit sipas ligjeve të All-llahut

Askush nuk ka të drejtë që të vendosë ligje dhe urdhëra për njeriun, përveç Atij, i Cili atë njeri e ka krijuar, e ky është All-llahu i Cili thotë:

“...vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi. I madhëruar

²¹⁵ Buhariu, Tirmidhiu, Ebu Dawudi, Ibn Maxhe, Nesaiu dhe Ahmedi nga Ebu-Hurejre.

²¹⁶ Ali Imran: 97.

²¹⁷ El-Haxhxi: 27.

²¹⁸ Hadith i besueshëm-sahih.

është All-llahu, Zoti i botëve.²¹⁹

Andaj kush veten, ose dikend tjetër e vë në rolin e ligdhënësit, që i sjell ligjet, urdhërat dhe i rivendos sistemet, e të cilat nuk janë të lejuara nga All-llahu, duke konsideruar që janë më të mira dhe më të vlefshme se sa ato të Islamit, ai ka bërë shirk dhe ai ndërhyr që t'i bëhet ibadet dikujt tjetër përveç All-llahut. All-llahu thotë:

“A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fe, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?”.²²⁰

“...vendimi (gjykimi) nuk i takon kujt, pos All-llahut, e Ai urdhëroi të mos adhuronit tjetër vetëm Atë.²²¹

Mu'mini plotësisht i dorëzohet gjykimit të All-llahut dhe absolutisht i nënshtrohet urdhërave të Tij. All-llahu gjithashtu thotë:

“Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty e as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht.²²²

6. Xhiahadi në rrugë të All-llahut

All-llahu thotë:

“O ju që keni besuar, a t'ju tregoj për një tregti të bujshme që ju shpëton prej një dënimi të dhembshëm: T'i besoni All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, të luftoni në rrugën e All-llahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj, e kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse jeni që e

²¹⁹ El-A'raf: 54.

²²⁰ Esh-Shura: 21.

²²¹ Jusuf: 40.

²²² En-Nisa: 65.

dini.”²²³

*“A mos menduat ju se do të hyni në xhennet e All-llahu pa i ditur (pa u vërtetuar në praktikë) se cilët prej jush kanë luftuar dhe pa u ditur cilët prej jush ishin të durueshëm.”*²²⁴

7. Të betuarit në All-llahun

All-llahu thotë:

*“Ata janë që zbatojnë premtimet e tyre dhe i frikësohen një Dite dëmi i së cilës ka përmasa të mëdha.”*²²⁵

I Dërguari i All-llahut ka thënë:

*“Kush betohet që do t’i nënshtrohet All-llahut, le ta përmbush atë, ndërsa kush betohet që do të bëjë mëkat ndaj Tij, mos të bëjë mëkat!”*²²⁶

8. Tawafi rreth Ka’bës

All-llahu thotë:

*“Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: ju të dy pastrone shtëpinë Time për vizituesit, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falen aty.”*²²⁷

*“...dhe le të sillen (bëjnë tawaf) rreth shtëpisë së lashtë.”*²²⁸

9. Të therurit e kurbanit

²²³ Es-Saff: 10-11.

²²⁴ Ali Imran: 142.

²²⁵ El-Insan: 7.

²²⁶ Ahmedi, Buhariu, Tirmidhiu dhe të tjerët nga Aishja, All-llahu qoftë i kënaqur me të.

²²⁷ El-Bekare: 125.

²²⁸ El-Haxh: 29.

All-llahu thotë:

***“Thuaj: »Namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)«!*”²²⁹**

Të therurit e kurbanit është njëra nga ceremonitë për të cilën All-llahu thotë:

***“Andaj, ti falu dhe ther kurban për hirë të Zotit tënd.”*²³⁰**

Aliu b. Ebu Talibi transmeton që i Dërguari i All-llahut s'ka thënë:

***“All-llahu e ka mallkuar atë, i cili diç ther, përveç në emër të All-llahut!”*²³¹**

E para: Sinqeriteti i nijjetit për ibadet

Kush dëshiron t'i bëjë ibadet Zotit të vet, atij i duhet vendimi i sinqertë, me të cilin do t'i mposhtë pakujdesinë dhe përtacinë dhe i cili do ta motivojë për përpjekje të shumta, për arritjen e nënshtrimit ndaj All-llahut, që fjalët e tij ta fitojnë mbulesën reale, përkatësisht, të zbatohen në praktikë. All-llahu thotë:

***“O ju që besuat, pse po e thoni atë që nuk e punoni?”*²³²**

Ai i cili dëshiron që ta fuqizojë vendimin e vet, duhet të shoqërohet me njerëz të vyer dhe me njerëz të hajrit.

All-llahu thotë:

²²⁹ El-En'Am: 162-163.

²³⁰ El-Kewther: 2.

²³¹ Muslimi, Ahmdei dhe En-Nesaiu.

²³² Es-Saff: 2.

“Atë ditë zullumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: »I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e të Dërguarit! O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e shejtani është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar«.”²³³

E dyta: Të besuarit në melaiket

Njëri nga kushtet themelore të imanit është të besuarit në melaiket.

“I Dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi All-llahut, melaikeve të Tij, Librave të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij dhe thanë: »Iu përgjigjëm (thirrjes) dhe respektuam (urdhërin). Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë«.”²³⁴

*“Ndërkaq, melaiket vazhdimisht madhërojnë (bëjnë tesbih) duke e falënderuar Zotin e tyre dhe kërkojnë falje të mëkateve për ata (besimtarët) që janë në tokë.”*²³⁵

*“S’ka dyshim se ata që janë pranë (afër) Zotit tënd (melaiket) nuk tërhiqen nga adhurimi ndaj Tij nga mendjemadhësia, Atë e madhërojnë dhe vetëm Atij i bëjnë sexhde.”*²³⁶

“Kush është armik i All-llahut, i melaikeve të Tij, i të dërguarve të Tij, i Xhibrilit dhe i Mikailit (ai është

²³³ El-Furkan: 27-29.

²³⁴ El-Bekare: 285.

²³⁵ Esh-Shura: 5.

²³⁶ El-A’raf: 206.

jobesimtar), All-llahu është pa dyshim armik i mosbesimtarëve.”²³⁷

Argumentet mbi të besuarin në melaiket janë të shumta në Kur'an dhe Sunnet. All-llahu melaiket i ka krijuar nga nuri-drita. Të besosh në melaiket, do të thotë, të pranosh me bindje të plotë që ato ekzistojnë, që ato janë krijesa të ndershme dhe të nënshtruara ndaj All-llahut. All-llahu thotë:

“Që nuk flasin para Tij, ato (melaiket) veprojnë me urdhërin e Tij.”²³⁸

“...nuk e kundërshtojnë All-llahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruara.”²³⁹

“E ata që janë pranë Tij (melaiket), nuk shprehin mendjemadhësi në adhurim ndaj Tij, e as nuk u bëhet (ibadeti) monoton. Ata lartësojnë (All-llahun) natë e ditë dhe nuk mërziten.”²⁴⁰

All-llahu melaiket i ka ndarë në grupe. Disa janë të ngarkuara që t'ua sjellin shpalljen të dërguarve, si “shpirti besnik” Xhibrili assa, disa janë të obliguara që ta ndajnë shpirtin nga trupi, si meleku i vdekjes dhe ndihmësit e tij. Israfilë është i obliguar me “surin” - burinë, me të cilin do ta lajmërojë Ditën e Kijametit, disa janë të ngarkuara për shiun, si Mikaili, disa për veprat e njeriut “Kiramun Katibun”, ndërsa disa për t'i ruajtur robërit e All-llahut përpara dhe mbrapa. All-llahu thotë:

“Ai (njeri) ka përcjellës një pas një, para tij dhe prapa tij,

²³⁷ El-Bekare: 98.

²³⁸ El-Enbija: 27.

²³⁹ Et-Tahrim: 6.

²⁴⁰ El-Enbija: 19-20.

***që me urdhërin e All-llahut e ruajnë atë.*”²⁴¹**

Disa janë të ngarkuara me xhennetin dhe me begatitë e tij, si Ridvani dhe ata që janë me të. Disa me xhehennemin dhe dënimin me të, si Maliku dhe të tjerët nga grupi “Zebanit” e ata janë nëntëmbëdhjetë. Disa janë të ngarkuara me sprovat e varrit-kaburit, disa janë të ngarkuara me bartjen e Arshit, kurse disa janë të ngarkuara me pikat e farës në mitrat dhe zhvillimin e frytit - vazhdimisht derisa shpirti merr frymë.

Ka melaïke që e vizitojnë Ka'bën²⁴², ashtu që në të hyjnë shtatëdhjetë mijë melaïke, të cilat nuk kthehen më. Disa melaïke udhëtojnë duke i vizituar mexhliset-tubimet, në të cilat përmendet emri i All-llahut, disa janë në safe në kijam dhe ato nuk lodhen, disa bëjnë sexhde duke mos i ngritur kokat, kurse disa këtu as nuk janë përmendur:

***“...e ushtrinë e Zotit tënd nuk e di kush pos Atij, e ai (Sekari), nuk është tjetër vetëm se një përkujtim për njerëz.”*²⁴³**

Tekstet mbi këto grupe të melaïkeve nga Kitabi dhe Sunneti janë të shumta dhe të njohura për dijetarët.

E treta: Të besuarit në Libra

Të besuarit në Kitabet-Librat, do të thotë, të jesh i bindur, që të gjitha këto Libra janë shpallur nga All-llahu dhe që All-llahu me të vërtetë ka folur përmes këtyre Librave.

²⁴¹ Er-Rra'd: 11.

²⁴² sh.r. nuk është fjala për Ka'bën që gjindet në Mekke, por, për atë që gjindet në Qiell dhe quhet Bejtu-l-Ma'mur.

²⁴³ El-Mudethir: 31.

All-llahu thotë:

“O ju që besuat, besoni vazhdimisht All-llahut, të Dërguarit të Tij, librit që gradualisht ia shpalli të Dërguarit të Tij dhe librit që e patë zbritur më parë. Kush nuk i beson All-llahut melaikëve të Tij, Librave të Tij, të dërguarve të Tij dhe Ditës së Gjykimit, ai ka humbur tepër larg.”²⁴⁴

Disa Libra, të dërguarve i janë shpallur në mënyrë direkte pa ndërmjetësues (i dërguar - melaikë), kurse disa Libra, meleku - i dërguar ia ka transmetuar të Dërguarit - njeriut. All-llahu thotë:

“Nuk ka asnjë njeri që t’i ketë folur All-llahu ndryshe, vetëm se me anën e frymëzimit, ose pas ndonjë perdeje, ose t’i dërgojë të dërguar (melek), e ai t’i shpallë me lejen e Tij atë që do Ai.”²⁴⁵

All-llahu i thotë Musa-it assa:

“Ai (All-llahu) tha: “O Musa, Unë të gradova ty mbi njerëzit me shpalljen Time dhe me të folurit Tim. Merr atë që të dhash dhe bëhu mirënjohës.”²⁴⁶

“...e Musait i foli All-llahu me fjalë.”²⁴⁷

“Dhe i përshkruan atij në pllaka çdo gjë (që i nevojitej), si këshillim dhe sqarim për secilin send.”²⁴⁸

Për Isa-in, thotë:

“...dhe atij ia dhamë Ingjilin,...”²⁴⁹

“...e Dawudit i patëm dhënë Zebur-in.”²⁵⁰

²⁴⁴ En-Nisa: 136.

²⁴⁵ Esh-Shura: 51.

²⁴⁶ El-A'raf: 144.

²⁴⁷ En-Nisa: 164.

²⁴⁸ El-A'raf: 145.

²⁴⁹ El-Hadid: 27.

Në pikëpamje të Kur'anit All-llahu thotë:

“(Jehuditë i thanë se nuk të besojmë në shpallje Muhammedit savs) Por All-llahu dëshmon për atë që t’u zbrit ty, atë ta zbriti sipas dijes së Vet, edhe melaiket dëshmojnë, po mjaft është All-llahu dëshmues.”²⁵¹

“Dhe (ta shpallëm) Kur'anin që Ne e ndamë pjesë-pjesë për t’ua lexuar njerëzve dalngadalë dhe ashtu e shpallëm atë një pas një.”²⁵²

“E edhe ai (Kur'ani) është shpallje (zbritje) e Zotit të botëve. Atë e solli shpirti besnik (Xhibrili). (E solli) në zemrën tënde, për të qenë ti prej atyre që tërheqin vërejtjen (të dërguar). (Të shpallëm) Me gjuhë të kulluar arabe.”²⁵³

“Atij nuk mund t’i mvishet e pavërteta nga asnjë anë; është i zbritur prej të Urtit, të lavdishmit.”²⁵⁴

Librat, të cilët All-llahu i ka cekur në Kur'an, janë: **Kur'ani, Inxhili, Tewrati, Zeburi dhe Suhufet** që u janë dërguar Ibrahimit dhe Musait:

All-llahu thotë:

“All-llahu është Një, e nuk ka të adhuruar (Zot) pos tij, është i përjetshëm mbikëqyrës. Ai ta zbret ty (Muhammed) librin me të vërtetën, që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tewratin dhe Inxhilin.”²⁵⁵

“...e Davudit i patëm dhënë Zeburin.”²⁵⁶

²⁵⁰ En-Nisa: 163.

²⁵¹ En-Nisa: 166.

²⁵² El-Isra: 106.

²⁵³ Esh-Shuara: 192-195.

²⁵⁴ Fussilet: 42.

²⁵⁵ Ali Imran: 2-3.

²⁵⁶ En-Nisa: 163.

“Apo nuk është informuar me atë që është në suhufet-fletushkat e Musait. Dhe të Ibrahimit, që gjithnjë i plotësoi obligimet.”²⁵⁷

Të tjerët All-llahu i përmend të gjithë së bashku dhe thotë:

“Ne i dërguam të dërguarit Tonë me dokumente (argumente) të qarta dhe Ne zbritëm me ata Librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës.”²⁵⁸

²⁵⁷ En-Nexhm: 36-39.

²⁵⁸ El-Hadid: 25.

KUR'ANI KERIM

Vendi i Kur'anit në lidhje me librat e mëparshëm

All-llahu thotë:

“Ne edhe ty (Muhammed) ta zbritëm librin (Kur'anin) e vërtetë që është vërtetues i librave të mëparshme dhe garantues i tyre. Gjyko, pra, mes tyre me atë që All-llahu e zbriti, e mos pëlqe epshet e tyre e të largohesh nga e vërteta që të erdhi. Për secilin prej jush, Ne caktuam ligj e program (të posaçëm në çështje të veprimit). Sikur të donte All-llahu, do t'ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t'ju sprovovë në atë që iu dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquini për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu, e Ai do t'ju njoftojë me atë që kundërshtoheshi.”²⁵⁹

“Nuk është e logjikshme të mendohet se ky Kur'an është i trilluar prej dikujt, por është zbritur prej All-llahut, e është vërtetues i asaj (shpalljes) që ishte më parë dhe sqarues e komentues i librit. Nuk ka farë dyshimi se

²⁵⁹ El-Maide: 48.

është (i zbritur) nga Zoti i botëve.”²⁶⁰

“E atyre që Ne ua dhamë librin përpara këtij, disa prej tyre i besojnë këtij (Kur'anit). Dhe kur u lexohet atyre, thonë: »Ne i kemi besuar atij, ajo është e vërtetë prej Zotit tonë, ne edhe para tij kemi qenë myslimanë!”²⁶¹

Obligimi i tërë Ummetit është që t'i përmbahen Kur'anit

I tërë Ummeti është i obliguar që haptazi dhe fshehurazi t'i përmbahen Kur'anit dhe t'i zbatojnë principet-urdhërat e tij.

All-llahu thotë:

“Dhe këtë Libër, dobiprurës, Ne e zbritëm, përmbajuni këtij, ruajuni ashtu që të mëshiroheni.”²⁶²

“Pasoni atë që ju është zbritur nga Zoti juaj, e mos zini miq (përkrahës) pos Tij.”²⁶³

“Po atyre që i përmbahen librit dhe falin namazin, Ne nuk u humbim shpërblimin të mirëve.”²⁶⁴

Ajetet mbi këtë janë të shumta, ndërsa i Dërguari savs na obligoi me Librin:

“Merreni Librin e All-llahut dhe përmbajuni rreptësisht!”

Në hadithin e Aliut rda, i cili rrjedh nga i Dërguari savs, qëndron:

“Me të vërtetë do të shfaqet ngatërrim i madh!” “Si të ruhemi nga ai, o i Dërguar i All-llahut? - kam pyetur.

²⁶⁰ Junus: 37.

²⁶¹ El-Kasas: 52-53.

²⁶² El-En'Am: 155.

²⁶³ El-A'raf: 3.

²⁶⁴ El-A'raf: 170.

“Përmbajuni Librit të All-llahut” - u përgjigj i Dërguari i All-llahut.²⁶⁵

Zbatimi konsekuent i Kur`anit

Islami, pjesëtarët e vet i nxiti shumë në mësimin e Kur`anit përmendsh, në leximin e Tij ditën dhe natën, në të menduarit mbi ajetet e tij, në të lejuarit e asaj që Ai ka lejuar, në të ndaluarit e asaj që Ai ka ndaluar, në të nënshtruarit urdhërave të Tij, në turp përpara qortimeve të Tij, në mësim mbi shembujt dhe të treguarit e Tij, në të vepruarit sipas dispozitave (urdhërave) të Tij, në pranimin e paqartësisë në të, ashtu si i ka hije përsosurisë së All-llahut, pa përfytyruar forma dhe dimensione dhe në ndalimin e përhershëm përpara kufijve të Tij, në pengimin me xhelozitë të atyre që tentojnë ta ndryshojnë përmbajtjen e Tij, ose në përhapjen e jo të vërtetave mbi Të, në dhënien e këshillave dhe udhëzimeve duke i shfrytëzuar të gjitha domethëniet e Tij dhe të thirrurit në Të, në mënyrë të arsyeshme dhe fisnike.

Premtimi i All-llahut, për ruajtjen e Kur`anit

All-llahu ka garantuar ruajtjen e Kur`anit nga çfardo ndryshimi, nga çfarëdo shtrembërimi nga të shtuarit ose të hequrit-marrurit diç prej tij-Kur`anit. All-llahu thotë:

“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur`anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.”²⁶⁶

Qëllimi i ruajtjes së Kur`anit është që argumenti i All-llahut të jetë i përfundimshëm për njerëzimin dhe si i tillë nuk

²⁶⁵ Transmeton Tirmidhiu, e konsideron të dobët.

²⁶⁶ El-Hixhr: 9.

do të kishte mundur të jetë argument kur nuk do të ishte vazhdimisht prezent në mesin e tyre, i ruajtur gjithnjë deri në Ditën e Kijametit, që njerëzit t'i kthehen vazhdimisht, dhe nga Ai të mësojnë Dinin e vet, bazat e Tij, principet, qëllimet dhe të njiheshin me dispozitat e ligjeve të All-llahut, t'i kuptonin obligimet dhe detyrat e veta, ndalesat dhe vlerat dhe qëllimet e larta dhe fisnike në të cilat i nxitë Ai - Kur'ani. Që nga kontekstet e Tij të nxjerrim konkluzione dhe urdhëresa për shumë dispozita të sherijatit, të lidhura me rrethana të ndryshme në jetën e njerëzve, t'i shfrytëzojnë mësimet e Tij të arta, këshillat, shembujt e fuqishëm (vulosur), normat e sjelljes, vërejtjet, kërcënimet, premtimet dhe mjetet tjera të ndryshme, metodat edukativo-edukuese, të cilat të shpiejnë kah rruga **siratal mustekim** - rruga e drejtë.

Dëshmitar i ruajtjes së Tij

Çdo njeri i arsyeshëm është i obliguar, që bindshëm të besojë, që Kur'ani, të cilin ai sot e lexon, është i njejtë me Kur'anin, i Cili i është shpallur Muhammedit savs.

Sikur dikush ta merrte një ajet nga Libri i All-llahut e të shkonte në Londër, Paris, Moskë, Washington, Peking ose Tel Aviv, sikur me të të qarkullonte nëpër të gjitha qytetet e Afrikës, Austrisë, pastaj të shkonte në Meke në Medine, e ta merrte Musafin nga këto qytete dhe ta hapte surën nga e cila e ka marrë këtë ajet, do të shihte që ky është një dhe i njejtë Kur'an, që ajeti i marrur është ajeti i njejtë.

Ka për të parë, që çdo gjë që gjendet mes këtyre dy kopertinave të Librit është një ligjeratë komplete, të cilën është e pamundur ta ndryshosh ose ta shtrembërosh. Dhe me të vërtetë, të vërtetën e ka thënë All-llahu:

“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi Jemi mbrojtës të Tij.”²⁶⁷

Sunneti ~ komentues i Kur'anit dhe mënyra e ruajtjes së Tij

All-llahu thotë:

“Ty ta zbritëm Kur'anin (Dhikrin) që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do të logjikojnë.”²⁶⁸

I Dërguari i All-llahut njerëzve ua ka shpjeguar-sqaruar Librin e Zotit të vet, me fjalë, vepra dhe me pajtueshmëri të pakontestueshme. Këto sqarime të të Dërguarit savs, All-llahu i ka ruajtur në librat e Sunnetit të të Dërguarit savs, të cilët Ummeti i tij i tubonte dhe i shënonte me kujdes. All-llahu Sunnetin e të Dërguarit savs e ruajti edhe me atë, që shumicën e njerëzve i bëri Hafidh, të cilët me xhelozi dhe kujdes mësonin përmendsh çdo gjë, që ishte e lidhur me të, të cilët mbanin halk-orë të mësimi, duke i mësuar të gjithë ata që nuk e njihnin Sunnetin e tij.

Ekzistonin njerëz të cilët i mbanin në mend me mijëra hadithe të të Dërguarit savs, me gjithë zinxhirët e transmetuesve dhe shkallët e tyre, sikurse që janë: Buhariu, Muslimi autor i gjashtë vëllimeve dhe të tjerë. E kjo është për atë, sepse hadithet e të Dërguarit savs janë komentues të Librit dhe pjesë të Dinit, i cili e jep orarin komplet ditor të jetës njerëzore, përmes namazit, agjërimit, zekatit, haxhit, përmes shitjes, blerjes, përmes martesës ose divorcit (shkurorëzimit) përmes marrëdhënieve familjare dhe fqinjësore, përmes të të gjithave që është i

²⁶⁷ El-Hixhr: 9.

²⁶⁸ En-Nahl: 44.

obliguar njeriu ndaj Zotit të vet dhe ndaj Ummetit të vet. Të gjitha këto janë të mbledhura dhe të ruajtura me precizitet.

All-llahu e zgjodhi Ummetin më të mirë për ruajtjen e Librit të Tij dhe Sunnetin e të Dërguarit savs

Duke pasur parasysh, që i Dërguari savs ishte vulë e të dërguarve, All-llahu ia garantoj ruajtjen e Dinit me të cilin është dërguar deri në Ditën e Kijametit, nga çfardo ndryshimi ose shtrembërimi.

Për këtë All-llahu i përgatiti as’habët për të cilët ka thënë:

“Ju jeni populli (gjenerata) më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve,...”²⁶⁹

“Dhe ashtu (sikur u udhëzuam në fenë islame) Ne u bëmë juve një Ummet (pupull) të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në Ditën e Gjykimit) ndaj njerëzve dhe për të qenë Resuli dëshmitarë ndaj jush...”²⁷⁰

I Dërguari savs i ka përshkruar si ***“gjeneratë më e mirë”***!

Nëse epshet dhe ëndjet janë shkaktarë kryesorë të shtrembërimeve dhe ndryshimeve, All-llahu i përgatiti as’habët në mënyrë të veçantë, që Dinin ta vendosin me kosekuencë dhe ta ruajnë për të gjitha gjeneratat që do të vijnë.

“E, dinie se në mesin tuaj e keni të Dërguarin e All-llahut. Sikur ai t’ju dëgjonte juve në shumë çështje, ju do

²⁶⁹ Ali Imran: 110.

²⁷⁰ El-Bekare: 143.

të pësonit vuajtje, por All-llahu juve ua bëri të dashur besimin dhe ua zbukuroi atë në zemrat tuaja, ndërsa mosbesimin, shfrenimin dhe kundërshtimin, ua bëri që t'i urreni. Të tillë janë ata që gjetën rrugën e drejtë.”²⁷¹

Në saje të gadishmërisë së tillë, ata kanë merituar, që All-llahu t'i përshkruajë me veçori të këtilla: **“Të sinqertë dhe të shpëtuar!”**

All-llahu thotë:

“(Ajo pronë) U takon muhaxhirëve të varfër, të cilët u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe prej pasurisë së tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e All-llahut dhe që ndihmojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, të tillët janë ata të sinqertit. Edhe ata që përgatitën vendin (Medinën) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjoksat e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për të, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar.”²⁷²

Besimtarë të vërtetë

All-llahu thotë:

*“E ata që besuan, migruan dhe luftuan për rrugën e All-llahut dhe ata që strehuan dhe ndihmuan, janë besimtarë të vërtetë. Atyre u takon falje (e mëkateve) dhe furnizim në mënyrë të ndershme.”*²⁷³

²⁷¹ El-Huxhurat: 7.

²⁷² El-Hashr: 8-9.

²⁷³ El-Enfal: 74.

Ndihmësit e të Dërguarit të All-llahut dhe përkrahja e tij

All-llahu thotë:

“E nëse (robërit) duan të të tradhtojnë ty, ata më parë tradhtuan All-llahun, (nuk besuan) e Ai (të ndihmoi), të mundësoi të ngadhnjesh ndaj tyre. Alahu i di të gjitha ndodhitë, vepron me urtësinë e Tij.”²⁷⁴

Janë të ashpër ndaj kafirëve, kurse të mëshirshëm mes vete, e sexhden e bëjnë të përulur

“Muhammedi është i dërguar i All-llahut e, ata që janë me të (sahabët), janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh kah përulen (në ruku), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde), e kërkojnë prej All-llahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes...”²⁷⁵

All-llahu është i kënaqur me ta, rda.

All-llahu thotë:

“Vërtet, All-llahu qe i kënaqur me besimtarët kur ata nën hijen e atij druri të zotoheshin ty dhe Ai e dinte se ç’kishin zemrat e tyre, andaj u dhuroi qetësim dhe i shpërbleu shpejt me një fitore (çlirimin e Hajberit).”²⁷⁶

²⁷⁴ El-Enfal: 71.

²⁷⁵ El-Fet’h: 29.

²⁷⁶ El-Fet’h: 18.

Cilësitë e as'habëve që i kandidonin për udhëheqës fetar dhe popullor

Ajetet e mëparshme kanë përmendur që as'habët dalloheshin me veçori që vijnë:

***Ummeti më i mirë që u është paraqitur njerëzve.**

***Ummeti i mesëm që dëshmon për njerëz.**

***Ata janë në rrugë të drejtë, atyre All-llahu imanin ua bëri të dashur dhe e zbukuroi në zemrat e tyre, ndërsa kufrin, mëkatet dhe padëgjueshmërinë ua bëri të urrejtur.**

***Ata janë të singertë, të shpëtuar dhe besimtarë të vërtetë.**

***Të ashpër ndaj kafirëve, të mëshirshëm mes vete (ndaj besimtarëve).**

***Ata, të përulur përkulen dhe sexhden e bëjnë. All-llahu tregoi atë se ç'ka në zemrat e tyre dhe Ai është i kënaqur me ta.**

Me këtë, ata merituan që All-llahu t'i vendos halife në Tokë dhe t'ua përmbush atë që u premtoi.

Kjo është realizuar në kohën e Sunduesve të drejtë - *hulefai rashidinëve*; Ebu Bekrit, Umerit, Uthmanit dhe Aliut, të cilët janë të lidhur familjarisht me të Dërguarin e All-llahut, sepse Aishja - nëna e besimtarëve është vajza e Ebu Bekrit, Hafza është vajza e Umerit, ndërsa Rukaja është vajza e të Dërguarit të All-llahut, të cilën e martoi për Uthmanin, e pas vdekjes së saj, për të (Uthmanin) e martoi vajzën e tij të dytë Ummu Kulthum, për këtë arsye Uthmani e mori kunjën (pseudonimin) “Dhun-nurejni” - pronar i dy dritave. Mandej Muhammedi s'vazhdoi vajzën e vet Fatimën e martoi për h. Aliun dhe për të thonë “**E para në mesin e grave të xhennetit**”, sikurse që edhe Ali ibn Talibi vajzën e tij Ummu Kulthum e martoi për Umer b.

El-Hattabin.

Gjatë kohës së Muhammedit savs, hulefai-rashidinët - sunduesit e drejtë ishin ministra, të cilët shpesh i konsultonte për pyetje më të rëndësishme. Ata gjithashtu ndër të parët e pranuan islamin në Meke. I pari Ali b. Ebi-Talibi, mandej Ebu Bekri, Uthmani dhe Umeri, All-llahu qoftë i kënaqur me ta. Mbi ta dhe vlerën e tyre, në krahasim me as'habët e tjerë flasin hadithet e shumta.

Sikurse që All-llahu thotë:

“Atyre nga mesi juaj të cilët besuan dhë bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t'i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t'u dhurojë siguri. Ata Më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillë janë ata më të prishurit.”²⁷⁷

Me çdo kusht e kanë merituar të udhëhequrit e kësaj bote dhe e kanë mundësuar forcimin e Dinit, me të cilin është All-llahu i kënaqur, kanë merituar të bëhen imam, që All-llahu të ishte i kënaqur me ta, por edhe me ata që i pasonin.

“All-llahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasvendihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh.”²⁷⁸

Ky është Ummeti, përmes të cilit All-llahu e ruajti Dinin, dhe për çfarë arsye është i kënaqur me ta, ndërsa me

²⁷⁷ En-Nur: 55.

²⁷⁸ Et-Tewbe: 100.

ta janë të kënaqur të gjithë popujt, për të cilët u bënë të dashur dhe të respektuar, përkundër prejardhjes, gjuhës dhe ngjyrës.

E katërta: **Të besuarit në të dërguarit, All-llahu qoftë** **i kënaqur me ta**

Të besuarit në të dërguarit, paraqet një nga kushtet themelore të islamit. Andaj, njeriu është i obliguar të besojë në të gjithë të dërguarit e All-llahut, pa kurrfarë dallimi mes tyre.

All-llahu thotë:

***“Ju (besimtarë) thuani: »Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre të dërguarve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur«.*»²⁷⁹**

Kështu All-llahu ka shpjeguar, që ky është imani i mu’minëve të drejtë (vërtetë):

***“I Dërguari i besoi asaj që iu shpall prej Zotit të Tij, e ashtu edhe besimtarët. Secili i besoi All-llahut, melaikëve të Tij, shpalljeve të Tij, të dërguarve të Tij. Ne nuk bëjmë dallim në asnjërin nga të dërguarit e Tij dhe thanë: »Ju përgjigjëm (thirrjes) dhe respektuam (urdhërin). Kërkojmë faljen tënde o Zoti ynë! Vetëm te Ti është ardhmëria jonë«.*»²⁸⁰**

Gjithashtu ka shpjeguar, që në imamin e tillë është

²⁷⁹ El-Bekare: 136.

²⁸⁰ El-Bekare: 285.

bëmirësia.

“Nuk është tërë e mira (e kufizuar) të ktheni fytyrat tuaja kah lindja ose perëndimi, por mirësi e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, Ditës së Gjykimit, melaikeve, Librit, të dërguarëve...”²⁸¹

Nëse njeriu beson në disa të dërguar, e në disa nuk beson, duke bërë ndaj tyre dallim në të besuar, atëherë ai është kafir:

“S’ka dyshim se ata që nuk besojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, dëshirojnë të bëjnë dallim mes All-llahut dhe të dërguarve të Tij, e thonë: »Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë« e mes kësaj duan të marrin një rrugë. Të tillët janë jobesimtarët e vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët. E ata që besuan All-llahun dhe të Dërguarin e Tij dhe nuk bënë kurrfarë dallimi në asnjë prej tyre, të tillëve do t’u jepet shpërblim i merituar. All-llahu falë shumë dhe është Mëshirues.”²⁸²

Fisnikëria e dërgimit të të dërguarve

1. All-llahu të dërguarit e Vet i dërgonte që t’i njoftonte njerëzit me Zotin dhe Krijuesin e tyre dhe që njerëzimin ta ftonin për t’i bërë ibadet vetëm Atij dhe, në luftë kundër të gjitha besimeve të rrejshme.

“Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t’u thonë: »Adhuroni vetëm All-llahun, e largonu djajve (adhurimit të tyre)!«.”²⁸³

“E ti, pra, pyeti ata të dërguarit që i dërguam para teje, a

²⁸¹ El-Bekare: 177.

²⁸² En-Nisa: 150-152.

²⁸³ En-Nahl: 36.

kemi lejuar që në vend të All-llahut të adhurohen zota tjerë?²⁸⁴

“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje e të mos i kemi shpallur atij se: Nuk ka të adhuruar përveç Meje, pra Më adhuroni!”²⁸⁵

2. I dërgonte për ta vendosur Dinin, që ta ruanin, që të mos ndahen nga ai, të gjykojnë në bazë të asaj që ka ardhur nga All-llahu.

“Ai u përcaktoi juve fe atë që i pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të.”²⁸⁶

“Ne të zbritëm ty (Muhammed) Librin (Kur`anin) me plot të vërteta, që të gjykosh mes njerëzve me atë që të mësoi All-llahu. Mos i mbroj ata që tradhtojnë (mashtrojnë)”²⁸⁷

3. I dërgonte që t'i gëzonin mu'minët me atë që All-llahu u ka përgatitur si shpërblim për nënshtrim, që t'ua tërheqin vërejtjen kafirëve për pasojat e kufrit të tyre dhe që t'i përgënjeshtrojnë pretekstet e njerëzve dhe që kundër tyre të vendosin argumentet e Zotit të tyre.

All-llahu thotë:

“Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të kenë fakt (arsyetim) para All-llahut. All-llahu është i pavarur në sundimin e Vet dhe di si të veprojë.”²⁸⁸

²⁸⁴ Ez-Zuhruf: 45.

²⁸⁵ El-Enbija: 25.

²⁸⁶ Esh-Shura: 13.

²⁸⁷ En-Nisa: 105.

²⁸⁸ En-Nisa: 165.

4. I dërgonte që të jenë shembuj të lartë dhe ideal për njerëz, në sjelljen e bukur të tyre - etikën, në ibadetin e drejtë dhe qëndrueshmëri në rrugën e All-llahut, sikur që është thënë për të Dërguarin tonë savs:

“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në Ahiret, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun.”²⁸⁹

5. I dërgonte për t’i ruajtur dhe për t’i shpëtuar njerëzit nga botëkuptimet e ndryshme në jetë dhe për t’i drejtuar njerëzit kah e vërteta me të cilën All-llahu është i kënaqur.

“Ne nuk të shpallëm ty për tjetër Kur’anin, vetëm që t’u sqarosh atyre atë për çka u përçanë, (ta zbritëm) që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë.”²⁹⁰

6. I dërgonte për t’ua treguar njerëzve veprat e mira, që fisnikërojnë, e pastrojnë shpirtin e njeriut dhe në të mbjellin arsyen (vetëdijen) e hajrit:

“Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi të dëguar nga mesi tyre që t’ju lexojë ajetet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme.”²⁹¹

Virtytet e të Dërguarve, paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi ta

Të gjithë të dërguarit është e domosdoshme të dallohen me natyrë të pastër, me arsye të shëndoshë, me të folur të sinqertë, me besnikëri në predikimin e asaj me çka janë obliguar. Është e domosdoshme që të jenë të mbrojtur

²⁸⁹ El-Ahzab: 21.

²⁹⁰ En-Nahl: 64.

²⁹¹ Exh-Xhum’a: 2.

nga çdo gjë që mund të linte edhe njollën më të vogël në biografinë e njeriut, është e domosdoshme të kenë trup të shëndoshë, që do ta entuziazmojë çdo shikim dhe do ta habit çdo shije. Është e domosdoshme të kenë shpirt të fuqishëm (moral të fortë), të cilin nuk mund ta mbizotërojnë natyra as e xhinnit, e as e njeriut, sepse All-llahu është Ai, i Cili e përkrah me të gjitha këto virtyte. Këto virtyte janë të domosdoshme për të dërguarit, sepse, sikur natyra e tyre të ishte nën nivelin e njerëzve të asaj kohe, sikur arsyeja e tyre të ishte më e dobët nga arsyeja e njerëzve të asaj kohe, sikur fuqia e shpirtit të tyre të ishte e nënshtruar ndaj dikujt, sikur shpirtrat e tyre të kishin ndonjë dobësi ose dëshirë të caktuar në realizimin e asaj çka All-llahu i urdhëroi ose ua ndaloi, ose bile edhe në të nënshtruarit ndaj Tij, kur për shkak të frikës, të ndonjë dëshire, harresës ose për diç tjetër, të ishin të pafuqishëm, për predikimin e të gjithë atyre me çka All-llahu i obligoi, do të thotë; sikur në çfarëdo gjëje të kishin ndonjë mangësi, nuk do të ishin të përgatitur për këtë detyrë të veçantë të All-llahut, e cila i tejkalon të gjitha detyrat, e kjo është: detyrë e veçantë në formë të Shpalljes, në zbulimin e fshehtësive të diturisë së All-llahut, që u janë zbuluar, do të thotë; nuk do të ishin të përgatitur për këtë zgjedhje me nderë të Zotit. Sikur të mos ishin dalluar me këto virtyte, njerëzit do të kishin arsye (shkak) që t'i mohojnë dhe t'i pengojnë në thirrjen e tyre në rrugë të drejtë - **siratal-mustekim**.

Por, sa i përket cilësive tjera, i Dërguari është njeri me veti të njejta, me të cilat karakterizohen të gjitha krijesat tjera. Edhe ai ha, pi, fle, jeton në bashkëshortësi, krijon familje, sëmuret, ndonjëherë i harron gjërat që nuk janë të lidhura me kumtimin e Shpalljeve. Ndonjëherë gabon në

rënditjen e gjërave, që i përkasin gjykimit të lejuar të njeriut, por për herë i tërhiqet vërejtja për atë ku ka gabuar, ashtu që ky gabim, për arsye të domosdoshmërisë që njerëzit ta pasojnë, nuk do të ishte veprim i rregullt. Herë pas here edhe mbi të vërsulen duart e sulmuesit dhe u ekspozohet presionit dhe keqpërdorimit, kurse ndonjëherë vriten ata të cilët nuk ishin të urdhëruar me xhihad.

Të dërguarit e mëparshëm

Ishin të dërguar, për të cilët All-llahu na tregon madje edhe me numra, por kishte edhe të tillë për të cilët nuk na tregon.

“Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të dërguar të tjerë për të cilët nuk të rrëfyem, e Musait i foli All-llahu me fjalë.”²⁹²

Ashtu, ne u besojmë të gjithë të dërguarve, i pranojmë në bazë të asaj me çka All-llahu detalisht dhe përgjithësisht i përmend. Ata të dërguar, për të cilët All-llahu na tregon, janë të cekur në ajetet vijuese:

“Këto janë argumentet Tona që ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij. Ne ngrisim në shkallë të lartë atë që duam. Zoti yt çdo send e vë në vendin e vet, asgjë nuk mund t'i fshehet. Ne atij (Ibrahimit) i falëm Is'hakun dhe Jakubin dhe secilin prej tyre e udhëzuam. Më parë edhe Nuhun e patëm udhëzuar. E nga pasardhësit e tij (të Ibrahimit) udhëzuam Davudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë bamirësit. (shpërblyem) Edhe Zekerijanë, Jahjanë, Isain, Ilijasin të gjithë prej të mirëve të përsosur. (shpërbylem) Edhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Të gjithë

²⁹² En-Nisa: 164.

këta i veçuam mbi njerëzit tjerë.”²⁹³

*“All-llahu e zgjodhi (të dërguar) Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit, familjen e Imranit mbi popujt tjerë (të asaj kohe).”*²⁹⁴

*“Edhe tek (populli) Adi (dërguam) vëllain e tyre, Hudin...”*²⁹⁵

*“(Përkujto) Edhe Ismailin, Idrisin dhe Dhul-Kiflin, që të gjithë ishin të durueshëm.”*²⁹⁶

*“Edhe te (populli) Themud (dërguam) vëllain e tyre, Salihun...”*²⁹⁷

*“Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj, por ai ishte i Dërguari i All-llahut dhe vulë e të gjithë të dërguarve...”*²⁹⁸

Këta të dërguar (misionarë) All-llahu ua dërgonte popujve gjatë gjithë shekujve dhe kohëve, ashtu që nuk ka pasur popull e të mos i është dërguar resul (i dërguar), i cili i thërriste në All-llahun dhe i drejtonte kah e vërteta. All-llahu thotë:

*“Pasha All-llahun, Ne dërguam (të dërguar) te popujt që ishin para teje...”*²⁹⁹

*“...e nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar.”*³⁰⁰

*“...Çdo popull pati udhëzues (të dërguar).”*³⁰¹

²⁹³ El-En’Am: 83-86.

²⁹⁴ Ali Imran: 33.

²⁹⁵ Hud: 50.

²⁹⁶ El-Enbija: 85.

²⁹⁷ Hud: 61.

²⁹⁸ El-Ahzab: 40.

²⁹⁹ En-Nahl: 63.

³⁰⁰ Fatir: 24.

³⁰¹ Er-Rra’d: 7.

Muhammedi savs

Të dërguarit u janë dërguar ekskluzivisht secili popullit të vet, siç thotë All-llahu:

“Çdo popull pati udhëzues (të dërguar).”³⁰²

Ndërkaq Muhammedi savs i është dërguar të gjithë popujve. All-llahu thotë:

“E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.”³⁰³

“I Madhëruar qoftë Ai i Cili e shpalli Furkanin (Kur’anin, dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të Vet (Muhammedit) që të jetë qortues (këshillues) për botën.”³⁰⁴

Argumentet e të dërguarve të mëparshëm dhe mu’xhizet e tyre, i përshtateshin njerëzve të asaj kohe, mund t’i shihnin dhe të bindeshin në ato, ose lajmet mbi to me besnikëri iu transmetoheshin njerëzve të kohrave tjera, nga ata që i kanë përjetuar, ndërsa argumenti që i është dhënë Muhammedit savs dhe mu’xhiza e tij, e cila qartë e vërteton Risaletin e tij, është e pandryshueshme, përherë aktuale dhe e re, deri në ditën e Kijametit, që të jetë dëshmi e qartë për njerëzimin.

Muhammedi savs është vulë për të dërguarit dhe për lajmëtarët e fesë, çka do të thotë, që pas tij më nuk ka të dërguar, për çfarë arsye All-llahu edhe e ruajti Dinin, argumentet e tij dhe mu’xhizet e tij, të cilët e vërtetojnë Risaletin - Shpalljen e Tij, të cilën e dërgoi përmes tij.

³⁰² Er-Rra’d: 7.

³⁰³ El-Enbija: 107.

³⁰⁴ El-Furkan: 1.

E pesta: Të besuarit në Ahiret

Të besuarit në Ahiret është njëri ndër themelet kryesore të akidës - të besuarit islam.

Njeriu është i obliguar që ta shprehë atë.

Të besuarit në Ahiret nënkupton, të besuarit në kushtet dhe parashenjat, të cilat detyrimisht i prijnë Ditës së Kijametit, të besuarit në vdekje dhe çdo gjë që pason pas saj, sikurse që janë sprovat e varrit, dënimet dhe shpërblimet në varr, të besuarit në lajmërimin e Ditës së Kijametit përmes **surit** - burisë, në daljen e krijesave nga varri, të besuarit në tmerret dhe llahtarinë e Ditës së Kijametit, të besuarit në detale të lidhura me ringjalljen dhe tubimin, në hapjen e - **Suhufëve** - fletët me shënime të veprave njerëzore, me vendosjen e mizanit - peshore precize dhe e saktë, të besuarit në Urën e Siratit, në shefat - ndërhyrje për atë për të cilin do të lejojë All-llahu, hyrjen në xhennet dhe bukuritë e Tij, në xhehennem dhe tmerret e Tij dhe mbi njohuritë tjera mbi të cilat flet Kur`ani dhe Sunneti i besueshëm.

ARGUMENTET MBI TË BESUARIT NË AHIRET

Argumentet nga Kur`ani dhe Sunneti:

1. Ajetet e shumta të All-llahut, të cilat flasin mbi Ahiretin si:

“Elif, Lam, Mim. Ky është Libri në të Cilin, nuk ka dyshim, udhëzues për të devotshmit. Të cilët e besojnë të fshehtë, e falin namazin dhe prej asaj që Ne i kemi furnizuar, japin. Dhe ata të cilët e besojnë atë që t’u shpall Ty, dhe atë që është shpallur para teje, dhe të cilët për Ahiretin (botën tjetër) janë të bindur.”³⁰⁵

“Kush nuk i beson All-llahut, melaikëve të Tij, librave të Tij, të dëguarve të Tij dhe botës tjetër, ai ka humbur tepër larg.”³⁰⁶

“Ata që nuk presin takimin Tonë, që janë të kënaqur me jetën e dunjasë dhe kanë gjetur prehje në të dhe ata që janë indiferentë ndaj argumenteve Tona. Vendi për të tillët është zjarri, për shkak të asaj që punuan.”³⁰⁷

“S’ka dyshim se ajo që u premtohet është e vërtetë e sigurt.”³⁰⁸

“Dhe nuk ka dyshim se Kijameti do të vijë patjetër dhe se All-llahu me siguri do t’i ngjallë ata të varrezave (të vdekurit).”³⁰⁹

³⁰⁵ El-Bekare: 1-4.

³⁰⁶ En-Nisa: 136.

³⁰⁷ Junus: 7-8.

³⁰⁸ Edh-Dharijat: 5.

³⁰⁹ El-Haxh: 7.

“Ata që nuk besuan, menduan se kurrresi nuk do të ringjallen. Thuaj: »Po, pasha Zotin tim, pa tjetër do të ringjallen dhe do të njihen me atë që keni punuar, e ajo për All-llahun është lehtë!«.”³¹⁰

“Në një ditë të madhe. Në ditën kur njerëzit ngriten (prej varrezave) për të dalë para Zotit të botëve.”³¹¹

“Betohem në Ditën e Kijametit; Betohem në shpirtin që është shumë qortues? A mendon njeriu se nuk do t’i tubojmë eshtrat e tij? Po, do t’ia tubojmë! Duke qenë se ne jemi të zotët t’ia rikrijojmë si kanë qenë edhe majat e gishtave të tij.”³¹²

“Ata u betuan në All-llahun, me betimin e tyre të fortë se »All-llahu nuk e ringjall atë që vdes!« Po, (i ringjall) ai është premtim i Tij i prerë, por shumica e njerëzve nuk dinë. I ringjall për t’ua sqaruar atyre atë për çka përçaheshin dhe për t’ua bërë me dije atyre që nuk besuan se me të vërtetë ishin gënjeshtarë. Ne kur dëshirojmë një send vetëm i themi atij: »Bëhu!«, ai menjëherë bëhet.”³¹³ e edhe ajete të shumta të cilat flasin mbi këtë.

2. I Dërguari savs na transmetonte atë, çka i thoshte Xhibrili assa. Kur e kishte pyetur: “Çka është imani?” I është përgjigjur:

“Të besosh në All-llahun, Melaiket e Tij, Librat e Tij, të dërguarit e Tij, në Ahiret dhe në përcaktimin e All-llahut, qoftë i mirë ose i keq.”

³¹⁰ Et-Tegabun: 7.

³¹¹ El-Mutaffifin: 5.

³¹² El-Kijam: 1-4.

³¹³ En-Nahl: 38-40.

Shembuj të tillë janë jashtëzakonisht të shumtë!

3. Përputhshmëria e të gjitha shpalljeve qiellore, milion të dërguar, lajmëtarë të fesë, dijetarë shkenctarë dhe robër të singertë të All-llahut dhe, bindshmëria e tyre në Ditën e Kijametit - Gjykimit dhe çdo gjëje që theksohet me të.

a) Fuqia absolute e All-llahut, Krijuesit për t'i ringjallur të gjitha krijesat pas zhdukjes së tyre përsëri, nuk është më e vështirë nga krijimi, të cilit nuk i parapriu as një shembull.

b) Jemi bindur në singëritetin e të Dërguarit savs, bartësit të argumenteve të shumta dhe mu'xhizeve të cilat e vërtetuan Risaletin - misionin e tij, e kemi kuptuar që All-llahu gjatë Isra'së, i ka mundësuar që të shohë xhennetin dhe xhehennemin, që të na e transmetojë të folurit e All-llahut azvxh, i Cili krijoi jetën në këtë botë-dunja dhe në Ahiret dhe të na lajmëroi me jetën që na pret pas vdekjes. Të kuptuarit tonë mbi Ahiretin, pra na vjen nga burimi më i sigurt, nga Ai i Cili e krijoi këtë botë dhe Ahiretin dhe nga i Dërguari i Tij, i cili e ka parë xhennetin dhe xhehennemin. Ky është premtimi i All-llahut, e All-llahu me siguri që do ta përmbush premtimin e Vet.

c) I Dërguari i All-llahut na ka lajmëruar mbi ngjarje që do të ngjajnë në këtë botë, e të cilat do të jenë parashenja dhe paralajmërime për ardhjen e shpejtë të Ditës së Gjykimit, kurse në të shumtat nga këto parashenja tani jemi bindur. Këto parashenja, në të cilat jemi bindur dhe të cilat i kemi përjetuar, na vërtetojnë qartë singëritetin

dhe vërtetësinë e fjalimit të të Dërguarit mbi momentin e Gjykimit dhe Ahiretin. Ashtu si jemi bindur në ata të dërguar, pas njëmijë e katërqind vjetësh (1400), me siguri që kemi për të parë xhennetin dhe xhehennemin.

All-llahu thotë:

“Ata të xhennetit i thërrasin (i pyesin) banuesit e zjarrit e u thonë: »Ne e gjetëm të vërtetë atë që na e pat premtuar Zoti ynë, e ju (banues të zjarrit) a e gjetët të vërtetën atë që ua pat premtuar Zoti juaj?« Ata (banuesit e zjarrit) thonë: »Po«. Atëherë në mes të tyre (mes dy grupeve) thërret një zë: »Mallkimi i All-llahut qoftë mbi zullumqarët!«”³¹⁴

d) Krijuesi i njeriut është i përsosur. Njeriu e do drejtësinë dhe nuk ka dyshim që All-llahu është Ai i Cili, që nga momenti i parë deri në momentin e fundit ia mbolli dashurinë ndaj drejtësisë. Drejtësia e të gjithë njerëzve është vetëm një grimcë nga drejtësia e All-llahut.

All-llahu është fisnik dhe absolutikisht i drejtë. Është e drejtë që, ata që bëjnë vepra të këqija të jenë të dënuar. Ndërsa, pasi që në këtë botë drejtësia kryesisht nuk realizohet, kurse ne e dimë drejtësinë e All-llahut, andaj jemi absolutisht të bindur që All-llahu në Ahiret do të vendosë peshojën e saktë të drejtësisë:

“A do t’i bëjmë krminelët të barabartë me muslimanët? Ç’është me ju, si gjykoni ashtu?”³¹⁵

“Në Ditën e Gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa peshoja e një kokrre të melit Ne do ta sjellim

³¹⁴ El-A’raf: 44.

³¹⁵ El-Kalem: 36.

atë...³¹⁶

e) Nëse mendojmë mbi krijimin e qiejve dhe të Tokës, kemi për të parë që çdo gjë është vendosur në vend përkatës. Për shembull, qiejt me të gjitha që gjenden mbi ta sikurse që janë: yjet, planetet, nata dhe dita, mandej Toka dhe ato që janë mbi të, sikurse që janë bimët, kafshët, njeriu dhe çdo gjë tjetër në natyrë. Çdo gjë në të vërtetë, është vendosur në vend, i cili i përgjigjet funksionit të dhënë. Zemra është në vend të vet, syri në të vetin, gjethi në dru është në vend të vet, trandafili në vend të vet dhe të tjera. Dhe nuk mund ta gjejmë asnjë krijesë mbi Tokë e cila sillet në kundërshtim me të vërtetën, përveç njeriut (të paudhëzuar).

Ashtu kriminelin do ta gjejmë në vendin e vet, ndonjëherë i Dërguari s'as do të jetë shenjë e sulmeve të të paditurve. Pse, e vërteta nuk dominon në mesin e krijesave të tjera të Tokës dhe të qiejve? Arsyeja jonë e shëndoshë do të vie në përfundim, që në të vërtetë Ai i Cili i krijoi qiejt dhe Tokën, me siguri që do ta vendosë të vërtetën në mesin e njerëzve edhe pse kjo kohë pas kohe nuk bëhet (ekziston) në këtë botë. Dunjaja është shtëpi e sprovave dhe e provimeve dhe kjo drejtësi domosdo do të realizohet në Ahiret.

All-llahu thotë:

“Ky (Kur’ani) është dritë e dijes për njerëz, është udhëzues e mëshirë për një popull që beson bindshëm. A menduan ata, të cilët vepruan në të këqija, se në jetën e tyre dhe në vdejkën e tyre do t’i bëjmë të barabartë me ata që besuan dhe bënë vepra të mira? Sa i shëmtuar

³¹⁶ El-Enbija: 47.

është gjykimi i tyre! All-llahu krijoi edhe qiejt edhe tokën me një drejtësi precize, e për t'u shpërblyer secili njeri me veprat e veta, atyre nuk u bëhet e padrejtë.³¹⁷

f) Nëse njeriu mendon mbi atë se si e ruajti All-llahu kur ishte një pikë e lëngët ose një varëse e vogël në mitrën e nënës, ose si All-llahu e ruan dhe e mbron gjatë tërë jetës së tij, nëse mendon mbi këtë, pa dyshim që do të vie deri te bindja, që All-llahu njeriun nuk do ta braktisë gjatë vdekjes së tij dhe, as nuk do të lejojë të shkojë në pakthim dhe të zhduket – humbas.

Krijuesi fisnik, i Cili i ruan dhe i mbron pjesët më të imta, me siguri që nuk do të lejojë zhdukjen e krijesave më të përsosura. All-llahu thotë:

“A mendon njeriu se do të lihet duke mos zënë asgjë (pa kurrfarë përgjegjësie). A nuk ka qenë ai në një pikë ujë që derdhet. E pastaj u bë gjak i trashë, e Ai e krijoi dhe e përsosi? Dhe prej tij Ai i bëri dy lloje: mashkullin dhe femrën. A nuk është Ai (Zot) i fuqishëm që i ngjall të vdekurit?”³¹⁸

³¹⁷ El-Xhathije: 20-22.

³¹⁸ El-Kijame: 36-40.

JETA NË BERZAH

Muslimani është plotësisht i bindur, që shpërblimi (begatitë) i varrit, dënimi i varrit dhe pyetjet nga dy melaiket në të, janë e vërtetë absolute. Kjo bindje e tij themelohet në argumentet që vijojnë:

Argumentet nga Kur`ani dhe Sunneti

All-llahu thotë:

“...Kurrsesi, (kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që e thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distançë periodike) deri në ditën kur ringjallen.”³¹⁹

“...ndërsa ithtarët e faraonit i përfshiu dënimi më i keq. Ata i nënshtrohen zjarrit mëngjes e mbrëmje, e Ditën e Kijametit (melaikëve): »Ithtarët e faraonit futni në dënimin më të rëndë!«.”³²⁰

“All-llahu forcon ata që besuan me fjalën e fortë (të mirë) në jetën e dunjasë, e e edhe në Ahiret...”³²¹

Transmetohet që ky përforsim ka të bëjë me pyetjet në

³¹⁹ El-Mu`minun: 100.

³²⁰ Gafir: 45-46.

³²¹ Ibrahim: 27.

varr.

All-llahu thotë:

“...E, sikur t’i shihje mizorët kur janë në agoni të vdekjes, e melaiket kanë shtrirë duart e veta (me ndëshkim) e (u thonë): »Shpëtoni pra vetveten (nëse mundeni)«. »Tash përjetoni dënimin e turpshëm për shkak se e thoshit të pavërtetën për All-llahun dhe ndaj argumenteve të Tij ishit kryeneç». ”³²²

I Dërguari savs thotë:

“Kur robi lëshohet në varr dhe kur të afërmit e tij e braktisin, e ai, duke i dëgjuar hapat e tyre, do t’i vijnë dy melaiket, do të ulen pranë tij dhe do ta pyesin: Çfarë ke folur për këtë njeri, pra për Muhammedin savs. Mu’mini do të përgjigjet: - Esh-hedu enne Abdull-llahi ve rusuluh! - Pastaj do t’i thuhet: Shikoje vendin tënd në xhehennem, All-llahu ta ka zëvendësuar me vendin në xhennet! Atëherë do t’i shohë të dy vendet. Mandej varri do t’i zgjerohet dhe do të bëhet i gjerë.

Munafiku ose kafiri në pyetjen: Çfarë ke folur për këtë njeri, për Muhammedin savs. Do të përgjigjet: - Nuk e di. Kam folur atë çfarë kanë folur njerëzit. - Pastaj do t’i thuhet: Nuk ke ditur por as nuk ke pasuar. Mandej pasi që do të jetë i goditur me qekan të hekurt do të bërtasë, bërtimën e tij do ta dëgjojë çdokush përveç xhinnëve dhe njerëzve.”

I Dërguari i All-llahut gjithashtu ka thënë:

“Kur dikush nga ju vdes, vendi i tij i tregohet mëngjes dhe mbrëmje, e nëse është nga ehli xhenneti, do t’i tregohet vendi në xhennet, por nëse është nga ehli xhehennemi, në xhehennem. Mandej do t’i thuhet: »Ky

³²² El-En’Am: 93.

është vendi yt derisa All-llahu nuk të ringjall në Ditën e Kijametit«.”

Me një rast kur i Dërguari i All-llahut ishte duke kaluar pranë dy varreve, kishte thënë:

“Këta dy janë duke u dënuar, por nuk janë duke u dënuar për mëkate të mëdha. Njëri nga këta i përgojonte njerëzit, kurse i dyti nuk kujdesej nga urina.”

Kur bënte dua Resulull-llahu savs thoshte:

“O All-llah, strehohem te Ti nga Adhabi (dënimi) i varrit, nga zjarri i xhehennemit dhe nga sprovat e jetës dhe të vdekjes.”

Ka edhe hadithe të shumta, që flasin për këtë!

Argumente racionale

1. - Të besuarit në All-llahun, melaiket e Tij, në librat, në të dërguarit e Tij dhe Ahiret, obligojnë gjithashtu të besuarit në adhabin (dënimin) e varrit dhe begatitë në të dhe, çdo gjë që ndodh në të, sepse të gjitha këto janë gjëra gajb-të fshehta, të cilat janë mbi njohuritë njerëzore, ashtu që ai, i cili beson në ndonjërin prej tyre, është i detyruar të besojë edhe në të tjera.

2. – Dënimi i varrit dhe begatitë në të, sikurse edhe të pyeturit në varr, nuk janë gjëra që arsyenja i injoron dhe i mohon ose i konsideron të pamundura, tashmë kjo arsye i pranon dhe dëshmon që janë të vërteta. Kur njeriu fle dhe e ëndërron ndonjë ëndërr të bukur, ai është i lumtur dhe kënaqet me atë gjumë, shpirti i tij është i lumtur dhe i disponuar, ndërsa kur zgjohet është i pikëlluar dhe i

padispunuar. Ndërsa kur e sheh ndonjë ëndërr të keqe dhe kur tmerrohet në të, i falënderohet atij që e zgjoi. Kjo ëndërr e mirë apo e keqe, ose të mirat dhe dënimi për njeriun, ndikojnë kryesisht në shpirt, ai i nënshtrohet ndikimit të tyre. Ajo nuk i është dedikuar trupit, as nuk është përjetim trupor. Këtë argument askush nuk mund ta kundërshtojë ose ta mohojë. E si atëherë ta mohojë dënimin e varrit ose begatitë në të?!

Tmerret dhe pamjet e llahtarshme të Ditës së Kijametit

Në tmerret dhe llahtaret e Ditës së Kijametit mund të bindemi në bazë të ajeteve Kur'anore:

“Kur dielli të jetë mbështjellur (dhe errësohet). Dhe kur yjet të kenë rënë (e shkapërderdhur). Dhe kur kodrat të kenë udhëtuar (e bërë pluhur në ajër). Dhe kur devetë e shtrenjta të lihen pa bari në fushë. Dhe kur egërsirat të jenë bashkuar (tubuar). Dhe kur detet të vlojnë si zjarr i flakruar. Dhe kur të pyeten ato vajza të varrosura të gjalla. Për çfarë mëkati ato janë mbytur. Dhe kur fletushkat të jenë shpaluar. Dhe kur qielli të jetë hequr. Dhe kur xhehennemi të jetë ndezur fort. Dhe kur xhenneti të jetë afruar.”³²³

“E kur të ngjajë ndodhia (Kijameti). Realitetin e asaj ndodhie nuk ka kush që do ta përgënjeshtrojë. Ajo është që rrëzon, është që ngrit (lart). (ajo ndodh) Kur toka tundet me dridhje të forta. E kodrat shkapërderdhen e bëhen copë e thërrmi. E bëhen pluhur i shpërndarë.”³²⁴

“O njerëz, ruajuni dënimin nga Zoti juaj, sepse dridhja

³²³ Et-Tekvir: 1-13.

³²⁴ El-Wakiah: 1-6.

pranë katastrofës së Kijametit është një llahtari e madhe. Atë ditë, kur ta përjetoni atë, secila gjidhënëse braktis atë që ka për gjini dhe secila shtatzënë e hedh para kohe barrën e vet, ndërsa njerëzit duken të dehur, po ata nuk janë të dehur, por dënimi i All-llahut është i ashpër.”³²⁵

“E kur të vijë ushtima (krisma e Kijametit); Atë Ditë njeriu ikën prej vëllait të vet. Prej nënës dhe prej babait të vet. Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet.”³²⁶

³²⁵ El-Haxh: 1-2.

³²⁶ Abese: 33-37.

XHENNETI DHE XHEHENNEMI

Xhenneti është shtëpi e muwehidëve - monoteistëve, shtëpi e atyre që besuan, e bën vepra të mira, të atyre që përherë në mendje e kanë All-llahun, shtëpi e robërve të sinqertë të All-llahut, të atyre që i frikësohen Zotit të vet, shtëpi e atyre që i përmbushin marrëveshjet kur zotohen në to, shtëpi e atyre që me pasuri dhe jetë luftojnë në rrugë të All-llahut, shtëpi e atyre që sinqerisht pendohen për mëkatet e bëra, të cilët janë përherë në ibadet, që janë falënderues ndaj zotit të vet, të cilët bëjnë sexhde, të cilët nxisin për të mirë dhe zbrapsin nga e keqja. All-llahu në Librin e Vet të shenjtë e ka përshkruar xhennetin dhe bukuritë e tij. Lumenjtë, drunjtë, frutat, ushqimin, pijën, veshën, divanët, dhomat dhe hyritë. All-llahu përmend se si bukuritë e xhennetit nuk janë si bukuritë e dunjasë:

“Pra, për ata që kanë vepruar nuk di askush për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit) që iu është caktuar atyre si shpërblim.”³²⁷

I Dërguari savs tregon që All-llahu ka thënë:

“Robërve të Mi të mirë u Kam përgatitur atë çfarë syri nuk ua ka parë, veshi nuk ua ka dëgjuar dhe çfarë

³²⁷ Es-Sexhde: 17.

zembrës së njeriut as që iu ka kujtuar.!”

Xhehennemi është shtëpi e kafirëve që ishin mendjemëdhenj në pikëpamje të ibadetit dhe të nënshtruarit ndaj All-llahut. All-llahu e ka përshkruar lëndën djegëse të tij, zjarrin e flakëruar, ushqimin dhe pijën në të, dënimet e tij, çfarë në zemrën e tiranëve shkakton frikë të madhe, e me çfarë All-llahu i kërcënohet mëkatarit mendjemadh dhe të fortë, që të dridhet nga gjendja në të cilën gjendet. Dhe formën e dënimit dhe mundimit më të lehtë do ta përjetojë ai i cili do t'i ketë të mbathurat me rrypa nga zjarri, me ç'rast do të vlojë truri sikur kur vlon kazani në zjarr dhe, do të mendojë që askush në ditën e Kijametit nuk e ka më të vështirë (dënimin) se ai. Nëse dikush dëshiron të dhëna më tepër mbi xhennetin dhe xhehennemin, le ta lexojë Librin e All-llahut dhe Sunnetin e të Dërguarit savs. Aty do të gjejë sa të dëshirojë.

Rezultati i të besuarit në Ahiret

Në saje të besuarit në Ahiret jeta jonë e fiton qëllimin e vet të lartësuar dhe kuptimin e thellë, ndërsa ky qëllim dhe kuptim realizohet duke bërë vepra pozitive dhe duke u ruajtur nga veprat e ndaluara, me arritjen e vlerave të ndryshme dhe kualitetit, me menjanimin e të gjitha të metave të dëmshme, për organizëm, për fenë, për dinjitet, arsyë dhe pasuri.

SI DO TË BËHET RINGJALLJA

Elementet nga të cilat është krijuar njeriu

Njeriu përbëhet nga tri elemente:

1. - Elementi i parë i cili rrjedh nga Ademi assa dhe nga i cili është krijuar pika e farës (fara).
2. - Pluhuri i dheut në formë të ushqimit, nga i cili është zhvilluar elementi që rrjedh nga Ademi assa dhe nga i cili është formuar trupi i njeriut.
3. - Shpirti, që i është dhënë embrionit në mitrën e nënës.

Periudha e sprovave dhe mbarimi i saj

Me sintezën e këtyre elementeve, me dëshirën e All-llahut, krijohet njeriu qenie e gjallë përpara të cilit qëndron periudha e sprovave në këtë botë. All-llahu thotë:

“Ai është që krijoi vdekjen dhe jetën, për t’ju provuar se

cili prej jush është më vepërmirë...³²⁸

Dhe kur arrin fundi i sprovave dhe koha e të kaluarit në Ahiret, atëherë vjen vdekja.

“...e kur t’u vijë afati i tyre, ai nuk mund të shtyhet për asnjë moment, e as të përngutet më parë.”³²⁹

“Po, All-llahu kurrësi askë nuk e shtyn për më vonë, kur atij t’i vijë afati i vet...”³³⁰

Me vdekjen e njeriut elementet e përmendura kthehen në gjendje të mëparshme

Me vdekjen e njeriut, pluhuri i dheut nga i cili është formuar trupi i njeriut, kthehet në gjendje të mëparshme:

“Ne dimë se ç’pakësohet (ç’tret) toka prej tyre. Te Ne është edhe libri që ruan çdo gjë (numrin e tyre, emrat, pjesët e trupit).”³³¹

Nga trupi i njeriut mbetet vetëm rrënja e ashtit bishtor (fara), e kjo është pjesë nga e cila krijohet njeriu gjatë formimit dhe ajo është jashtëzakonisht e vogël. Atë pjesë toka nuk e tretë dhe ajo kurrë nuk mund të kalbet.!

I Dërguari i All-llahut thotë:

“Toka e ha tërë trupin e njeriut, përveç ashtit bishtor, nga ai është krijuar dhe nga ai është formuar.”³³²

Sa i përket shpirtit, ai shkon atje ku don All-llahu dhe aty mbetet deri në Ditën e Kijametit.

³²⁸ El-Mulk: 2.

³²⁹ El-A’raf: 34.

³³⁰ El-Munafikun: 11.

³³¹ Kaf: 4.

³³² Hadithin e transmetojnë El-Buhariu, Muslimi, En-Nesaiu, Ebu Dawudi dhe Maliku në El-Muweta’.

Gjatë ringjalljes këto elemente përsëri do të jenë të bashkuara

Kur do të vijë momenti i ringjalljes All-llahu nga qielli do ta lëshojë shiun prej të cilit do të mbijnë këto fara, domethënë, maja e ashtit bishtor, i cili nuk është kalbur!

I Dërguari i All-llahut thotë:

“...mandej nga qielli do të lëshohet shiu, pastaj do të mbijnë sikurse që mbijnë perimet. Dhe nga njeriu nuk do të mbetet asgjë, e që të mos jetë kalbur përveç një ashti, e ky është maja e ashtit bishtor.”³³³

E ngjashme ndodh edhe në dunja, kur paraqitet kohë e thatë, je duke parë se si drunjtë thahen dhe gradualisht kalben dhe, njeriu nuk sheh që në drunjtë ose në bimët kanë mbetur vetëm farat, të cilat bien në pluhurin e dheut ose nën shkëmbinj, ashtu që gjatë shiut këto fara mbijnë dhe nga ato rriten drunjtë ose bimët tjera.

All-llahu thotë:

“Ai krijon të gjallin prej të vdekurit dhe të vdekurin prej të gjallit, Ai e ngjall tokën pas vdekjes së saj, e po ashtu edhe ju do të nxirreni (të gjallë prej varrezave).”³³⁴

Një herë, kur një njeri e kishte pyetur të Dërguarin e All-llahut, se si All-llahu do t'i ringjallë përsëri krijesat dhe cili është argument për këtë, ai iu përgjigj:

“A ke kaluar ndonjëherë gjatë thatësirës nëpër luginën e vdekur ku jeton populli yt dhe përsëri rastise nëpër te dhe ke parë se si e tëra vezullon dhe gufon nga gjelbërimi? E,

³³³ Hadithin e transmetojnë El-Buhariu, Muslimi, En-Nesaiu, Ebu Dawudi dhe Maliku në El-Muweta’.

³³⁴ Er-Rrum: 19.

pra ky është argument i All-llahut mbi krijimin e Tij. Ashtu All-llahu do t'i ringjallë të vdekurit.³³⁵

Dhe, kur maja e ashtit bishtor mbin nga pluhuri i dheut dhe trupat kthehen ashtu, çdo shpirt do të vij në trupin e vet dhe mu për këtë All-llahu thotë:

“...Dhe kur shpirtra të jenë bashkuar...”³³⁶

Dhe kështu krijimi do të përsëritet edhe një herë, sikurse që filloi për herë të parë:

“(Përkujto) Atë ditë kur Ne e palojmë qiellin sikurse palimi i fletëve në libër. Ashtu sikundër e kemi filluar krijimin (tuaj), e rikthejmë. Ky është obligimi Yni, e Ne e bëjmë këtë.”³³⁷

Përgjigje atyre që nuk besojnë në Ahiret

Si përgjigje për ata që nuk besojnë në Ahiret, mjaftojnë fjalët e All-llahut kur thotë:

“O ju njerëz, nëse dyshoni për ringjalljen, atëherë (mendoni krijimin tuaj që) Ne u krijuam prej dheu, pastaj prej uji, pastaj prej një gjaku të ngjizur, pastaj prej një sa kafshatë mishi, që është krijesë e formuluar ose e paformuluar, në mënyrë që t’ju sqarojmë. Ndërsa atë që dëshirojmë Ne, e përqëndrojmë në mitër deri në një afat të caktuar, e mandej u nxjerrim foshnje dhe ashtu të arrini pjekurinë tuaj. Ka që dikush prej jush vdes herët, e dikush të jetojë deri në pleqëri të thellë, në mënyrë që të mos dijë asgjë nga dija që ka pasur. E ti e sheh tokën e tharë-të vdekur, e kur Ne ia lëshojmë asaj ujin ajo gjallërohet, shtohet dhe nga të gjitha llojet rritë bimë të

³³⁵ Teksti i hadithit është i Ahmedit.

³³⁶ Et-Tekwir: 7.

³³⁷ El-Enbija: 104.

këndshme. Këtë (e themi për ta ditur) se All-llahu është Ai i vërteti dhe se Ai ringjallë të vdekurit dhe Ai ka fuqi për çdo send. Dhe nuk ka dyshim se Kijameti do të vijë patjetër dhe se All-llahu me siguri do t'i ngjallë ata të varrezave (të vdekurit).»³³⁸

“A nuk mendon njeriu se Ne e krijuam atë prej një pike uji (fare), kur qe, ai kundërshtar i rreptë. Ai na solli Neve shembull, e harroi krijimin e vet e tha: »Kush i ngjall eshtrat duke qenë ata të kalbur?«. Thuaj: »I ngjall Ai që i krijoi për herë të parë, e Ai është shumë i dijshtëm për çdo krijim. Ai që prej drurit të gjelbër ju bëri zjarrin, e ju prej tij ndezni«. A nuk është i fuqishëm Ai, që krijoi qiejt e tokën, të krijojë njerëz sikundër që i krijoi ata? Po Ai është krijuesi, i dijshtëmi. Kur Ai dëshiron ndonjë send, urdhëri i Tij është vetëm t'i thotë: »Bëhu!« Ai menjëherë bëhet. I lartë është Ai e në dorën e Tij është pushteti mbi çdo send dhe vetëm tek Ai ktheheni.»³³⁹

“Kaf, pasha Kur'anin e lavdishëm (do të ringjalleni)! Por jo, ata u çuditën që u erdhi i Dërguari (qortues) nga mesi i tyre, andaj jobesimtarët thanë: »Kjo është diçka shumë e çuditshme. A pasi të vdesim e të bëhemi dhe (do të kthehemi në jetë)? Ai kthim është larg (mendjes e mundësisë)«! Ne dimë se ç'pakësohet (ç'tret) toka prej tyre. Te Ne është edhe libri që ruan çdo gjë (numrin e tyre, emrat, pjesët e trupit). Ata përgënjeshtroan të vërtetën kur ajo u erdhi dhe ata janë në gjendje të luhatshme. A nuk shikojnë ata me vëmendje kah qielli se si mbi ta kemi ndërtuar atë, e kemi zbukuruar atë duke mos pasur në të ndonjë zbrazëti.»³⁴⁰

³³⁸ El-Haxh: 5-7.

³³⁹ Jasin: 77-83.

³⁴⁰ Kaf: 1-6.

E gjashtë: Të besuarit në Kader ~ përcatim

Çka domethënë Kader?

All-llahu ka dashur të krijojë krijesa, mandej ua përcaktoi afatin kohor, virtytet dhe vetitë e caktuara.

“Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur.”³⁴¹

Ai ka ditur mirë, se çka do të bëhet me krijesat e Tij, andaj e ka urdhëruar Kalemin-Lapsin, që në ***pllakën e ruajtur me kujdes*** (Lewhi Mahwudh) të shënojë çdo gjë që do të bëhet deri në Ditën e Kijametit. All-llahu thotë:

“A nuk e ke ditur se All-llahu di çka ekziston në qiell e në tokë, e tërë ajo është e shënuar në Libër, ajo për All-llahun është shumë lehtë.”³⁴²

Dhe çdo gjë që ekziston, e tundshme ose e patundshme, ekziston në saje të vullnetit të All-llahut, i Cili thotë:

“...Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijsلمي, më i fuqishmi.”³⁴³

Domethënë, që asgjë nuk ndodh pa vullnetin dhe fuqinë e All-llahut:

“Dhe mos thuaj kurrsesi për ndonjë çështje: »Unë do të bëj këtë nesër!« Vetëm (nëse i shton): »Në dashtë All-llahu (in-nsha - All-llah)!«.”³⁴⁴

³⁴¹ El-Furkan: 2.

³⁴² El-Haxh: 70.

³⁴³ Er-Rrum: 54.

³⁴⁴ El-Kehf: 23-24.

Dhe atë që do All-llahu, ajo edhe bëhet dhe ajo që nuk do, ajo edhe nuk bëhet.

Të besuarit në Kader

Të besuarit në Kader, është njëri nga themelet e imanit sikurse që shpjegon i Dërguari i All-llahut savs në bisedë me Xhibrilin assa:

“Të besosh në përcaktimin e All-llahut, qoftë ai (kaderi) i mirë apo i keq.”

Njeriu nuk është në gjendje të njohë të fshehtat e All-llahut - përveç nëse dituria e tij është e barabartë me diturinë e All-llahut - e kjo është gjë e pamundur, e pse atëherë nuk mendon mbi atë se çfarë bëjnë mjekët, ekspertët dhe inxhinierët. Aftësinë e tyre profesionale dhe diturinë e veprave të tyre i dinë vetëm ata të cilët kanë arritur nivel të barabartë në dituri.!

Të themi, sikur një njeri i paditur të kishte parë se si kirurgu e hap barkun e ndonjë pacienti dhe i prenë zorët e tij, ai energjikisht do t'i kundërvihet, ndërkaq, kur kupton që kirurgu është i ditur dhe i shkathët në punët e tij, e përkrah kësaj edhe ekspertë, i padituri do të lëshojë pe në kundërshtimin e tyre dhe do ta pranojë paditurinë e vet kundruall diturisë së kirurgut.

Besimtari është i vetëdijshëm për përsosmërinë e Zotit të vet, për çka është i denjë vetëm Ai edhe është i vetëdijshëm, se çdo gjë që ndodh ka urtësinë dhe kuptimin e vet dhe atëherë kur nuk është në gjendje që ta kuptojë urtësinë e All-llahut, ai e kupton paditurinë e vet kundruall diturisë së All-llahut dhe ai nuk e kundërshton të Urtin, të Gjithëdijshmin dhe Atë, i Cili është mbi të gjitha i lajmëruar, i Cili thotë:

“Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit),

Rezultatet e të besuarit në Kader

Kush beson që All-llahu që çdo gjë krijoi me përcaktim, ai mundohet ta kuptojë përcaktimin e mirë, që me ndihmën e tij të lirohet nga përcaktimi i fatkeqësisë.

Ashtu, ai me ushqim e menjanon urinë, me shërim e menjanon sëmundjen, me punën e vet dhe të kërkuarit e riskut - furnizimit, ai e mënjanon kaderin - përcaktimin e varfërisë.

Kush beson në përcaktimin e All-llahut – Kaderin, ai nuk vajton për atë që ka kaluar, nuk bie në depresion për shkak të sprovave dhe fatkeqësive të ndryshme, nuk krenohet dhe nuk mburret pa i pasur parasysh se çfarë të mira i kanë ndodhur. Ai beson në fjalët e All-llahut:

“Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime (libër - Lehvi Mahfudh) para se të ngjajë ajo, e kjo për All-llahun është e lehtë. Ashtu që të mos dëshproheni tepër për atë që u ka kaluar, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai u ka dhënë, pse All-llahu nuk e do asnjë arrogant që u lavdërohet të tjerëve.”³⁴⁶

Ai i cili beson në Kaderin-përcaktimin e All-llahut, në vullnetin dhe fuqinë e Tij dhe kush e kupton dobësinë dhe pafuqinë e vet dhe nevojën e tij për Krijuesin, ai me sinqeritet të plotë i mbështetet Zotit të vet, i mbahet shkaqeve, të cilat All-llahu i ka përcaktuar, i lutet për ndihmë Zotit të vet, për atë që është i pafuqishëm dhe shpesh i përsërsit fjalët e All-llahut.

³⁴⁵ El-Enbija: 23.

³⁴⁶ El-Hadid: 22-23.

“Thuaj: »Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është caktuar nga All-llahu; Ai është ndihmëtar yni«. Prandaj, vetëm All-llahut le t'i mbështeten besimtarët.”³⁴⁷

³⁴⁷ Et-Tewbe: 51.

DY DILEMA

Dilema e parë:

Disa nga xhahilët konsiderojnë, që All-llahu i dërgoi në mashtrim dhe i pengoi të bëjnë namaz, duke mos e praktikuar agjërimin dhe llojet e tjera të ibadetit, që të tjerët i ka urdhëruar duke i vërtetuar këto pohime me fjalët e All-llahut, që ia ka drejtuar të Dërguarit savs.

“Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por All-llahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit.”³⁴⁸

Ata të cilët e preferojnë dhe e favorizojnë këtë dilemë, nuk e dinë se udhëzimi-hidajeti ka dy aspekte të veta:

1. - **Të udhëzuarit në rrugë të drejtë**

2. - **Të udhëhequrit rrugës së drejtë**

Të udhëzuarit në rrugë të drejtë është e njëjtë, sikur kur dikush të shpjegon se përmes cilës rrugë mund të arrish deri te shtëpia e dëshiruar dhe pastaj të shkosh dhe ta gjesh. Do të thotë, ai të udhëzoi në atë rrugë, ta sqaroi, do të thotë, ai të udhëzoi!

³⁴⁸ El-Kasas: 56.

Të dërguarit kanë pasur detyrë që në këtë mënyrë ta udhëzojnë njerëzimin në rrugë të drejtë. Pra, ata njerëzve ua tregojnë rrugën, e cila do t'i shpie në xhennet.

Duke i folur Muhammedit savs All-llahu thotë:

***“Në të vërtetë, ti udhëzon në rrugë të drejtë.”*³⁴⁹**

E, sa i përket aspektit të dytë të Udhëzimit të All-llahut, do të thotë, të udhëhequrit rrugës së drejtë, kjo do të ishte sikur do të kishe hasur në një person fisnik, të mëshirshëm dhe të dashur dhe ta kishe pyetur për rrugën e cila të shpie deri te shtëpia e dëshiruar, e ai ta tregoi dhe ta sqaroi atë rrugë dhe në fund me lutjen tënde, me veturë të dërgoi deri te caku i dëshiruar. Pra, kjo është të udhëhequrit në rrugën e drejtë dhe ky aspekt i Udhëzimit vie atëherë kur personi e pranon të udhëzuarit në rrugën e drejtë, e pastaj kërkon ndihmë, përkatësisht udhëheqësin, i cili do ta shpie rrugës së drejtë.

Do të thotë, të Dërguarit e tregonin rrugën e drejtë, por, ata nuk mundnin të afronin këtë aspekt të Udhëzimit, sepse All-llahu këtë mundësi ia jep vetëm atij të cilit Ai do. Andaj All-llahu i thotë Muhammedit savs:

***“Është e vërtetë se ti nuk mund ta udhëzosh atë që do ti, por All-llahu udhëzon kë të dojë dhe Ai është që di më së miri për të udhëzuarit.”*³⁵⁰**

Ai, pra, është absolutisht i drejtë dhe Ai e udhëzon atë kush pranon ta pasojë rrugën e drejtë dhe kërkon ndihmë dhe udhëheqje me atë rrugë.

“Atyre të cilët janë në rrugën e drejtë, ua rritë udhëzimin dhe u jep takwallëk, e gjithashtu vetëdije të përhershme për All-llahun.”

³⁴⁹ Esh-Shura: 51.

³⁵⁰ El-Kasas: 56.

All-llahu askend nuk e shpie në humbje, përveç atij të cilin Ai dëshiron, do të thotë, atë i cili vetë e dëshiron këtë humbje, me atë që refuzon ta pasojë rrugën e treguar dhe ashtu (bie në humbje) humbet.

All-llah thotë:

“...E kur ata u shmangën (nga e vërteta), All-llahu i largoi zemrat e tyre, pse All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin e prishur.” (Es-Saff: 5)

Dilema e dytë:

Disa xhahilë thonë, se si ajo që All-llahu e ka shkruar në ***pllakën e ruajtur me kujdes*** (Lewhi Mahfudh) i pengoi ata që e lënë namazin që ta kryejnë, kurse ata që e kryejnë (bëjnë) i ka bërë ta kryejnë, çka do të thotë, vetëmbrojtje e llojit të vet, sepse ai i cili e kryen namazin, ai e kryen sipas zgjedhjes personale, pa kurrfarë detyrimi, ndërsa ai i cili e braktis namazin gjithashtu e braktis sipas zgjedhjes personale, pa kurrfarë detyrimi. Këtë e di çdo njeri, sepse All-llahu ka dashur ta krijojë njeriun me të drejtat e lirisë së zgjedhjes.

Por, nëse dikush pyet, po a nuk është ajo, që është shkruar në ***Pllakën e sigurt***, për njeriun një formë e detyrimit, nëse kjo është shenuar kaherë aty? Kjo gjë është fare e thjeshtë dhe këtë do ta sqarojmë me shembullin vijues:

Shiko një mësues mendjeprehtë, që i njeh mirë nxënësit e vet dhe i cili parashtron pyetjet për provim.

Për shembull, sikur ai t'i shënonte në fletë emrat e atyre nxënësve që është i sigurt që do të kalonin në provim dhe emrat e atyre për të cilët është i sigurt, që do të kalonin, e mandej pas rezultateve ata që nuk kishin kaluar, do të arsyetoheshin, se si supozimi i mësuesit që nuk kanë

për të kaluar është shkak i vërtetë i mossaksesit të tyre!

Po a do të mirret parasysh ky arsytim i tyre, ose do t'u thuhet, se si ajo që mësuesi shënoi në letër është rezultat i përvojës së tij të mëhershme dhe njohja e diturisë së tyre dhe që mossaksesit i tyre është rezultat i parregullsisë dhe moskujdesit të tyre dhe të mos arsyetohen duke mos e përfillur eksperiencën dhe diturinë e mësuesit të tyre. (All-llahut i takon shembulli më i mirë). Ai është Krijuesi i krijesave dhe i gjendjes më të mirë.

“A nuk e di ai që ka krijuar, kur dihet se Ai depërton në thellësi të sekreteve, i njeh hollësitë.”³⁵¹

All-llahu na krijoi që të jetojmë periudhën e sprovave dhe provimeve në këtë botë, e Ai duke i ditur rezultatet e këtij provimi, i caktoi fatkeqësi atyre që janë të pafat, e begati dhe të mira atyre që janë të lumtur, në pajtim me diturinë e Tij, që përfshin çdo gjë që ka qenë dhe që do të jetë. Ndoshta mësuesi mund të gabojë në vlerësimin e nxënësve të vet, por përcaktimi i All-llahut është i pagabueshëm në vlerësimin e veprave të robërve të Vet.

Ndërsa, të shenuarit ose përaktimi në ***Pllakën e Sigurt***, është i lidhur me diturinë e mëparshme të All-llahut. Të braktisurit e namazit është i lidhur me mosnënshtrueshmërinë, mospërfilljen dhe mëkatet e atij që nuk falet.

Kështu xhahilët, mashtrimet dhe mëkatet e tyre, dëshironin t'i arsyetonin me diturinë dhe përsosurinë e All-llahut. Në të vërtetë Dituria e All-llahut është e përhershme, ajo nuk është e arritur.

Prandaj All-llahu të Dërguarin e Vet e ka lajmëruar mbi gjërat që do të ndodhin deri në Ditën e Kijametit, e në

³⁵¹ El-Mulk: 14.

çka jemi bindur duke folur për parashenjat e saj (Ditës së Kijametit), sepse shumë gjëra që i ka përmendur i Dërguari savs, e të cilat muslimanët i shënonin me kujdes në përmbledhjet e Hadithit mu tani ndodhin. Prandaj, a mund dikush të pohojë që ato çka muslimanët i shënojnë, tani është shkaktar që këto të ndodhin? Me të vërtetë dituria e All-llahut është shkak për çdo gjë, e jo pasojë.

DOMOSDOSHMERIA E TË BESUARIT

1. ~ Të besuarit në çdo gjë, që ka ardhur nga All-llahu:

Besimtari absolutisht dhe pa asnjë grimcë dyshimi ose luhatje, beson në të gjitha ato që All-llahu e lajmëroi në Librin e Vet, ose ka thënë përmes të Dërguarit të Vet të nderuar, me bindshmërinë që është argument i patundur për këtë, pa e përzier dyshimin dhe mosbesimin. Mu'mini beson se çdo gjë që është në kundërshtim ose bie ndesh me Dinin e All-llahut është jo ekzakt, sado që disa mundohen që këtë ta zbukurojnë ose ta kamuflonjë. Ai beson se Dini është nga All-llahu azvxh i Gjithëdijsëm dhe i Urti, i Cili me diturinë e Vet çdo gjë përfshin. All-llahu thotë:

“E pas gjithë kësaj, ç’të shtyri të përgënjeshtrorsh ditën e shpërblimit (përgjegjësisë)? A nuk është All-llahu më i Urti Gjykues?”³⁵²

³⁵² Et-Tin: 7-8.

2. ~ Të nështruarit e All-llahut dhe të Dërguarit të Tij

Ai i cili beson All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, i Cili është i bindur në vërtetësinë e premtimit të All-llahut, ai i cili beson në shpërblimin e All-llahut për nënshtrimin ndaj Tij dhe të Dërguarit të Tij dhe për dëgjueshmërinë ndaj urdhërave të All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, imani i tij e obligon në devocion të plotë ndaj këtyre urdhërave. Ai përherë kujdeset që çdo vepër të tij, para se ta kryejë, të jetë në pajtueshmëri me Librin e All-llahut dhe Sunnetin e të Dërguarit të Tij. All-llahu thotë:

“E kushdo që i bindet All-llahut dhe të Dërguarit, të tillët do të jenë së bashku me ata që All-llahu i shpërbleu: (me) të dërguarit, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe më të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!”³⁵³

“Kush i bindet të Dërguarit, ai i është bindur All-llahut, e kush e refuzon, Ne nuk të dërguam roje kundër tyre.”³⁵⁴

I Dërguari i All-llahut ka thënë:

“I gjithë Ummeti im do të hyjë në xhennet, përveç atij i cili refuzon.” “E kush është ai i cili refuzon, o i Dërguar i All-llahut.” Ai u përgjegj: “Ai i cili më nënshtrohet hyn në xhennet, e kush ndaj meje bën mëkat (nuk më nënshtrohet), ai veç refuzon të hyjë në xhennet.”³⁵⁵

3. ~ Kryerja e obligimeve fard

Nëse zemra është formuar me iman, atëherë organet trupore automatikisht janë të drejtuara në kryerjen e

³⁵³ En-Nisa: 69.

³⁵⁴ En-Nisa: 80.

³⁵⁵ Transmeton El-Buhariu në Sahihun e vet nga Ebu Hurejre rda.

veprave të mira, e me këtë edhe obligimeve serioze (fardeve).

Ndrëkaq, ai i cili nuk i kryen këto obligime serioze (fardet) e për veten e tij pohon që është besimtar, por ai është gënjeshtar, atë e ka mashtruar shejtani dhe veprat e tij të këqija ia ka paraqitur të mira. Sikur zemra e tij të ishte e shëndoshë për iman, duke i kryer fardet, do ta kishte të shëndoshë tërë trupin.

I Dërguari i All-llahut ka thënë:

“Në trup është një organ (copë mishi), i cili, nëse është i shëndoshë, do të jetë i shëndoshë tërë trupi, e nëse është i sëmurë do të jetë i sëmurë tërë trupi. E ky (organ) është zemra!”³⁵⁶

4. ~ Kryerja e obligimeve dhe të ruajturit nga ndalesat

Imani i një njeriu është i plotë vetëm atëherë, nëse i përmbush të gjitha ato me çka e ka obliguar All-llahu dhe nëse e ruan veten nga të gjitha ato që i ka ndaluar All-llahu, në pajtim me atë me çka ka urdhëruar i Dërguari i All-llahut.

All-llahu thotë:

“...Çka t’ju jep i Dërguari, atë merrnie, e çka t’ju ndalojë, përmbahuni dhe kinie frikë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër.”³⁵⁷

5. ~ Pendimi dhe të kërkuarit e faljes

Kur shejtani e mashtron besimtarin dhe e nxit të bëjë

³⁵⁶ Mutefikun alejh.

³⁵⁷ El-Hashr: 7.

diç çka All-llahu e ka ndaluar, ai nxiton të bëjë tewbe, domethënë, të pendohet për të gjitha që i ka bërë, kërkon falje nga All-llahu dhe fortësisht vendos që mëkate të tilla të mos i bëjë më.

All-llahu, duke i përshkruar besimtarët, robërit e Vet besnikë, thotë:

“Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetes së tyre, e përmendin All-llahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç All-llahut? - dhe që duke e ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen).”³⁵⁸

“Thuaj: »O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, pse All-llahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është Mëshirues!«.”³⁵⁹

6. ~ Të nxiturit për të mirë dhe të penguarit nga e keqja

Të nxiturit për të mirë dhe të penguarit nga e keqja, janë domosdoshmëri qenësore, pjesë përbërëse të imanit dhe virtyte të rëndësishme të besimtarëve të vërtetë. All-llahu thotë:

“Besimtarët dhe besimtaret janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja,...”³⁶⁰

Kjo lidhje reciproke dhe harmonia mes forcës së imanit në zemrën e besimtarit dhe shtytja për të mirë dhe

³⁵⁸ Ali Imran: 135.

³⁵⁹ Ez-Zumer: 53.

³⁶⁰ Et-Tewbe: 71.

pengimi nga e keqja, është lidhje e fortë dhe besnike.

I Dërguari i All-llahut thotë:

“Kush nga ju e sheh ndonjë të keqe, le ta largojë me dorë, nëse nuk është në gjendje (ta largojë me dorë), atëherë me gjuhë, por, nëse edhe këtë nuk është në gjendje ta bëjë, atëherë me zemër, por kjo është dukuri e imanit më të dobët.”³⁶¹, kurse në rivajetin tjetër qëndron: ***“...pas kësaj nuk ekziston as sa një kokërr e xixës së imanit.”***

Besimtari është konsekuent në nxitjen për të mirë dhe të penguarit nga e keqja, sepse sikur ta linte këtë fard, absolutisht do të ishte në humbje, duke e përjashtuar atë që mbetet mes besimtarëve të sinqertë:

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin që të jenë të durushëm.”³⁶²

7. ~ Thirrja e njerëzve në Dinin e All-llahut dhe lufta kundër atyre që zbrapsin nga ai

Kur njeriu e kërkon ëmbëlsinë e imanit, i shijon bukuritë e Islamit dhe kur në zemrën e tij mbisundon dashuria ndaj All-llahut, ai në çdo moment tenton ta japë tërë mundin me të cilin disponon, që veten e tij, familjen e tij dhe të gjithë njerëzit sa më tepër t’i largojë dhe t’i ruajë nga errësira e kufrit, ateizmit dhe pakujdesisë, kurse (në

³⁶¹ El-Buhariu, Ebu Dawudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Ibn Maxhe nga El-Hudriu.

³⁶² El-Asr.

anën tjetër) t'i afrojë botës së imanit, Islamit dhe Udhëzimit të Kur'anit. Ai i thërret njerëzit në All-llahun, duke i përballuar torturat e ndryshme, provokimet dhe armiqësitë e njerëzve duke llogaritur mbi shpërblimin e lartë nga All-llahu azvxh.

“E kush flet më mirë se ai që thërret në rrugën e All-llahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: »Unë jam prej muslimanëve«?»³⁶³

“Thua: »Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te All-llahu, unë dhe ai që më pason. Larg të metave është All-llahu, e unë nuk jam nga idhujtarët.«³⁶⁴

I Dërguari i All-llahut thotë:

“Ai që thërret në udhëzim, ka shpërblim të njejtë sikurse ai që e pason, e që kjo aspak nuk e zvogëlon shpërblimin e tyre.”³⁶⁵

Sa i përket atyre që zbrapsin nga rruga e All-llahut dhe e pengojnë kalimin e njerëzve në Dinin e All-llahut, besimtari është i obliguar që me të gjitha mjetet e disponuara të luftojë kundër tyre, për ta mundësuar, që Dini i All-llahut të arrijë te secili njeri, pastaj kush do të besojë, do të dijë pse beson, ndërsa kush e refuzon, ai me vetëdije shkon në shkatërrim.

All-llahu thotë:

“O ju që keni besuar, a t’ju tregojë për një tregti të bujshme që ju shpëton prej një dënimi të dhembshëm: T’i besoni All-llahut dhe të Dërguarit të Tij, të luftoni në rrugën e All-llahut me pasurinë tuaj dhe me veten tuaj, e

³⁶³ Fussilet: 33.

³⁶⁴ Jusuf: 108.

³⁶⁵ Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre.

kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse jeni që e dini. Ai (All-llahu) iu falë mëkatet tuaja dhe do t'ju shpie në xhennete, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë dhe në pallate të mrekullueshme - e në xhennetet e Adnit, e ky është suktesi më i madh. Edhe të tjera që ju i dëshironi: ndihmë prej All-llahut dhe fitore e afërt, e pra, përgëzoji besimtarët!”³⁶⁶

“Luftoni ata derisa të mos mbetet idhujtari (besimi i kotë), e i tërë adhurimi të bëhet vetëm për All-llahun.”³⁶⁷

8. ~ Miqësia mes besimtarëve dhe izolimi i kafirëve

Me fjalën miqësi, nënkuptojmë mirëkuptim, dashuri të ndihmuar reciproke dhe dhënia e përkrahjes vëllait të vet besimtar. Njëri nga elementet qenësore të imanit është, që muslimani të përpiqet me të gjitha mundësitë, ashtu që të formojë qëndrimin islam ndaj vëllait të vet besimtar dhe assesi nuk i lejohej të formojë miqësi pa baza islame.

“Mik (i afërt) juaji është vetëm All-llahu, është i dërguari i Tij dhe ata që besuan e që falin namazin dhe japin zekatin duke bërë ruku (duke qenë respektues). E kush ka për mik All-llahun, të Dërgurin e Tij dhe ata që besuan, s’ka dyshim se ana (pala-krahu) e All-llahut është ngadhënjyese.”³⁶⁸

“Besimtarët dhe besimtarejt janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqja, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë All-llahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t’i mëshirojë All-

³⁶⁶ Es-Saff: 10-13.

³⁶⁷ El-Enfal: 39.

³⁶⁸ El-Maide: 55-56.

llahu. All-llahu është Ngadhnjyes, i Urtë.³⁶⁹

All-llahu besimtarit i tregoi shembull të mirë për izolimin e kafirëve kur thotë:

“Ju e keni shembullin më të mirë tek Ibrahimimi dhe ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: »Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuroni, pos All-llahut, nuk besojnë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm All-llahun Një!«.³⁷⁰

³⁶⁹ Et-Tewbe: 71.

³⁷⁰ El-Mumtehine: 4.

E KUNDËRTA E IMANIT

E para: Kufri dhe llojet e tij

a) ~ Kufri i të futurit në gënjeshtëri

Kjo do të thotë, të konsideruarit e asaj me çka ka ardhur i Dërguari savs, gënjeshtëri. All-llahu thotë:

“Edhe nëse të përgënjeshtrojnë ty, përgënjeshtruan edhe ata që ishin para tyre, që atyre u patën ardhur të dërguar me argumente të qarta, me broshura dhe me Libër të ndritshëm. Pastaj (pasi refuzuan) i shkatërrova ata që nuk besuan, e sa i tmershëm ishte ndëshkimi Im!”³⁷¹

b) ~ Kufri i inatit dhe mendjemadhësisë

Ky kufër është i ngjashëm me kufrin e Iblisit, i cili nuk e kundërshton dhe nuk e mohon urdhërin e All-llahut, por, e priti me mendjemadhësi si dhe padëgjueshmëri. Kjo është, sikur ai i cili e di që islami është Dini i vërtetë dhe i

³⁷¹ Fatir: 25.

pranueshëm tek All-llahu, i cili mjafton edhe për dunja e edhe për Ahiret dhe përkundër kësaj ai e refuzoi dhe e pranoi masën ose drejtimin jetësor që e imagjinoi njeriu - i vdekuri.

All-llahu thotë:

“E kur u thamë melaikeve: përuluni (bini në sexhde) Ademit, ato menjëherë iu përulën, me përjashtim të Iblisit (shejtanit). Ai refuzoi dhe u mbajt në të madh dhe u bë pabesimtar.”³⁷²

c) ~ Kufri i largimit dhe indiferencës

Ky kufër pasqyrohet me indiferencën dhe të larguarit nga ajo me çka ka ardhur i Dërguari i All-llahut. Ai as nuk e pranon atë e as nuk e refuzon, por thjesht largohet (ikë). All-llahu thotë:

“E kush është më zullumqar se ai që këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj ua kthyen shpinën atyre? Ne, me siguri, do të hakmirremi kundër kriminelëve.”³⁷³

d) ~ Kufri i dyshimit

Ky është lloji i kufrit, kur njeriu dyshon në atë me çka i ka ardhur të Dërguarit të All-llahut, ashtu që as nuk e beson dhe as nuk e konsideron të rrejshëm atë.

All-llahu thotë:

“...»Ne e mohojmë atë me çka jeni të dërguar dhe ne dyshojmë shumë në atë që ju na thërrisni«.”³⁷⁴

³⁷² El-Bekare: 34.

³⁷³ Es-Sexhde: 22.

³⁷⁴ Ibrahim: 9.

e) - Kufri i mohimit dhe i refuzimit

Do të thotë, kur njeriu e mohon dhe e refuzon çdo gjë që ka shpallur All-llahu, ose e mohon vetëm një pjesë që është detyrimisht e njohur nga islami.

All-llahu thotë:

“Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në to (se ishin nga Zoti), i mohuan në mënyrë të padrejtë e me mendjmadhësi, pra shikoje se çfarë ishte fundi i shkatërrimtarëve.”³⁷⁵

“Ne dimë se ty të brengos ajo që thonë, e ata nuk të gënjejnë ty, por ata mizorë mohojnë argumentet e All-llahut.”³⁷⁶

E dyta: Shirku dhe llojet e tij

All-llahu thotë:

“Pasha All-llahun, ty të është shpallur, e edhe atyre para teje: »Nëse i bën shok (All-llahut), veprat tua janë të asgjësuar dhe ti do të jeshë prej të humburve...”³⁷⁷

“S’ka dyshim se All-llahu nuk fal (mëkatin) t’i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do. Kush i përshkruan All-llahut shok, ai ka trilluar një mëkat të madh.”³⁷⁸

Pra, Shirku është në kundërshtim me imanin e ai ndahet në llojet që pasojnë:

³⁷⁵ En-Neml: 14.

³⁷⁶ El-En’Am: 33.

³⁷⁷ Ez-Zumer: 65.

³⁷⁸ En-Nisa: 48.

a) ~ Shirku, kur njeriu beson në All-llahun, por dikend tjetër e konsideron të barabartë me Të, në pushtetin e paprekshëm dhe në të udhëhequrit me krijesa, në krijimin, jetën, vdekjen, furnizimin, dëmin, dobinë dhe të ngjashme.

Kjo është po si shirku i të krishterëve dhe mexhusijasve, sepse të krishterët thonë se All-llahu është *“njëri prej të treve”* - i Lartësuar dhe i Lavdëruar është Ai mbi të gjitha që flasin ata, ndërsa mexhusijasit thonë, se Ai është *“i dyti nga të dytët”* - i Lartësuar dhe i pastër është Ai nga të gjitha që ata flasin! All-llahu thotë:

*“Ai është që vetëm Atij i takon sundimi i qiejve dhe i tokës, Ai nuk ka as fëmijë e as nuk ka shok në sundimin e Tij. Ai krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë e të matur.”*³⁷⁹

b) ~ Shirku kur dikush vetën e tij ose dikend tjetër e përshkruan me cilësi të Zotit.

Këto janë cilësi që i përkasin ekskluzivisht vetëm All-llahut, sikur kur Fir’auni kishte thënë:

*“E u tha: »Unë jam Zoti juaj më i lartë«.”*³⁸⁰

Ose nëse dikush e refuzon ose mohon ndonjë cilësi të All-llahut, sikurse kur Fir’auni kishte thënë:

*“(Faraoni) Tha: »E cili është ai zot i botëve (që ju dërgojë)?«.”*³⁸¹

Ose kur kafirët Kurejshit thanë:

³⁷⁹ El-Furkan: 2.

³⁸⁰ En-Naziat: 24.

³⁸¹ Esh-Shaura: 23.

“E kur u është thënë atyre: Bëni sexhde ndaj të Madhërishmit, ata thanë: »E kush është Rrahmani - Mëshiruesi? A t’i bëjmë sexhde pse ti na urdhëron?» E kjo shtoi edhe më tepër largimin e tyre (nga feja).”³⁸²

“Sepse ata janë duke e mohuar Mëshiruesin (Zotin). Thuaj: »Ai (Rrahmani) është Zoti im, nuk ka zot tjetër pos Atij. Vetëm Atij i jam mbështetur dhe vetëm tek Ai është e ardhmja ime«.”³⁸³

c) ~ Lloji i shirkut, kur njeriu i bën ibadet dikujt tjetër përveç All-llahut, pa marrë parasysh se çfarë ibadeti është ai.

All-llahu thotë:

“Adhurone All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send,...”³⁸⁴

“Thuaj: »O ju injorantë, a mos më thirrni të adhuroj tjetër, në vend të All-llahut.”³⁸⁵

“Pasha Alahun, ty të është shpallur, e edhe atyre para teje: »Nëse i bën shok (All-llahut), veprat tua janë të asgjësuar dhe ti do të jeshë prej të humburve. Prandaj, vetëm All-llahun adhuroje dhe bëhu mirënjohës!”³⁸⁶

³⁸² El-Furkan: 60.

³⁸³ Er-Rra’d: 30.

³⁸⁴ En-Nisa: 36.

³⁸⁵ Ez-Zumer: 64.

³⁸⁶ Ez-Zumer: 65-66.

E treta: Dezertimi nga islami

All-llahu thotë:

“Ata do t’u luftojnë juve vazhdimisht për t’ju zmbarsur, nëse munden, nga feja juaj. E kush zmbarsset prej jush nga feja e tij dhe vdes si pabesimtar, ata i kanë zhdukur veprat e veta në këtë jetë dhe në jetën tjetër. Të tillët janë banorë të zjarrit dhe në të do të qëndrojnë përjetshëm.”³⁸⁷

Murte-dezertor ose përçarës është ai i cili edhe pse e ka vetëdijën e shëndoshë pa kurrfarë detyrimi dhe zgjedhje personale e braktis Dinin e vet dhe e përqafon ndonjë fe tjetër, sikur se që janë: Krishterizmi, Jehudizmi ose ndonjë drejtim tjetër, sikurse për shembull, komunizmi dhe mohon çfarëdo nga Islami, siç është obligimi i kryerjes së namazit, zekatit, është tallur në çfardo mënyrë me islamin, me parimet e njohura të tij, ose t’i paraqes argumentet që mund të shpjegohet si kufër.

Pse vie deri te shfaqja e dezertimit (largimit nga islami)

a) ~ Dezertimi për shkak të bindjes së gabuar ideologjike

1. Ulematë islam janë të pajtimit se ata që i bëjnë shirk All-llahut, mohojnë ekzistimin e Tij, mohojnë Cilësit e Tij, si Fuqinë dhe Vullnetin e Tij. I përshkruajnë diç nga të cilat Ai është i pastër, sikurse fëmijë, ose i konsideron të rrejshme melaiket. Librat, të dërguarit, Ahiretin, kaderin, ose çfardo që është pjesë përbërëse e domosdoshme e Dinit, muslimani bëhetë dezertor ose kafir.

³⁸⁷ El-Bekare: 217.

2. Është e njohur që dezertor është edhe ai musliman që e mohon tërë Kur'anin ose ndonjë pjesë të tij, po sikur të ishte ai vetëm edhe një ajet, sikurse ai që ka mendime kontradiktore mbi Kur'anin, ai i cili dyshon në mbinatyrallitetin e tij, mundësinë për ta sjellur një libër të ngjashëm me atë, ose ndryshimin e pëmbajtjes së tij në kuptim të shtuarjes ose heqjes.

3. Kafir - dezertor, konsiderohet ai i cili beson, që diç nga ajo me çka ka ardhur Muhammedi savs është gënjeshtër, sikurse edhe ai, që diç që ka ndaluar All-llahu, e bën të lejuar, siç janë; prostitucioni, konzumimi i alkoolit dhe të ngjashme.

b) ~ Dezertimi për shkak të të folurit

1. Kush pa të drejtë betohet me diç jashtë Dinit Islam. Kështu transmetohet nga Thabit b. Ed-Dahhaku, që i Dërguari i All-llahut ka thënë:

“Kush betohet pa të drejtë me diç jashtë Dinit, ai është i atillë siç ka thënë.”³⁸⁸

Nga Burejda gjithashtu transmetohet se ka thënë: I Dërguari i All-llahut ka thënë:

“Ai që thotë; Unë distancohem nga islami, - por nëse atë e ka thënë rrejshëm, ai është i atillë siç ka thënë; por, nëse atë e ka thënë me seriozitet, atëherë islamit nuk mund t'i kthehet aq lehtë.”³⁸⁹

³⁸⁸ Transmeton grupi përveç Dawudit.

³⁸⁹ Transmetojnë Ebu Dawudi, Ibn Maxhe, kurse zinxhiri i tij është i mirë.

2. Kush e përshkruan All-llahun, Kur'anin, të Dërguarin savs, ose cilindo nga lajmëtarët e fesë, ai është kafir, pa marrë parasysh, se a ka qenë ajo në shaka, seriozisht ose dukuri e talljes.

All-llahu thotë:

***“E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: »Ne vetëm jemi mahitur e dëfruar«. Thuaj: »A me All-llahun, Librin dhe të Dërguarin e Tij talleni?«.*”³⁹⁰**

3. Ulemaja është në pajtim, që besimtar nuk është ai, i cili për nënën e besimtarëve, Aishën, e paraqet shpifjen e njohur, nga e cila All-llahu e ka liruar.

All-llahu thotë:

“S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen, janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që e barti pjesën e madhe (të shpifjes) i takon dënim i madh. E përse kur e dëgjuan atë (shpifje) besimtarët dhe besimtare të mos mendoni të mirën si për vete dhe të thonin: »Kjo është shpifje e qartë«?!” Përse ata nuk i sollën katër dëshmitarë për këtë? E derisa nuk sollën dëshmitarë, ata pra te All-llahu janë mu gënjeshtarët. E sikur të mos ishte mëshira e All-llahut dhe mirësia e Tij ndaj jush, në këtë dhe në botën tjetër, ju do t’ju kapte dënim shumë i madh për shkak të asaj në të cilën u hudhët. Kur ju atë (shpifjen) e përcollët me gjuhën tuaj dhe për atë që nuk kishit kurrfarë dije flisni duke menduar se ajo ishte imtësi e parëndësishme, ndërsa te All-llahu ajo është e madhe. E përse, kur e

³⁹⁰ Et-Tewbe: 65.

dëgjuat atë, nuk thatë: »Ne nuk na takon të flasim për këtë. I lartë je Ti, kjo është shpifje e madhe«! All-llahu ju këshillon që një gjë e tillë të mos përsëritet kurrë, nëse jeni besimtarë të denjë.»³⁹¹

4. Fyerja dhe të shpifurit mbi Dinin. Kush e sulmon islamin, shpif ose rekomandon ndonjë ide ateiste ose të kafirëve, ai gjithashtu është dezertor - murted. All-llahu thotë:

“E nëse ata thyejnë zotimet e tyre pas marrëveshjes, ofendojnë fenë tuaj, atëherë luftoni krerët e mohuesve. Ata vërtet nuk kanë besë, luftoni që të frenohen (nga krimi e fyerja).”³⁹²

c) ~ Dezertimi përmes veprave

1. Dijtarët islam janë të pajtimit, se muslimani mund të bie në kufër, kur e hedh-gjuan, ose në një mënyrë tjetër e nënvlerëson Mus'hafin, kur edhe vetëm një fletë të tij e shlyen, por i njejtë është rasti edhe me hadithin që ai hadith kudsijj ose hadith i të Dërguarit savs. All-llahu thotë:

“E nëse i pyet ti ata (përse tallen), do të thonë: »Ne vetëm jemi mahitur e dëfryer«. Thuaj: »A me All-llahun, Librin dhe të Dërguarin e Tij talleni?«.”³⁹³

2. Ulematë janë të pajtimit, që gjithashtu është dezertor ai musliman, i cili i bën sexhde ndonjë statujë, Diellit, ose kur ndonjëherë bën ose thotë diç, çka tregon

³⁹¹ En-Nur: 11-17.

³⁹² Et-Tewbe: 12.

³⁹³ Et-Tewbe: 65.

qartë për talljen me Dinin dhe për nënvlerësimin e tij.

3. Nëse gjatë luftës, ndonjë musliman me vetëdëshirë pa kurrfarë detyrimi kalon në anën e armikut dhe lufton kundër muslimanëve, ai është kafir sepse All-llahu thotë:

“O ju që besuat! Mos zini miq as jehuditë as të krishterët. Ata janë miq të njëri-tjetrit. E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre. Vërtet All-llahu nuk vë në rrugë të drejtë popullin zullumqar.”³⁹⁴

I Dërguari i All-llahut gjithashtu është distancuar nga personat e tillë.

4. Kafir është edhe ai musliman, i cili lufton kundër ligjit islam (Sherijatit), duke mos i përfillur dispozitat e Sherijatit, e duke i rekomanduar ligjet e pozitivitetit të njeriut. All-llahu ka thënë:

“...E kush nuk gjykon me atë që e zbriti All-llahu, ata janë mohues.”³⁹⁵

E katërta: Hipokrizia

Munafik ose hipokrit është ai njeri, i cili publikisht para muslimanëve e shpreh dhe e thekson imanin e vet, kurse në esencë është kafir dhe gënjeshtar, hipokrizia në të besuarit është kufër, vetëm se që hipokriti nuk trajtohet si kafir, duke pasur parasysh që kufri i tij nuk është vënë në dukje sheshazi. All-llahu thotë:

“Kur të erdhën ty hipokritët, të thanë: “Ne dëshmojmë se

³⁹⁴ El-Maide: 51.

³⁹⁵ El-Maide: 44.

vërtet ti je i Dërguar i All-llahut!” E, All-llahu e di se ti je i Dërguar i Tij, por All-llahu dëshmon se hipokritët janë rrenacakë.³⁹⁶

“Ngase ata besuan (me gojë) e pastaj mohuan, andaj zemrat e tyre u mbyllën dhe ata nuk kuptojnë.³⁹⁷

Përkrah hipokrizisë në të besuarit, ekziston hipokrizia në praktikë, sikurse gënjeshtria, tradhtia dhe mosplotësimi i premtimit të dhënë. Ndërsa ai i cili është hipokrit në praktikë, nuk konsiderohet kafir, por fasik, përkatësisht mëkatar, sepse tek ai është një degë e hipokrizisë - munafikllëkut.

Vetitë e munafikut

Vetitë më të dukshme të munafikut janë:

a) Bërja e çrregullimeve në tokë, duke i rrënuar ligjet e All-llahut dhe fyerja e besimtarëve

Kur All-llahu i përshkruan munafikët, Ai thotë:

“E kur atyre u thuhet: »Mos prishni rendin në tokë«! Ata thonë: »Ne jemi vetëm përmirësues (paqtues)!« Veni re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë. Dhe, kur atyre u thuhet: »Besoni sikurse besuan njerëzit!« Ata thonë: »A të besojmë ashtu sikurse besuan mendjelehtit?« Në të vërtetë ata dhe mu ata janë mendjelehtit, por nuk e dinë.³⁹⁸

b) Të mashtruarit e besimtarëve duke e shfaqur imanin e vet në shoqërin e tyre, derisa në shoqërin e

³⁹⁶ El-Munafikun: 1.

³⁹⁷ El-Munafikun: 3.

³⁹⁸ El-Bekare: 11-13.

vet janë kafira

All-llahu thotë:

“E, kur i takojnë ata që besuan, thonë: »Ne kemi besuar«! Por, kur veçohen me shejtanët (parinë) e vet, u thonë: »Ne jemi me ju, ne vetëm jemi tallur (me besimtarët)«.”³⁹⁹

c) Injorimi i sherijatit të All-llahut dhe zbrapsja e njerëzve nga zbatimi i urdhërave të Tij.

All-llahu thotë:

“A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë mes tyre të gjykojë djalli, e duke qenë se janë urdhëruar që të mos e besojnë atë. E djalli dëshiron t'i humbë në pafundësi. Kur u thuhet atyre: »Ejani (për të gjykuar) tek ajo që e zbriti All-llahu dhe tek i Dërguari!« i sheh se si dyfytirëshit ta kthejnë shpinën.”⁴⁰⁰

d) Nxitja për veprime të këqija, e zbrapsja nga e mira.

All-llahu thotë:

“Hipokritët dhe hipokritet janë si njëri-tjetri; urdhërojnë për të keqen e ndalojnë nga e mira dhe shtrëngojnë duart e tyre. Harruan All-llahun (nuk i binden), prandaj Ai i harroi (nga mëshira). Nuk ka dyshim, hipokritët janë ata të prishurit.”⁴⁰¹

e) Marrja e kafirëve për miq, e largimi nga besimtarët.

³⁹⁹ El-Bekare: 14.

⁴⁰⁰ En-Nisa: 60-61.

⁴⁰¹ Et-Tewbe: 67.

All-llahu thotë:

“Ti (Muhammed) lëjmërojë munafikët se me të vërtetë ata kanë një dënim të dhembshëm. Janë ata që, përkundër besimtarëve, i miqësojnë jobesimtarët. Vallë, a mos kërkojnë krenari te ta? S’ka dyshim, e tërë krenaria i takon All-llahut.”⁴⁰²

f) Urrejtja ndaj besimtarëve për shkak të imanit të tyre, kurse miqësia me kafirët për shkak të kufrit të tyre

Ai i cili për vete e merr kafirin për mik, e ndihmon dhe e don për shkak të qëndrimit të tyre armiqësor ndaj besimtarëve ai e ka shkatërruar imanin e vet. All-llahu thotë:

“Nuk gjen popull që e beson All-llahun dhe Ditën e Gjykimit, e ta dojë atë që e kundërshton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe sikur të jenë ata (kundërshtarët) prindërit e tyre, ose fëmijët e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre.”⁴⁰³

Ai i cili është armik ndaj besimtarëve, ai i cili lufton kundër tyre, ai që ka urrejtje ndaj tyre dhe ai i cili u ndihmon armiqve të tyre, për shkak të imanit të tyre e ka shkatërruar imanin e vet.

All-llahu thotë:

“E nuk patën pse t’i urrejnë, përveç që e besuan All-llahun, Ngadhënjyesin, të Lavdëruarin, të Cilin i takon sundimi i qiejve e i tokës; e All-llahu është dëshmitar i çdo gjëje. Është e sigurt se ata që i sprovuan besimtarët dhe besimtaret dhe nuk u penduan; ata kanë dënimin e

⁴⁰² En-Nisa: 138-139.

⁴⁰³ El-Muxhadele: 22.

***xhehenemit dhe dënimin e djegies.*”⁴⁰⁴**

Ata do të pendohen në Ditën e Kijametit për shkak të talljes së tyre me besimtarët. All-llahu thotë:

***“Pse një grup prej robërve të Mi thanë: »O Zoti ynë, ne besuam, prandaj na fal dhe na mëshiro, se Ti je më i miri i mëshiruesve!«. E ju i patët tallur ata, sa që ajo tallje bëri të harronit përkujtimin ndaj Meje, madje edhe qeshnit me ta. E Unë sot i shpërbleva ata për atë që ishin të durueshëm ata janë fitimtarët.”*⁴⁰⁵**

⁴⁰⁴ El-Buruxh: 8-10.

⁴⁰⁵ El-Mu'minun: 109-111.

HUMBJE TË RREZIKSHME

Muslimanë, por xhahil !!!

Mosnjohja e Islamit në masë të tmerrshme i ka përfshirë vende të shumta muslimane, ashtu që ekziston numër i madh i muslimanëve që dëshmojnë, se nuk ka të adhuruar tjetër që meriton të adhurohet përveç All-llahut dhe që Muhammedi savs është rob dhe i Dërguar i All-llahut, të cilët kryejnë namazin, japin zekatin, agjërojnë ramadanin, e kryejnë haxhxin, besojnë në të gjitha që janë në Kur'an, e pranojnë dhe e duan të Dërguarin e All-llahut savs, janë jashtëzakonisht xhelozë kur është në pyetje Islami, megjithatë edhe përkrah kësaj, bëjnë vepra të tilla, shqiptojnë mendime të tilla, ose imani i tyre përmban shtesa të cilat direkt shpiejnë në kufër, shirk dhe hipokrizi, e që nuk janë të vetëdijshëm për esencën e veprimit.

Madje ata mendojnë që është në rregull ajo që ata bëjnë, si flasin dhe si sillen, e kjo në të vërtetë në esencë është kufër, shirk ose hipokrizi. Domethënë, bëhet fjalë për muslimanin i cili është xheloz në Dinin e vet, por bie në sferën e kufrit ose të shirkut, vetëm në saje të mosditurisë së tij - xhehlit, e cila e ekspozon në zjarr të

xhehennemit.

Xhahili deri diku ka arsyetim, por është i obliguar ta mësojë dhe ta pasojë të vërtetën kur njihet me të

Kur islami forcohet në zemrën e njeriut, atë mund ta rrënojë vetëm ajo që është në kundërshtim me islamin. Qëllimi dhe synimi i pastër janë kondita për rregullsinë e veprimit. Prandaj, xhahili, i cili bie në sferën e kufrit ose shirkut, pa vetëdije e shkatërron imanin e vet, duke mos pasur qëllim për ta shkatërruar, në njëfarë mënyre ka rrethana lehtësuese, por është i obliguar të mësojë dhe të nxitojë të bëjë tewbe - të pendohet.

Me një rast apostujt, nga padituria e kishin pyetur Isën assa, ashtu si qëndron në Kur'an:

***“Dhe (përkujto) kur Havarijjunët thanë: »O Isa, bir i Merjemes, Zoti yt a mund të na zbresë një tryezë nga qielli?» (Isai) tha: »Keni frikë All-llahun nëse jeni besimtarë«!*”⁴⁰⁶**

Këtu xhehaleti erdhi në shprehje të plotë, sepse ata nuk e dinin që All-llahu çdo gjë mundet. Pra, ai i cili në çfarëdo mënyre e refuzon fuqinë e All-llahut, bëhet kafir, me atë që xhehaleti i tij është rrethanë lehtësuese tek All-llahu dhe i Dërguari i Tij.

Kur i Dërguari me as'habët e vet u nis në Hajber, kaluan pranë një druri të cunguar mbi të cilin politeistët kishin shprehi që gjatë luftimeve t'i varin shpatat e tyre, duke besuar që ky dru po ndikon në fitorën e tyre. Atëherë disa muslimanë kërkuar nga i Dërguari savs që edhe ai t'ua përgatiste një dru të tillë, kurse i Dërguari savs u ishte

⁴⁰⁶ El-Maide: 112.

përgjigjur:

“Subhanall-llah, kjo është e njëjtë me atë, sikurse kur populli i Musait ka thënë: - Na e bëj edhe ti neve një zot sikurse ata që kanë zotra! - Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, do ta pasoni praktikën e atyre para jush!”⁴⁰⁷

Ata që i parashtuan këto dy pyetje Musait assa dhe Muhammedit savs nga xhehaleti-padituria, kanë rënë në sferën e shirkut. Ndaj përgjigjja e Muhammedit savs është:

“Do ta pasoni praktikën e atyre para jush.”

Kurse përgjigjja e Musait assa:

“Ai (Musai) tha: »Ju jeni popull që nuk dini«.”⁴⁰⁸

Këtyre që nga xhehaleti kanë rënë në kufër dhe shirk, Isa assa, Musai assa dhe Muhammedi savs nuk u kanë thënë që janë kafira ose mushrikë por këtë ua ka thënë All-llahu:

“Nuk ëshë ndonjë mëkat juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaj e bëjnë qëllimisht, po All-llahu është që fal, është Mëshirues.”⁴⁰⁹

Pas të kuptuarit nuk ka arsyetim për askend

Nëse puna është bërë aq e rrezikshme dhe shqetësuese, atëherë ulemaja ka përgjegjësi, që sa më me konsekuencë t’ua sqarojë njerëzve Dinin e All-llahut, kurse ai i cili nga padituria dhe padashje ka rënë në kufër ose shirk, është i

⁴⁰⁷ Transmeton Tirmidhiu dhe thotë që është i mirë dhe i besueshëm, e gjithashtu e transmeton Ahmedi nga Rakidi.

⁴⁰⁸ El-A’raf: 138.

⁴⁰⁹ El-Ahzab: 5.

obliguar që sa më parë të bëjë tewbe. Ndërsa, All-llahu për ulemanë që është inkonsekuent në sqarimin e Dinit të Tij thotë:

“Ata, të cilët fshehin argumentet dhe faktet që Ne i shpallëm, e pasi që ato ua sqaruam njerëzve në libër, të tillët i mallkon All-llahu, i mallkojnë edhe ata që mallkojnë. Përveç atyre që pendohen, që përmirësohen dhe që u shpjegojnë njerëzve, (të vërtetën), të tillëve ua pranoj pendimin, se Unë pranoj shumë pendimin, jam Mëshirues.”⁴¹⁰

Për ata që vazhdimisht i thyejnë urdhërat e All-llahut dhe Sunnetin e të Dërguarit savs, edhe pas asaj që u kanë ardhur argumentet e qarta dhe ata që i pasojnë rrugët e tjera përveç rrugës së besimtarit, All-llahu thotë:

“Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe pason rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur (në dunja) dhe e fusim në xhehennem. Përfundim i keq është ai.”⁴¹¹

⁴¹⁰ El-Bekare: 159-160.

⁴¹¹ En-Nisa: 115.

LLOJET E SHIRKUT – BESIMIT NË SHUMË ZOTËRA

Bërja shirk All-llahut në të drejtuarit me krijim

Secili, që beson se ndonjë individ mund të disponoj me krijimin në këtë kozmos, që mund të bëjë dëm ose dobi në ndonjë mënyrë tjetër pa i zbatuar ligjet e All-llahut, me të cilat All-llahu e ka rregulluar qëllimin e krijesave sikurse për shembull, që të besojë se dikush nga të gjallët ose të vdekurit mund t'i dhurojë dikujt lindje, t'ia plotësojë lutjen fatkeqit (nevojtarit), ta lëshojë shiun, ta ruajë shtëpinë, fëmijët, bagëtinë ose pozitat nga fuqitë e padukshme dëmtuese, ai ka rënë në shirk. Duke e përshtetur Vetën, All-llahu thotë:

“Vetëm i All-llahut është pushteti i qiejve e i tokës; Ai krijon çka të dojë; Ai i falë vetëm femra atij që do; e i falë vetëm meshkuj atij që do. Ose u falë çift, meshkuj e femra, por atë që do e lë pa fëmijë (steril); Ai është i Dijshëm, i Fuqishëm.”⁴¹²

⁴¹² Esh-Shura: 49-50.

“A është Ai që i përgjigjet nevojtarit (të mjerit) kur ai e thërret, duke ia larguar të keqen e juve ju bën mbizotërues të tokës. A ka zot tjetër pos All-llahut? Jo, por ju shumë pak përkujtoni.”⁴¹³

“Nëse All-llahu të godet me ndonjë të keqe, s’ka kush që ta largojë atë pos Tij, e nëse të dhuron ndonjë të mirë, duhet ditur se Ai është i Gjithëfuqishëm për çdo send.”⁴¹⁴

“Thuaj: »Më tregoni, nëse uji juaj humbet në thellësi, kush do t’ju sjell ujë mbitokësor (burimor)«.”⁴¹⁵

“Ai është që e zgjat natën në pjesë të ditës dhe e zgjat ditën në pjesë të natës, i nënshtroi Diellin dhe Hënën që secili lëviz (udhëton) deri në afatin e caktuar. Ky është All-llahu, Zoti juaj, i tërë sundimin është i Tij, e ata që i lutni në vend të Tij, nuk posedojnë as sa një cipë (e hurmave, fije).”⁴¹⁶

Llojet e shirkut në ibadet

1. ~ Përshkruarja e pjesëmarrjes në furnizim dikujt tjetër përveç All-llahut

Ai i cili i ofron mjaltë, tlyen ose grurë drurit të caktuar, gurëve ose varreve, ai i cili i ofron mish dhe qumësht xhinnëve, ai i cili viçin e parë të lopës ose ndonjë kafshe të re e sakrifikon për dikend tjetër përveç All-llahut, ai i cili përpara dasmorëve e thyen venë për t’i kënaqur xhinnët, ai i cili për xhinnët çdo vit e ther nga një dash, me qëllim të ruajtjes së shtëpisë ose bunarit, secili që vepron ashtu, ka bërë shirk, sepse All-llahu thotë:

⁴¹³ En-Neml: 62.

⁴¹⁴ El-En’Am: 17.

⁴¹⁵ El-Mulk: 30.

⁴¹⁶ El-Fatir: 13.

“Dhe çdo të mirë që e keni, ajo është prej All-llahut, madje edhe kur ju godet e keqja, ju vetëm tek Ai e ngritni zërin (me lutje). Pastaj, kur Ai e largon prej jush dënimin, qe, një grup prej jush i përshkruajnë shok Zotit të tyre. (I bëjnë shok) Dhe ashtu ata përbuzin atë që Ne u dhamë atyre, pra shfrytëzoni (për një kohë) se më vonë do të kuptoni (rrjedhimin). E nga ajo që Ne i furnizuam, ata u ndajnë një pjesë atyre (zotave) që nuk kuptojnë asgjë. Pasha All-llahun, patjetër do të merreni në pëgjegjësi për atë që trillonit.”⁴¹⁷

“Dhe nga ajo që krijoi Ai prej të lashtave dhe prej kafshëve shtëpiake, ata (idhujtarët) e ndanë një pjesë për All-llahun dhe thanë: »Kjo është për All-llahun, si mendonin ata, e kjo është e idhujve tanë«. Ajo që ishte për idhujt, nuk shkon tek All-llahu, e ajo që është për All-llahun, shkon tek idhujt e tyre. Sa gjykim i shëmtuar është ai që gjykojnë (pjesën e idhujve e plotësonin nga ajo e All-llahut, në rast nevojë, e të All-llahut jo).”⁴¹⁸

Këtu gjithashtu hyn ai i cili dhëmbin e vet e gjuan kah Dielli për t'i mbirë edhe më i mirë.

2. ~ Të therurit e kafshëve në emër të dikujt tjetër përveç All-llahut

Kush e ther kafshën në emër të ndonjë vendi, ndonjë druri, ndonjë tyrbe, ndonjë kubeje ose ndonjë varri, kjo është si në kohën e xhahilijetit kur kafshët i thernin në emër të ndonjë statuje ose ndonjë idhulli. Ai i cili tenton që me therje, t'i afrohet dikujt tjetër përveç All-llahut, ka bërë shirk, sepse therja e kafshëve është një lloj ibadeti.

⁴¹⁷ En-Nahl: 53-56.

⁴¹⁸ El-En'Am: 136.

All-llahu thotë:

“Ne, vërtetë të dhamë ty shumë të mira. Andaj, ti falu dhe ther kurban për hirë të Zotit.”⁴¹⁹

“Thuaj: »Namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për All-llahun, Zotin e botëve. Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i muslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)«!”⁴²⁰

Ali b. Ebu Talibi (All-llahu qoftë i kënaqur me të) transmeton nga i Dërguari savs që ka thënë:

“All-llahu e ka mallkuar atë, i cili e ther kafshën për diç ose për dikend tjetër përveç All-llahut.”⁴²¹

3. ~ Lutja dikend tjetër përveç All-llahut

All-llahu na ka sqaruar që ibadet është:

“Zoti juaj ka thënë: »Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangen adhurimit ndaj Meje, do të hyjnë në nënçmuar në xhehennem«.”⁴²²

I Dërguari savs gjithashtu na ka sqaruar se:

“Duaça-lutja është ibadet!”⁴²³

Ai i cili i lutet dikujt tjetër përveç All-llahut, po sikur ai të jetë Melaike, i dërguar, evlia, xhinn ose shejtan, njeri i gjallë a i vdekur, ai bie në shirk.

All-llahu thotë:

⁴¹⁹ El-Kewther: 1-2.

⁴²⁰ El-En'Am: 162-163.

⁴²¹ Transmeton Muslimi në Sahihun e vet, Ahmedi në Musenedin e vet, dhe En-Nesaiu në Sunnenin e vet.

⁴²² Gafir: 60.

⁴²³ Ahmedi dhe Tirmidhiu.

“Dhe mos lut askend tjetër pos All-llahut, ndonjë (idhull) që nuk të sjell as dobi as dëm, e nëse bën atë, dije se i ke bërë padrejt vetvetes. Nëse All-llahu të provon me ndonjë të keqe, atë s’mund ta largojë kush pos Tij, po, nëse dëshiron të japë ndonjë të mirë, s’ka kush që mund ta pengojë dhuntinë e Tij. E shpërblen me të, atë që do nga robët e Tij. Ai fal dhe mëshiron shumë.”⁴²⁴

“S’ka dyshim se ata që po i adhuroni ju, pos All-llahut, janë të krijuar sikur ju. Thirrni pra ata, e le t’ju përgjigjen juve nëse e thuani të vërtetën.”⁴²⁵

“Thuaj: »Ftoni ata, të cilët i menduat (zota) pos Atij, e ata nuk mund të heqin prej jush mjerimin, as nuk mund të mënjanojnë«. Të tillë (zotat) që këta po lusin (pos Zotit), vetë ata (zotat e tyre) kërkojnë afrimin (te Zoti i vërtetë), shpresojnë në mëshirën e Tij dhe i frikësohen dënimit të Tij. Vërtet, dënimit të Zotit tënd ëshë për t’ju ruajtur.”⁴²⁶

4. - Mospërfillja e dispozitave të All-llahut në fushën e legjislacionit

Ai i cili nuk i përfillë ose i refuzon ligjet e All-llahut, e i pranon ligjet e njerëzve, ligjet pozitiviste, ai i bën ibadet dikujt tjetër përveç All-llahut, sepse vendosja e ligjit dhe zbatimi i tij është një lloj ibadeti.

All-llahu thotë:

“...Gjykimi nuk i takon kujt, pos All-llahut, e Ai urdhëroi të mos adhuroni tjetër vetëm Atë. Kjo është feja

⁴²⁴ Junus: 106.

⁴²⁵ El-A’raf: 194.

⁴²⁶ El-Isra: 56-57.

*e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.*⁴²⁷

Atëherë gjykimi nuk i takon idhujve përkrah Allahut.

*“A i vure re ata që mendojnë se besuan atë që të zbriti ty dhe atë që zbriti para teje, se si dëshirojnë që mes tyre të gjykojë shejtani, e duke qenë se janë urdhëruar që të mos e besojnë atë. E shejtani dëshiron t’i humbë në pafundësi.”*⁴²⁸

*“All-llahu është mik-mbikëqyrës i atyre që besuan, i nxjerr ata prej errësirave në dritë. E miq-kujdestarë të atyre që nuk besuan janë shejtanët që i nxjerrin ata prej drite e i hudhin në errësira. Ata janë banues të zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”*⁴²⁹

5. ~ Tolerimi i së keqës dhe të kënaqurit me përhapjen e saj

Ata, të cilët haptazi ose fshehurazi e tolerojnë të keqën dhe të cilët janë të kënaqur me përhapjen e saj, me atë e humbin imanin dhe bëhen kafir, edhe pse thonë dhe pohojnë që janë muslimanë. A thua vallë se si është me ata të cilët urojnë për të këqijat e bëra, edhe pse përkrah asaj e tolerojnë dhe e lejojnë. E ngjashme është edhe me ata të cilët sotë rrahin gjoks që janë muslimanë, ndërsa, japin përparësi dhe urojnë për të keqën e bërë, i gëzohen asaj, që në vendet publike mund t’i shohin femrat e zhveshura, pse meshkujt përzihen me gratë dhe pse mund të hidhen në haramë ose bile sikur ai që i shan, urren dhe ia ekspozon talljes meseve islamike në të cilat edhe më tutje ruhet

⁴²⁷ Jusuf: 40.

⁴²⁸ En-Nisa: 60.

⁴²⁹ El-Bekare: 257.

dinjiteti, dhe për këtë arsye shoqërinë muslimane e konsiderojnë të prapambetur dhe primitive.

Njeriu i tillë ka frikë nga thirrja për zbatimin e Librit të All-llahut dhe urdhërave të Tij në praktikën e përditshme dhe me dëshpërim lufton për t'ia hapur rrugën epsheve dhe ëndjeve të veta.

Për të tillët dedikohen fjalët e të Dërguarit savs:

“Nuk ka pasur të dërguar, e të cilët All-llahu i dërgoi para meje, e që nuk ka pasur pasues, të cilët e kanë dëgjuar dhe u kanë nënshtruar, por pas tyre vinin të prishurit, të cilët njëriën e flisnin, e tjetrën e punonin (flisnin e nuk punonin). Ai i cili lufton kundër tyre me dorën e vet, ai është besimtarë. Kush kundër tyre lufton me gjuhën e vet edhe ai është besimtar, e kush kundër tyre ka luftuar me zemër, ai është gjithashtu besimtar, por pas kësaj nuk ka iman as sa grimca e xixës!”⁴³⁰

6. - Të folurit mbi diturinë e gjërave Gajb

Nëse personi pohon mbi vetën e tij ose për dikend tjetër që posedon dituri mbi gjërat Gajb, atëherë bie në shirk ose kufër. All-llahu thotë:

“Ai është që e di të fshehtë, por fshehtësinë e vet nuk ia zbulon askujt. Me përjashtim të ndonjë të dërguari që Ai do...”⁴³¹

Duke i dhënë instrukcion të Dërguarit savs, All-llahu thotë:

“Thuaj: »Unë nuk kam në dorë për veten time as ndonjë dobi, as ndonjë dëm, pos çka do All-llahu. Sikur ta dija

⁴³⁰ Muslimi dhe Ahmedi nga Abdull-llah b. Mes’udi.

⁴³¹ El-Xhinn: 26.

të fshehtën, do të shumoja për vete të dobishmet, e nuk do të më prekte gjë e keqe. Unë nuk jam tjetër vetëm se qortues dhe përgëzues për njerëzit që besojnë».⁴³²

Pra, provim i thjeshtë me të cilin All-llahu ua zbulon turpin atyre të cilët flasin për njohjen e gjërave gajb, e kjo do të thotë njohja e tregtisë profitabile dhe rentabile dhe të mirren me të. Atëherë do të ishin bërë njerëz më të pasur, ose sikur të dinin se çfarë fatkeqësish do të ndodhin, do të ruheshin nga ato që mos t'i godasin.

Këtu, gjithashtu bëjnë pjesë astrologët dhe parashikuesit e fatit - falltorët.

I Dërguari savs thotë:

“Kush shikon te falltori dhe beson në atë çfarë i thotë (parashikojnë), është bërë kafir në atë çka i është shpallur Muhammedit (savs).”⁴³³

Disa gjëra, të cilat astrologët ose falltorët i parashikojnë, ndërsa ato me të vërtetë janë të rralla, arrijnë si lajme nga shejtani i xhinnëve, të cilët me një të vërtetë përziejnë 99 gënjeshtër. Ndërsa ata që kontaktojnë me shejtanët janë njerëzit më të ndytë.

All-llahu thotë:

“A t’u tregoj unë se kujt i vijnë shejtanët? Ata i vijnë çdo gënjeshtari mëkatari. (U vijnë) Dhe hedhin dëgjimin, shumica e tyre gënjejnë.”⁴³⁴

7. ~ Sihri dhe falli

Ai i cili mirret me sihër - magji, i thërret shejtanët,

⁴³² El-A'raf: 188.

⁴³³ Hadithi është i besueshëm, kurse e paraqesin Ahmedi, Tirmidhiu, Ebu Dawudi, En-Nesaiu dhe Ibn Maxhe.

⁴³⁴ Esh-Shuara: 221-223.

lidh nyje, shkruan shenja të ndryshme në hajmali, në të cilat përmenden emrat e xhinnëve, e ai i cili fut urrejtje mes çifteve bashkëshortore, ai bie në kufër.

All-llahu thotë:

“(E hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që thonin shejtanët në kohën e sundimit të Sulejmanit. Por Sulejmani nuk ishte i pafe, shejtanët ishin të pafe, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën) Edhe atë që u zbriti në Babil dy melekëve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t’i thonin: »Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pafe!« E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejën e All-llahut me atë askujt nuk mund t’i bënëin dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për çka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe. E sikur të kishin besuar ata dhe sikur të ishin ruajtur (prej mëkateve), po të dinin, shpërblimi prej All-llahut do të ishte shumë më i dobishëm.”⁴³⁵

Me sihir nënkuptohen dhe disa veprime të kokëtrashëve, kur i bien kokës me kokë, kur me shpata ose me thika e shpojnë trupin e vet dhe, ai i cili i magjeps njerëzit duke e larguar sihrin nga barku i tyre. I Dërguari sava ka thënë:

“Neve nuk na takojnë ata, të cilët shkojnë te falltorët, kush mirret me sihir ose kërkon ndihmë nga sihri dhe

⁴³⁵ El-Bekare: 102-103.

kush e parasheh fatin dhe të cilit i parashikohet fati!”⁴³⁶

⁴³⁶ Transmetojnë El-Bezza me sened të mirë.

TË ARRITURAT PAS TË CILAVE KEMI MBETUR LARG PRAPA

Kur njeriu mendon mbi gjendjen e muslimanëve, ka për të parë se kanë mbetur shumë të varur nga popujt tjerë, në pikëpamje të disponimit me gjëra të dunjasë, në industri, bujqësi, tregti, të mirat teknike etj.

Vallë, çka është shkaku i kthimit të prapambetorisë, jo vetëm në pikëpamje materiale, por edhe në pikëpamje fetare!?

Pasi që imani në zemra hatashëm është dobësuar, kontakti me All-llahun është bërë gati i panjohur, kurse morali përjetoi rënie të tmerrshme, filloi të përhapet çrregullimi, ashtu që erdhën gjeneratat, të cilat e asgjësuan namazin dhe filluan t'i pasojnë epshet dhe ëndjet e veta, në mes njerëzve mbretëroi padrejtësia e madhe, mëkatet u shumëfishuan, u shfaqën moskuptimet dhe përleshjet e mëdha në mes muslimanëve, tmerrësisht është rritur mosnjohja e Dinit dhe dunjasë, janë shfaqur novacione të shumta dhe dukuri të ndryshme të supersticioneve (besimeve të kota), muslimanët e humbën mirëkuptimin dhe vëllazërimin e çmuar, e me atë edhe fuqinë e vet, ashtu që mu aty filloi dekadencia, nga gjendja e keqe në gjendje gjithnjë më të keqe.

Kolonializmi edhe më thellë i mbolli rrënjët e prapambeturisë sonë, kurse ne e ndihmuam

Nëse All-llahu ka thënë:

“...All-llahu kurrësi nuk iu mëndëson jobesimtarëve mbizotërim të plotë mbi besimtarët.”⁴³⁷

Pasi që e humbën imanin e rregullt, e në vend të tij erdhën novacionet dhe supersticionet e ndryshme, përveç atyre që All-llahu i mëshiroi, muslimanët ishin të gatshëm për ta parnuar pushtetin e kafirëve, të cilët bënë përpjekje të shumta për ta penguar çdo gjë që do ta vënte në veprim çfarëdo lloji të përparimit fetar ose të përparimit në dunja, të muslimanëve.

Në saje të imanit të dobët, në mesin e tyre u gjendën të tillë, që ranë në kurthën e kafirëve, i ndihmuar dhe kontribuan në suksesin e tyre kundër muslimanëve.

Shkaqet e përparimit fetar dhe të dunjasë

Shkaqet, të cilat i rilindin muslimanët në pikëpamje fetare qëndrojnë në thellimin dhe forcimin e imanit në shpirtrat e tyre, në përtëritjen dhe forcimin e kontakteve të tyre me Krijuesin, në arritjen e sinqeritetit dhe të nënshtruarit në ibadetet e tyre, në zbatimin e ligjeve të All-llahut, në jetën e përditshme, në ngritjen e moralit në nivel islamik dhe në ngritjen dhe edukimin e gjeneratave të reja në bazë të të gjitha këtyre vlerave.

Sikur të kishim vepruar kështu do të bëheshim të veçantë dhe të bashkuar, do të bëheshim fuqi e nderuar dhe

⁴³⁷ En-Nisa: 141.

kështu do të kishim merituar ndihmën e All-llahut kundër armikut.

Shkaqet të cilat e realizojnë rilindjen e dunjasë, qëndrojnë në aftësinë dhe efikasitetin e shfrytëzimit të të gjitha të mirave materiale që All-llahu i ka dhënë në Tokë.

Që të arrijnë këtë muslimanët, është e duhur:

1. - **Arritja sa më e madhe e diturisë dhe përvojës teknike dhe fuqisë së vyeshe dhe të aftë punëtore.**

2. - **Sigurimi i mjeteve dhe i promaterialit.**

3. - **Ndërtimi i fabrikave dhe vendosja e tregut për plasimin e mallrave të prodhuara.**

4. - **Vendosja e sistemit të drejtë, i cili do ta stimulonte prodhimin dhe do ta pengonte padrejtësinë dhe dukuritë e ndryshme të keqpërdorimeve dhe të mashtrimeve.**

Këto shkaqe janë padyshim disa nga dukuritë e bëmirësisë, në çka na shtyn Dini ynë, sikurse që na shtyn në bashkëpunim në këtë plan, duke pasur parasysh që kjo është nevoja jonë e përditshme, sepse, nëse muslimanët nuk e përfillin këtë bashkëpunim, sikurse që ky është realitet i tyre i sotëm, përherë do të jenë të varur nga kafirët dhe të përlur. All-llahu thotë:

“...dhe nuk ju obligoj në Dinin tuaj me ndonjë vështirësi...”⁴³⁸

All-llahu na ka urdhëruar në bashkëpunim në baza të bëmirësisë, të cilat i përfshijnë të gjitha njohuritë e të mirave dhe të përparimit, ndërsa na i ka ndaluar mëkatet dhe armiqtë me të gjitha format e tyre.

All-llah thotë:

“Ndihmohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e

⁴³⁸ El-Haxh: 78.

*mosni në mëkatë e armiqësi. Kini dro dënimit të Allahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.*⁴³⁹

Sikurse për shembull, çdo banor i Jemenit të ipte gjysmë riali (monedhë Jemenase) për çdo muaj, do ta vendosnin nga një fakultet të të drejtave të Sheriatit, elektroteknikës, farmaceutikës, shkencave teknike, të bujqësisë ose mjeksisë, e në këto fakultete do të arrinin përvojë të domosdoshme teknike për procesin e prodhimit, zbulimin e të mirave natyrore dhe eksplotimin e tyre të drejtë dhe efikas, gjithashtu, të shqyrtonin të udhëhequrit e drejtë në fuqinë punëtore.

Sikur çdo banor i Jemenit të ipte për çdo muaj nga një rijal, atëherë do të kishin mundur të hapnin firmë ose fabrikë. A thua vallë, a do të kishim mundur të bënim, sikur çdo njëri nga ne të ipte aq sa mundet?!

Atëherë zhvillimi ynë material për një kohë të shkurtër do ta arrinte nivelin e vet lakmues!

All-llahu, vendeve muslimane u ka dhuruar pasuri të mëdha ekonomike. Ne këto pasuri nuk mund t'i shfrytëzojmë vet, por fatkeqësisht i përdorim nën mbikëqyrjen e kafirëve.

Lufta kundër përparimit dhe zhvillimit të muslimanëve me dekada të tëra

Vende të shumta muslimane kanë qenë nën mbikëqyrjen e kafirëve. Kafirët nuk e lëshuan asnjë rast që u është paraqitur për luftë kundër muslimanëve dhe Islamit. Kjo luftë e tyre kundër Islamit dhe muslimanëve ka pasur karaktere të ndryshme, ndërsa më të rëndësishmet

⁴³⁹ El-Maide: 2.

janë:

1. Abrogimi i ligjeve të Sherijatit në vendet muslimane.

2. Lufta kundër arsimimit fetar, mësimit dhe edukimit në shkolla, institucione, fakultete.

3. Lufta kundër kuadrove të vetëdijshme dhe të zgjuara muslimane.

4. Formimi i partive ateiste, me detyrë të luftës kundër Dinit.

5. Inicimi dhe favorizmi i novacioneve, miteve, supersticioneve dhe tregtia me të njëjtën, në emër të Dinit.

6. Shthurja morale e personalitetit të gruas muslimane, shkatërrimi i familjeve muslimane dhe përhapja e shfrenimeve dhe imoralitetit në shoqërinë muslimane.

7. Mbjellja e pëçarjes, moskuptimit, ndarjes dhe armiqësisë në mes të muslimanëve.

All-llahu na tërheq vërejtjen që mos t'i nënshtohemi ehli kitabëve:

***“O ju që besuat, në qoftë se ju i bindeni një grupi të atyre që ju është dhënë libri, ata, pas besimit tuaj, do t’ju kthejnë në mosbesimtarë.”**⁴⁴⁰*

Lufta e kolonialistëve kundër fuqisë materiale, të muslimanëve, ka pasur gjithashtu dukuri të ndryshme ndërsa më të dalluarat janë:

1. Vendosja e kufijve të pëçarjes dhe të ndarjes në mes muslimanëve.

2. Kontrollimi dhe dominimi mbi pasurinë e muslimanëve.

⁴⁴⁰ Ali Imran: 100.

3. Përgatitja e gjeneratave nga bijtë muslimanë, të edukuar nën kontrollin dhe sipas programeve të misioneve krishtere dhe orientalistëve, me shpërlarjen e domosdoshme të trurit të atyre bijve, që përparimi i muslimanëve nuk është përparim nëse nuk e nënkuptojnë luftën kundër Dinit, kundër Sherijatit dhe zëvendësimin e tij me ligjet pozitiviste, shthurjen morale të gruas muslimane nën slloganin “emancipimi i gruas” dhe lirimi i saj nga “prangat” e moralit, të vlerave morale dhe ndershmërisë, e në anën tjetër të lejuarit e alkoolit dhe prostitucionit.

Dhe në vend që këta bij aftësitë e veta intelektuale dhe potenciale t'i drejtojnë në ndërtimin e fabrikave, fakulteteve, univerziteteve dhe institucioneve shkencore, ata i drejtuan në luftë kundër popullit islam, besimit të tyre, kundër principeve të tyre morale dhe kundër ligjeve të sherijatit, ashtu që ai i cili e kryen namazin, në sytë e tyre është i prapambetur, prapanik. Kurse ai që e braktis namazin është përparimtar dhe i kulturuar. Gruaja e nderhme dhe e moralshme, në sytë e tyre është e prapambetur, ndërsa gruaja e shthurur, imorale, në sytë e tyre është e kulturuar, përparimtare dhe e emancipuar!

Ku janë fabrikat? Ku janë firmat muslimane? Ku janë institucionet shkencore?!

Kolonialistët dhe shërbëtorët e tyre me perfiditet (tradhti) na pamundësuan që t'i realizojmë kushtet e përparimit të vërtetë material.

4. Armiqtë e muslimanëve me shkathtësi i bënë muslimanët të varur nga fabrikat e tyre dhe prodhimi i tyre. Atë që ne duhet ta kuptojmë është fakti që përparimi që është arritur në vendet jomuslimane nuk është arritur në saje të kufrit - mosbesimit, sepse kufri është i vjetër,

ekzistonte para shfaqjes së Islamit dhe ai atëherë pasuesve të vet nuk i prodhoi aeroplanë, raketa, rrymën e të tjera, por ky përparim material është arritur në saje të përpjekjeve dhe shfrytëzimit të të mirave të cilat All-llahu ua dha robërve të Vet. All-llahu thotë:

“Ne të gjithë atyre edhe njërit e edhe tjetrit, i japim nga të mirat e Zotit tënd dhe dhënia e Zotit tënd nuk është e kufizuar.”⁴⁴¹

Pra, ata e shfrytëzuan dhënien e All-llahut, sepse punuan, ndërsa ne këtë nuk e shfrytëzuam, sepse jemi përtacë!

⁴⁴¹ El-Isra: 20.

RRUGA E SUKSESIT

Atëherë kur muslimanët e pranojnë me vërtetësi Dinin e vet, do ta pranojnë respektin dhe dinjitetin e vet.

Atëherë, All-llahu do t'u ndihmojë kundër armikut dhe do t'ua lehtësojë realizimin e suksesit në pikëpamje të Dinit dhe dunjasë.

“Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na i drejtove, na dhuro Mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je Dhuruesi i Madh.”⁴⁴²

Paqja qoftë mbi të gjithë Lajmëtarët e fesë dhe falënderimi i qoftë All-llahut, Zotit të të gjitha botërave.

⁴⁴² Ali-Imran: 8.

Tabela e përmbajtjes

EL-IMAN	1
EL-IMAN	3
Të besuarit e vërtetë në dritën e Kur'anit, Sunnetit dhe argumenteve shkencore	3
Parathënie	5
Hyrje	8
IMANI DHE ESENCA E TIJ	13
Imani: bindja e fortë - i'tikad	13
dhe veprat e mira - amel	13
Llojet e veprave	14
Imani shtohet (forcohet) dhe pakësohet (dobësohet)	15
PASTRIMI DHE SHËRIMI I ZEMRËS	17
Zemra e pastër është zemra e besimtarit:	17
1. Përparësi të plotë, të vërtetës: nga e cila rezulton njohja e të vërtetës dhe pasimi i saj.	17
2. Dashuria ndaj të vërtetës dhe zemërgjerësia ndaj Islamit.	18
3. Përgjigjja në thirrjen Islame dhe dëshira për rritjen e vazhdueshme të tij:	18
4. Të ardhurit në vete:	20
5. Bindja e fortë:	21
7. Të pasuarit e Kur'anit dhe Sunnetit	23
TË BESUARIT NË ALL-LLAHUN	26
Të besuarit në All-llahun është obligim i njeriut	26
SHKENCA RRUGË PËR NË IMAN	28
ARGUMENTET SHKENCORE MBI TË BESUARIT NË ALL-LLAHUN	29
Principet logjike:	29

1. Ajo çka nuk ekziston - nuk mund të krijojë asgjë	29
Ajo çka ekziston	29
2.Të menduarit mbi krijimin, na tregon mbi disa veçori të Krijuesit:	30
El-Hajju, Ed-Daimu - i Përjetshëm	32
El-Alim - I Gjithdishmi	34
El-Hakim - Fisniku	36
El-Habiru - i njoftuar mbi çdo gjë	38
Er-Rezak - Furnizuesi	40
El-Hadi - Udhëzuesi	43
El-Hafidh - Mbikëqyrësi	45
Veçori të tjera	47
NJËRI DHE I VETMI ALL-LLAH AZVXH	49
KUSH ËSHË PRONAR I KËTYRE VEÇORIVE	51
3. Nëse dikush nuk posedon diç, ai as nuk mund të ta japë atë	52
Çka është në të vërtetë natyra?	52
Dyshimi dhe përgjigja	53
PËRGJIGJA NË MASHTRIMET E TË KRISHTERËVE	55
I Cili e dëgjon lutjen e nevojtarit kur lutet	57
QËNDRIMI I KAFIRAVE, MBI PYETJEN E ARGUMENTEVE TË IMANIT	58
Pasimi i verbër i kufrit	59
Inicimi i gënjeshtreve dhe trillimeve	59
Kushtëzimi i të përgjigjurit në thirrje	62
TË NJOHURIT E ALL-LLAHUT PËRMES CILËSIVE DHE EMRAVE TË TIJ TË BUKUR	63
Rëndësia e njohjes së emrave të bukur të All-llahut dhe cilësive të Tij	63
Shpallja - rrugë më e mirë, për kuptimin e veçorive dhe emrave të bukur të All-llahut	65

Përsosmëria e All-llahut mbi krijesat	66
TË BESUARIT NË EMRAT E BUKUR TË ALL-LLAHUT DHE CILËSITË E TIJ, SIPAS KUR'ANIT DHE SUNNETIT	67
Pamundësia e njohjes së qenies së All-llahut	68
Arsyeja dhe të kuptuarit e gjërave	69
Emrat e bukur	70
TË DËSHMUARIT QË MUHAMMEDI SAVS ËSHTË I DËRGUAR I ALL-LLAHUT	71
Argumente të qarta mbi vërtetësinë e Muhammedit, savs, dhe Risaletin - Misionin e tij	71
Argumenti Kur'anor - mu'xhiza	71
Të shqiptuarit e Kur'anit dhe madhështia e vazhdueshme e tij	72
Paraqitja Kur'anore e lajmeve (gjërave) të fshehta - gajbit	73
Aspektet bashkëkohore-shkencore të mu'xhizës Kur'anore	77
SHENJAT E DITËS SË KIJAMETIT	82
1. Ngjarjet e mëdha që deri më tani askujt nuk i kanë rënë ndërmend:	83
2. Kur të zhveshurit dhe të zbathurit dhe barinjtë e varfër bëhen të pasur dhe kur ata do të garojnë në ndërtime	83
3. Shfaqja e femrave të zhveshura, në mënyrë provokuese, lakuriqe dhe mashtruese, kokat e të cilave janë sikurse gunga e devës	84
4. Të folurit e gjërave	85
5. Zhdukja e diturisë, termete të shpeshta, të afruarit e kohës, shfaqja e fitnës-ngatërresave dhe ndërtimi i rrokaqiejve	86
6. Të përshëndeturit e njerëzve të veçantë, tregtia	

masovike, shkëputja e lidhjeve fisnore, leximi i jashtëzakonshëm dhe dëshmia e paarsyehme-e rrejshme	87
7. Shfaqja e zinasë - imoralitetit dhe përdorimi i madh i alkoolit	87
8. Të marrurit me kamat	88
9. Të përshëndeturit me mallkime dhe imitimi reciprok i femrës dhe i mashkullit	88
10. Grupi i rrugës së drejtë	89
ARGUMENT I CILI E NDËRRON SISTEMIN E KRIJIMIT	91
Nga Kur'ani Kerimi:	91
1. Ndarja e Hënës	91
2. Isra'ja dhe Mi'raxhi	92
3. Erërat dhe ushtria e padukshme e ndihmojnë në luftë të Dërguarin savs dhe as'habët e tij	93
4. Në luftën e Bedrit	94
5. Ushtria e All-llahut e ndihmon Muhammedin savs gjatë hixhretit kundër kafirëve.	95
Pyetje dhe përgjigje	96
ARGUMENT I CILI E NDRYSHON SISTEMIN E KRIJIMIT TË ZAKONSHËM	98
Nga hadithi i nderuar	98
1- Rritja e sasisë së vogël të ujit	98
2- Rritja e e ushqimit nga sasia e vogël e tij	99
3- Vajtimi i pikëllueshëm i palmës dhe tesbih-ët e ushqimit	100
4- Mrojtja e Muhammedit savs nga armiqtë e tij	101
5- Paralajmërimet e tij mbi gjërat e fshehura - gajb	101
PARALAJMËRIME TË GËZUARA TË SHPALLURA NË LIBRAT E MËPARSHËM	102

Në Tewrat:	103
Në Inxhil:	104
Në librat e Hindusëve:	105
Në librat e mexhusive - zjarreputistëve:	106
DËSHMIA E GJENDJES SË PËRDITSHME E TË	
DËRGUARIT SAVS MBI VËRTETËSIN E DËRGIMIT	
TË TIJ	107
1.Singeriteti	107
2.Konsekuencë absolute në atë në çfarë i ftonte njerëzit	108
3. Zbatimi i tij konsekuent i shpalljes dhe sqarimi i saj	
njerëzve	110
SJELLJA E PASUESVE DHE ARMIQVE NDAJ TIJ	
DËSHMUAN QARTË MBI MISIONIN E TIJ	113
Pasuesit e tij:	113
Miq e tij:	114
UNIVERZIALITETI I SHERIATIT PËR ÇDO KOHË	
DHE PËR ÇDO VEND	115
TË PËRULURIT NË IBADET	118
1. Çka është ibadeti	118
2. Llojet e ibadetit	120
a) Ibadeti nga bindja	121
b) Ibadeti në fjalë	125
c) Ibadetet praktike	128
E para:	Singeriteti i
nijjetit për ibadet	134
E dyta:	Të besuarit
në melaiket	135
E treta:	Të besuarit
në Libra	137
KUR'ANI KERIM	141
Vendi i Kur'anit në lidhje me librat e mëparshëm	141

Obligimi i tërë Ummetit është që t'i përmbahen Kur'anit	142
Zbatimi konsekuent i Kur'anit	143
Premtimi i All-llahut, për ruajtjen e Kur'anit	143
Dëshmitar i ruajtjes së Tij	144
Sunneti - komentues i Kur'anit dhe mënyra e ruajtjes së Tij	145
All-llahu e zgjodhi Ummetin më të mirë për ruajtjen e Librit të Tij dhe Sunnetin e të Dërguarit savs	146
Besimtarë të vërtetë	147
Ndihmësit e të Dërguarit të All-llahut dhe përkrahja e tij	148
Janë të ashpër ndaj kafirëve, kurse të mëshirshëm mes vete, e sexhden e bëjnë të përlulur	148
Cilësitë e as'habëve që i kandidonin për udhëheqës fetar dhe popullor	149
E katërta:	Të
besuarit në të dërguarit, All-llahu qoftë i kënaqur me ta	151
Fisnikëria e dërgimit të të dërguarve	152
Virtytet e të Dërguarve, paqja dhe mëshira e All-llahut qofshin mbi ta	154
Të dërguarit e mëparshëm	156
Muhammedi savs	158
E pesta:	Të besuarit
në Ahiret	159
ARGUMENTET MBI TË BESUARIT NË AHIRET	160
Argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti:	160
JETA NË BERZAH	166
Argumentet nga Kur'ani dhe Sunneti	166
Argumente racionale	168
Tmerret dhe pamjet e llahtarshme të Ditës së Kijametit	

	169
XHENNETI DHE XHEHENNEMI	171
Rezultati i të besuarit në Ahiret	172
SI DO TË BËHET RINGJALLJA	173
Elementet nga të cilat është krijuar njeriu	173
Periudha e sprovave dhe mbarimi i saj	173
Me vdekjen e njeriut elementet e përmendura kthehen në gjendje të mëparshme	174
Gjatë ringjalljes këto elemente përsëri do të jenë të bashkuara	175
Përgjigje atyre që nuk besojnë në Ahiret	176
E gjashtë:	Të
besuarit në Kader - përcatim	178
Çka domethënë Kader?	178
Të besuarit në Kader	179
Rezultatet e të besuarit në Kader	180
DY DILEMA	182
Dilema e parë:	182
Dilema e dytë:	184
DOMOSDOSHMERIA E TË BESUARIT	187
1. - Të besuarit në çdo gjë, që ka ardhur nga All-llahu:	187
2. - Të nështuarit e All-llahut dhe të Dërguarit të Tij	188
3. - Kryerja e obligimeve fard	188
4. - Kryerja e obligimeve dhe të ruajturit nga ndalesat	189
5. - Pendimi dhe të kërkuarit e faljes	189
6. - Të nxiturit për të mirë dhe të penguarit nga e keqja	190
7. - Thirrja e njerëzve në Dinin e All-llahut dhe lufta kundër atyre që zbrapsin nga ai	191
8. - Miqësia mes besimtarëve dhe izolimi i kafirëve	193

E KUNDËRTA E IMANIT	195
E para: Kufri dhe llojet e tij	195
a) - Kufri i të futurit në gënjeshtër	195
b) - Kufri i inatit dhe mendjemadhësisë	195
c) - Kufri i largimit dhe indiferencës	196
d) - Kufri i dyshimit	196
e) - Kufri i mohimit dhe i refuzimit	197
E dyta: Shirku dhe llojet e tij	197
a) - Shirku, kur njeriu beson në All-llahun, por dikend tjetër e konsideron të barabartë me Të, në pushtetin e paprekshëm dhe në të udhëhequrit me krijesa, në krijimin, jetën, vdekjen, furnizimin, dëmin, dobinë dhe të ngjashme.	198
b) - Shirku kur dikush vetën e tij ose dikend tjetër e përshkruan me cilësi të Zotit.	198
c) - Lloji i shirkut, kur njeriu i bën ibadet dikujt tjetër përveç All-llahut, pa marrë parasysh se çfarë ibadeti është ai.	199
E treta: Dezertimi nga islami	200
Pse vie deri te shfaqja e dezertimit (largimit nga islami)	200
a) - Dezertimi për shkak të bindjes së gabuar ideologjike	200
b) - Dezertimi për shkak të të folurit	201
c) - Dezertimi përmes veprave	203
E katërta: Hipokrizia	204
Vetitë e munafikut	205
HUMBJE TË RREZIKSHME	209
Muslimanë, por xhahil !!!	209
Xhahili deri diku ka arsytim, por është i obliguar ta mësojë dhe ta pasojë të vërtetën kur njihet me të	210
Pas të kuptuarit nuk ka arsytim për askend	211

LLOJET E SHIRKUT – BESIMIT NË SHUMË ZOTËRA	213
Bërja shirk All-llahut në të drejtuarit me krijim	213
Llojet e shirkut në ibadet	214
1. - Përshkruarja e pjesëmarrjes në furnizim dikujt tjetër përveç All-llahut	214
2. - Të therurit e kafshëve në emër të dikujt tjetër përveç All-llahut	215
3. - Lutja dikend tjetër përveç All-llahut	216
4. - Mospërfillja e dispozitave të All-llahut në fushën e legjislacionit	217
5. - Tolerimi i së keqës dhe të kënaqurit me përhapjen e saj	218
6. - Të folurit mbi diturinë e gjërave Gajb	219
7. - Sihri dhe falli	220
TË ARRITURAT PAS TË CILAVE KEMI MBETUR	
LARG PRAPA	223
Kolonializmi edhe më thellë i mbolli rrënjët e prapambetorisë sonë, kurse ne e ndihmuam	224
Shkaqet e përparimit fetar dhe të dunjasë	224
Lufta kundër përparimit dhe zhvillimit të muslimanëve me dekada të tëra	226
RRUGA E SUKSESIT	230